



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RAPORT

I

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2010

TIRANË 2011

HYRJE

Raportimi i Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend “Mbi gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2010” bëhet në përmbushje të detyrimit të nenit 149 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 53 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar).

Ky raport përmban të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe drejtimit dhe përparësitë në luftën ndaj kriminalitetit.

Treguesit për punën e organit të akuzës për vitin 2010 dëshmojnë për rritje të komponentëve sasiorë dhe atyre cilësorë. Këto arritje janë rezultat i angazhimit të prokurorëve në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të tyre.

Interesi i organit të akuzës në ushtrimin e ndjekjes penale dhe në përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit shqiptar, nuk është që ai të fitojë një rast, por që drejtësia të bëhet.

Ne jemi të paafte për të gjetur një justifikim për dështimin e një prokurori, me qëllim shmangien e përgjegjësisë që ne kemi në ushtrimin e këtij funksioni publik kaq të rëndësishëm në funksionimin e shtetit të së drejtës.

Drejtësia konsiston jo në të qënurit neutral mes së mirës dhe së keqes, por në zbulimin e së mirës, në mbrojtjen e saj, kudo që të jetë, kundër së keqes.

Drejtësia është ai virtyt i shpirtit, që shpërndahehet siç i takon.

Shoqëria përgatit krimin, me përkushtimin për ta goditur atë, ne kemi synuar në punën tonë të instalojmë besimin tek organi i akuzës, duke u udhëhequr nga parimi se:

“Asgjë nuk duhet të preferohet përpara drejtësisë” !

VOLUMI I PUNËS SË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2010


Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Funkzioni i prokurorit duhet të ushtrohet në mënyrë të paanshme dhe objektive. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Prokuroria si organ i pavarur punën e saj e bazon në parimin e pavarësisë kundrejt të gjithë pjesëmarrësve në procedurë penale si dhe organeve të tjera shtetërore.

Organet e prokurorisë janë:

- a) Prokuroria e Përgjithshme e Republikës;
- b) Prokuroria pranë gjykatës së apelit për Krime të Rënda;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të Apelit;
- ç) Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda;
- d) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.

Gjatë vitit 2010, në organin e prokurorisë janë trajtuar 31 522 njoftime për vepra penale të ndodhura. Nga këto janë ndjekur penalisht 24 506 procedime (rritje prej 10% në krahasim me vitin 2009); prej të cilave janë regjistruar 19 286 procedime (rritje prej 14% në krahasim me vitin 2009); janë mbartur nga viti i kaluar 4 415 procedime (ulje prej 6,91% në krahasim me vitin 2009) dhe janë rifilluar 805 procedime (rritje prej 29,21% në krahasim me vitin 2009). Është vendosur mosfillimi për 7016 procedime (në Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe në Prokurorinë e Përgjithshme për çështje me juridiksion fillestar) edhe ky tregues rezulton me rritje rreth 23,5% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Volumi i punes ne hetim per vitin 2010




Gjatë vitit 2010, nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, është ngritur dhe është përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 7336 procedime (rritje prej 10,78% në krahasim me vitin 2009 me 9261 të pandehur (rritje prej 10,88% në krahasim me vitin 2009). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 9656 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal për persona nën hetim (rritje prej 27,94% në krahasim me vitin 2009).

Nga prokuroritë pranë gjykatave të Apelit është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 2682 çështje themeli (ulje prej 10% në krahasim me vitin 2009) dhe 1604 raste për masat e sigurimit personal (rritje prej 39,91% në krahasim me vitin 2009).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar akuzën në emër të shtetit pranë Gjykatës së Lartë për gjykime themeli, masa sigurimi personal, përfaqësime në Kolegjet e Bashkuara dhe, në cilësinë e subjektit të interesuar, në mbrojtje të interesave të shtetit dhe të individëve, pranë Gjykatës Kushtetuese, për 407 çështje.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

VOLUMI I PUNES I ORGANIT TE PROKURORISE PER CESHTJE TE PERFAQESUARA NE GJYQ VITI 2010




Më poshtë paraqitet grafikisht volumi i punës së organit të prokurorisë për vitet 2009-2010:

VOLUMI I PUNES I ORGANIT TE PROKURORISE 2009-2010



Më poshtë, paraqitet grafikisht volumi i punës së organit të prokurorisë për procedimet penale të regjistruara në pesë vitet e fundit (2006-2010):


ÇESHTJE TE RREGJISTRUARA 2006-2010



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 janë regjistruar 15961 procedime, që do të thotë se ka rritje të regjistrimit të procedimeve penale prej 11,2% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë regjistruar 17352 procedime, që do të thotë se ka një rritje prej 8,7% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë regjistruar 16910 procedime që do të thotë se ka një ulje të lehtë prej 2,54% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë; në vitin 2010 janë regjistruar 19286 procedime, që do të thotë se ka rritje prej 14% për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rritja e volumit të punës së organit të prokurorisë vihet re edhe në procedimet penale që kanë qenë në ndjekje penale gjatë vitit 2006-2010.

Grafiku i mëposhtëm paraqet “ndjekjen penale” në pesë vitet e fundit (2006-2010):



Sikurse shihet edhe nga grafiku, procedimet në ndjekje penale nga organi i prokurorisë kanë ardhur gjithnjë në rritje. Kështu, në vitin 2007 ka ulje të procedimeve në ndjekje penale me 1,41% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 20,14% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një rritje prej 4,69% (për qind) të procedimeve në ndjekje penale pranë organit të prokurorisë; në vitin 2010 ka përsëri rritje prej 10% (për qind) të procedimeve në ndjekje penale pranë organit të prokurorisë.

MBI PROCEDIMET E HETUARA DHE TË PËRFUNDUARA

Nga shqyrtimi i të dhënave statistikore për pesë vitet e fundit (2006–2010), lidhur me çështjet për të cilat është përfunduar hetimi nga organi i prokurorisë, rezultoni se:

Në lidhje me çështjet e përfunduara, në vitin 2007 ka rritje prej 8,63% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka përsëri rritje prej 3,39% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka përsëri rritje prej 7% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 9,34% (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Në lidhje me çështjet e pezulluara, në vitin 2007 ka rritje prej 14,35% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka përsëri rritje prej 7,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka përsëri rritje prej 27% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 15,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me çështjet e pushuara, në vitin 2007 ka rritje prej 9,55% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 12,53% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka përsëri rritje prej 9,8% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 4,37% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me çështjet e dërguara në gjyq, në vitin 2007 ka rritje prej 6% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 7,68% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 5,84% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 10,78% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

PROCEDIME TE PERFUNDUARA 2006-2010




Më poshtë paraqiten të dhëna për të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake.

Siç shihet edhe nga tabela, rezulton se numri i të pandehurve të dërguar në gjyq për vitin 2007 ka rritje të procedimeve të dërguara në gjyq prej 2,52% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 13% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 ka ulje prej 4,28% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka rritje prej 10,88% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me pushimin e akuzës për të pandehurit, dinamika në pesë vitet e fundit është e tillë që: në vitin 2007 ka rritje prej 40,34% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 20,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 3,77% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 ka ulje prej 50,39 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatës në lidhje me pafajësinë, në pesë vite 2006-2010.

Në lidhje me vendimet e gjykatës për pafajësinë, rezulton nga të dhënat statistikore se: në vitin 2007 ka ulje prej 1,12% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 6,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 vihet re rritje prej 29,56% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 vihet re një ulje prej 0,41 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e më poshtëm:



Nga të dhënat statistikore rezulton se: në vitin 2006 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,35% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate; në vitin 2007, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,26% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate; në vitin 2008, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,13% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate; në vitin 2009, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,88% (për qind) kanë marrë pafajësi më vendim gjykate në vitin 2010, nga totali i të pandehurve të dërguar në gjyq, vetëm 2,59% (për qind) kanë marrë pafajësi me vendim gjykate.

Në lidhje me mënyrën se si kanë përfunduar çështjet e dërguara nga organi i prokurorisë në vendimet e gjykatës theksojmë se për pushimin e çështjes: në vitin 2007 ka rritje të theksuar prej 3 herë në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 77,3% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 vihet re


rritje prej 25,25% (për qind) në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 vihet re rritje prej 30,45% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në analizë të të dhënave që lidhen me ankimet ndaj vendimeve të pushimit rezulton se nga numri i përgjithshëm i vendimeve të pushimit janë ankimuar në gjykatë 62 raste ose 1,24 % e çështjeve të pushuara, prej të cilave një numër shumë i vogël i rasteve, 16 janë shfuqizuar nga gjykata. Sic shihet, nga numri total i rasteve për të cilat është vendosur pushimi, vetëm 0,32 % zënë rastet e shfuqizuara nga gjykata, fakt domethënës për bazueshmërinë ligjore të vendimmarrjes së prokurorëve.

PEZULLIMET

Mbështetur në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, prokurori është organi kompetent për të vendosur pezullimin e hetimeve kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendimin e prokurorit.


Ky tregues, në vitet 2006-2010, rezulton nga të dhënat statistikore si më poshtë:



Në lidhje me pezullimet, rezulton nga të dhënat statistikore se: në vitin 2007 vihet re rritje prej 14,35 % (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 vihet re rritje prej 7,66 % (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 vihet re përsëri rritje prej 27,02 % (për qind) e vendimeve të prokurorit për pezullimin e hetimeve, në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 vihet re përsëri rritje prej 15,11 % (për qind) në krahasim me vitin 2009, të vendimeve të prokurorit për pezullimin e hetimeve.

Për vitin 2010 procedimet penale të pezulluara për moszbulim të autorit sipas veprave janë në paraqitjen grafike si më poshtë (për efekt të paraqitjes grafike tek vepra penale të tjera janë përfshirë procedime penale të pezulluara për vepra penale numri i të cilave është nën shifrën 60 procedime):

PROCEDIMET E PEZULLUARA SIPAS VEPRAVE PENALE 2010



MOSFILLIMET

Organi i prokurorisë është organi kompetent që bën regjistrimin e njoftimit të veprave penale të cilat mund të vijnë nga subjekte e në rrugë të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se në çdo kallëzim të bërë nga subjektet e parashikuara nga nenet 281 e vijues të Kodit të Procedurës Penale ekzistojnë elementët e veprave penale. Me qëllim që të evitohen hetimet e panevojshme, ligjvënësi në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar edhe të drejtën e prokurorit, që në mungesë të ekzistencës të rrethanave për fillimin e procedimit, të jepi vendimin e arsyetuar për mosfillimin e procedimit.


Ky tregues i punës, i parë edhe si mjet për të evituar hetimet e panevojshme për kallëzimet ku mungon baza ligjore, ka pësuar rritje këtë vit në krahasim me vitin e kaluar.

Kështu, ndërsa në vitin 2009 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 5679 kallëzime, në vitin 2010 janë marrë 7016 vendime të tilla.

Në analizë të të dhënave që lidhen me ankimet ndaj vendimeve të mosfillimeve rezulton se nga numri i përgjithshëm i vendimeve të mosfillimit janë ankimuar në gjykatë 82 raste ose 1,16 % e çështjeve të mosfilluara, prej të cilave një numër shumë i vogël i rasteve, 15 janë shfuqizuar nga gjykata. Sic shihet, nga numri total i rasteve për të cilat është vendosur mosfillimi, vetëm 0,21% zënë rastet e shfuqizuara nga gjykata, fakt domethënës për bazueshmërinë ligjore të vendimmarrjes së prokurorëve. Mosfillimet e bazuara në ligj e në prova përbëjnë një tregues që parandalon hetime të panevojshme dhe krijon mundësinë për përqëndrimin e forcave të punës në çështje të rëndësishme.

Në lidhje me mosfillimet, rezulton nga të dhënat statistikore se: në vitin 2007 vihet re rritje prej 19% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 vihet re rritje prej 13,64% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 vihet re përsëri rritje prej 22,63% (për qind) e vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në krahasim me vitin 2008; në vitin 2010 vihet re përsëri rritje prej 23,54% (për qind) në krahasim me vitin 2009, të vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet dinamikën e këtij treguesi në pesë vitet e fundit (2006-2010):



PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS RRETHEVE DHE KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT


Nga të dhënat statistikore rezulton se:

Në Berat, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 615 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 23,49 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Dibër, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 359 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 12,89 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Durrës,

gjatë vitit 2010 janë regjistruar 2053 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 22,12 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Elbasan, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 1674 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 30,37 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Fier, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 887 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 8,56 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Gjirokastrë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 602 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë ulje prej 3,98 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Kavajë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 384 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 25,08 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Korçë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 1140 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 12,87 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Krujë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 343 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 9,58 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Kukës, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 303 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë ulje prej 10,61 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Kurbin, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 345 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 14,61 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Lezhë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 624 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 30,81 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Lushnjë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 478 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 4,82 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Mat, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 240 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 67,83 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Pogradec, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 332 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 19,85 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Pukë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 114 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 15,15 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Sarandë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 533 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 21,13 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Shkodër, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 1254 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 33,68 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Tiranë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 5162 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 10,63 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Tropojë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 109 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 43,42 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Vlorë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 1495 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 10,41 % (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Prokurorinë për Krime të Rënda , gjatë vitit 2010 janë regjistruar 111 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 19,35 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

PROCEDIME TE RREGJISTRUARA SIPAS RRETHEVE 2009-2010



Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike sipas procedimeve te regjistruara gjatë vitit 2009 në rrethe të ndryshme të vendit dhe përqindjet përkatëse:

SHPERNDARJA GJEOGRAFIKE 2010




Në lidhje me koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë, në bazë edhe të procedimeve të regjistruara për çdo rreth gjatë viteve 2009 dhe 2010 situata rezulton si më poshtë:


Në Berat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 291,6 ndërsa në vitin 2010 është 360; në Dibër koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 337,5 ndërsa në vitin 2010 është 393,6; në Durrës koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 692,6 ndërsa në vitin 2010 është 845,5; në Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 374,4 ndërsa në vitin 2010 është 487,9; në Fier koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 354,1 ndërsa në vitin 2010 është 384,3; në Gjirokastrë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 611,6 ndërsa në vitin 2010 është 587; në Kavajë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 370,4 ndërsa në vitin 2010 është 463,1 ; në Korçë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 531,8 ndërsa në vitin 2010 është 609,6; në Krujë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 462,5 ndërsa në vitin 2010 është 506,7; në Kukës koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 537,9 ndërsa në vitin 2010 është 480; në Kurbin koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 547,7 ndërsa në vitin 2010 është 627,5; në Lezhë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 459,5 ndërsa në vitin 2010 është 600,9; në Lushnje koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 318,4 ndërsa në vitin 2010 është 333,6; në Mat koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 293,1 ndërsa në vitin 2010 është 491,8 ; në Pogradec koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 392,6 ndërsa në vitin 2010 është 470,4; në Pukë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 407,2 ndërsa në vitin 2010 është 468,7; në Sarandë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 728 ndërsa në vitin 2010 është 881,6; në Shkodër koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 423,2 ndërsa në vitin 2010 është 565,5; në Tiranë koeficienti i kriminalitetit për 100.000

banorë në vitin 2009 ishte 663,6 ndërsa në vitin 2010 është 735; në Tropojë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 467,6 ndërsa në vitin 2010 është 670,4; në Vlorë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 895,2 ndërsa në vitin 2010 është 988.

KOEFICIENTET E KRIMINALITETIT PER 100.000 BANORE SIPAS RRETHEVE 2009-2010



Më poshtë paraqitet grafikisht koeficientët e kriminalitetit për 100.000 banorë sipas rretheve për vitin 2010:



Sikurse vihet re, rrethet me problematikë më të madhe për kriminalitetin janë: Vlorë, Sarandë, Durrës, Tiranë, Tropojë, Kurbin, Korçë, Lezhë, Gjirokastrë etj.

KOEFIÇIENTËT E KRIMINALITETIT

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në shkallë Republike për vitin 2009 dhe për vitin 2010 është 529. Pavarësisht faktit se numri i procedimeve penale në shkallë vendi është rritur në krahasim me vitin 2009, koeficienti i kriminalitetit i llogaritur si raport i totalit të procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2010 me numrin e popullsisë së këtij viti, shumëzuar për 100.000 banorë, mbetet i njëjtë. Kjo vjen si efekt i rritjes së numrit të popullsisë për vitin 2010.

Koeficientët e kriminalitetit sipas strukturës së Kodit Penal.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se:

Për Seksionin e Parë, Kreu i Tretë i Kodit Penal, koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 184.9 në vitin 2009, “Vjedhja e Pasurisë” është 251,96 në vitin 2010.

Për Seksionin e Tretë, Kreu i Tetë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 101.94 në vitin 2009 “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, është 108,76 në vitin 2010.

Për Seksionin e Tretë, Kreu i Dytë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 25.86 në vitin 2009 “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit ” është 34.12 në vitin 2010.

Për Seksionin e Tetë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 37.66 në vitin 2009 “Falsifikimi i Dokumenteve”, është 32.93 në vitin 2010.

Për Seksionin e Tretë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 20.25 në vitin 2009, është 24.48 “Shkatërimi i Pronës ” është 25.07 në vitin 2010.

Për Seksionin e Parë, Kreu i Tetë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 17 në vitin 2009 “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit” është 19.56 në vitin 2010.

Në Seksionin e Parë, Kreu i Dytë koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 19,44 në vitin 2010 “Krime kundër jetës të kryera me dashje”.

Për Seksionin e Dytë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 19.72 në vitin 2009 “Mastrimet” është 15.58 në vitin 2010.

Për Seksionin e Dytë, Kreu i Tetë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 16,62 në vitin 2009 “Vepra Penale Kundër Veprimtarisë Shtetërore të Kryera nga Punonjësit Shtetëror ose në Shërbim Publik” është 15,65 në vitin 2010.

Për Seksionin e Pestë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 7.42 në vitin 2009 “Krime në fushën e Doganave” është 12.46 në vitin 2010.

Për Seksionin e Njëmbëdhjetë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte në vitin 2009 5.44 “Vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës” është 6.73 në vitin 2010.

Për Seksionin e Dhjetë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 5.82 në vitin 2009 “Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit” është 6,67 në vitin 2010.

Për Seksionin e Katërt, Kreu i Tetë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 4.6 në vitin 2009 “Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë” është 6.07 në vitin 2010.

Për Seksionin e Tetë, Kreu i Dytë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 3.19 në vitin 2009 “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit” është 4.29 në vitin 2010.

Për Seksionin e Shtatë, Kreu i Dytë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 3.13 në vitin 2009 “Vepra penale kundër lirisë së personit” është 4.01 në vitin 2010.

Për Seksionin e Gjashtë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 3 në vitin 2009 “Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 3,79 në vitin 2010.

Për Seksionin e Pestë, Kreu i Dytë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 7.54 në vitin 2009 “Vepra Penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës” është 3.47 në vitin 2010.

Për Seksionin e Shtatë, Kreu i Tretë, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 2.84 në vitin 2009 “Falsifikimi i monedhave dhe i letrave me vlerë ” është 3,47 në vitin 2010.

Për Seksionin e Gjashtë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 2.25 “Krime seksuale” është 1.97 në vitin 2010.

Për Seksionin e Nëntë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 1.22 në vitin 2009 “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” është 1,92 në vitin 2010.

Për Seksionin e Katërt, Kreu i Tretë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 0.4 në vitin 2009 “Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare” është 0.53 në vitin 2010.

Për Seksionin e Dytë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 0.59 në vitin 2009 “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi ” është 0,5 në vitin 2010.


Për Seksionin e Katërt, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 0.21 në vitin 2009 “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 0,25 në vitin 2010.

Për Seksionin e Nëntë Kreu i Tretë “Vepra penale në Fushën e Falimentimit” dhe për Seksionin e Dytë Kreu i Pestë “Krime në fushën e rendit kushtetues”, koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë është 0.06 në vitin 2010.

Për Seksionin e Dhjetë, Kreu i Dytë, Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë ishte 0.09 në vitin 2009 “Vepra penale kundër lirisë së besimit” është 0,03 në vitin 2010.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURES SE KODIT PENAL 2010



Më poshtë paraqitet analizë e strukturës së kriminalitetit sipas ndarjes në krime dhe kundravajtje penale në raport me totalin e procedimeve penale të regjistruara gjatë viteve 2009 dhe 2010 duke përfshirë të dhëna statistikore që lidhen si me procedimet penale të regjistruara nga Kodi Penal Civil ashtu edhe nga procedime penale të regjistruara nga Kodi Penal Ushtarak.

Kështu rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 krimet në raport me totalin e procedimeve penale të regjistruara përbëjnë 74,78% (për qind) ndërsa kundravajtjet përbëjnë 19,23 % (për qind). Në vitin 2010 krimet përbëjnë 71,86% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara ndërsa kundravajtjet penale përbëjnë 18,77% (për qind) të totalit të procedimeve penale të regjistruara. Theksojmë se në këtë të dhënë duhet të merret në konsideratë edhe fakti që për një total prej 5,97% (për qind) në vitin 2009 dhe prej 9,41% (për qind) në vitin 2010 është e pamundur të bëhet ndarja e procedimeve të regjistruara në krime dhe kundravajtje penale, kjo për arsye se në të dhënat statistikore nuk mund të bëhet ndarja në krime dhe kundravajtje penale për disa nene të Kodit Penal që në paragrafë të tyre përmbajnë edhe krime edhe kundravajtje penale.

Në lidhje me vendin që zënë në kriminalitetin në vend procedimet penale të rregjistruara pranë Prokurorisë për Krime të rënda, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2010 këto procedime zënë 0,57% (për qind) të totalit të procedimeve penale të rregjistruara në shkallë vendi. Në vitin 2009 ky tregues rezulton të jetë 0,54% (për qind).

TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Në vitin 2010 janë bërë në total 20898 njoftime, përkundrejt vitit 2009 kur janë bërë 21075 njoftime, që do të thotë se kemi një ulje të lehtë prej 0,83% (për qind) gjatë vitit 2010 në krahasim me vitin 2009.

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2010 janë filluar kryesisht nga prokuroria 314 procedime dhe në vitin 2009 janë filluar kryesisht 264 procedime, që do të thotë rritje prej 18 % (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009. Në këtë shifër nuk përfshihet ngritja e akuzave të reja nga prokurorët përtej fakteve kriminale të referuar në materialin kallëzues dhe të evidentuara gjatë hetimeve të kryera.

Kallëzime nga nëpunësit publikë, për vitin 2010 rezultojnë 1134 kallëzime, që do të thotë rritje prej 25,30% (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Kallëzime nga personeli mjekësor, për vitin 2010 rezulton 1 kallëzim, gjatë vitit 2009 dhe për vitin 2008 rezultojnë 5 kallëzime.

Kallëzime nga shtetasit, në vitin 2010 rezultojnë 2009 kallëzime, që do të thotë ulje prej 14,80% (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Kallëzime për vepra penale, që ndiqen mbi ankim rezultojnë 458 në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 118% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2010 është marrë njoftim për 2465 ngjarje, që do të thotë se është një tregues në ulje prej 3,71 % (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Gjithashtu, theksojmë se, gjatë viti 2010 janë marrë 13772 referime nga policia e shtetit, që do të thotë ulje prej 3,94% (për qind) në krahasim me vitin 2009; gjatë vitit 2009 janë marrë 14337 referime nga policia e shtetit, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 14529 referime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re ulje e tyre gjatë vitit 2009 prej 1,32% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2010 janë marrë 85 kallëzime nga organet tatimore që do të thotë rritje prej 21,42% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Gjatë vitit 2009 janë marrë 70 kallëzime nga organet tatimore, përkundrejt vitit

2010 kur janë marrë 32 kallëzime nga organet tatimore, që do të thotë se vihet re rritje e tyre gjatë vitit 2009 prej 2,18 herë në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2010 janë bërë 156 kallëzime nga Policia Pyjore, që do të thotë ulje prej 19,58% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Gjatë vitit 2009 janë bërë 194 kallëzime nga policia pyjore, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 188 kallëzime nga policia e shtetit, që do të thotë se vihet re rritje e tyre gjatë vitit 2009 prej 3,19% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjatë vitit 2010 janë bërë 660 kallëzime nga OSSH/CEZ, që do të thotë rritje prej rreth 5,2 herë në krahasim me vitin 2009. Gjatë vitit 2009 janë bërë 106 kallëzime nga OSSH/CEZ, përkundrejt vitit 2008 kur janë marrë 391 kallëzime nga OSSH/CEZ, që do të thotë se vihet re ulje e ndjeshme e tyre gjatë vitit 2009 prej 72,89% (për qind) në krahasim me vitin 2008.

Gjithashtu janë bërë 53 kallëzime nga “polici të tjera” gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 26,19% (për qind) në krahasim me vitin 2009 kur janë bërë 42 kallëzime pranë organit të prokurorisë edhe nga “polici të tjera” gjatë vitit 2009 dhe rreth 62 kallëzime gjatë vitit 2008.

TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT PËR VITIN 2010.


Funksion i organit të prokurorisë është edhe ekzekutimi i vendimeve penale. Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre.

Kështu, gjatë vitit 2010, prokurorët kanë urdhëruar ekzekutimin e 6763 vendimeve penale të formës së prerë, që do të thotë rritje prej 4,35% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Nga këto vendime, janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 3105 vendime penale të formës së prerë ose duke u krahasuar me vitin 2009 ka një rritje prej 7,7% (për qind) të këtij treguesi.

Vendime të cilët kanë mbetur pa u ekzekutuar (ku përfshihen edhe vendimet e mbartura të paekzekutuara), gjatë vitit 2010 janë 6263, duke u krahasuar me vitin 2009, ka një ulje prej 13,60% (për qind).

Në lidhje me këtë tregues rezulton se gjatë vitit 2010 kanë mbetur pa u ekzekutuar 14 vendime për masën e dënimit burgim i përjetshëm, përkundrejt 24 vendime me burgim të përjetshëm të paekzekutuara gjatë vitit 2009; 1486 vendime me burgim gjatë vitit 2010 përkundrejt 2107 të tilla në vitin 2009; 4729 vendime për dënimin me gjobë përkundrejt 4266 të tilla në vitin 2009 dhe 34 dënime plotësuese në vitin 2010, përkundrejt 852 të tilla në vitin 2009.

Një tregues tjetër lidhet me vendin që zënë urdhrat për ekzekutim të lëshuar nga prokurori për dënime alternative dhe urdhrat për ekzekutim në lidhje me dënimin me burgim. Në lidhje me këtë tregues rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2010, urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 18,4% (për qind) të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori (këtu përfshihen, urdhra për burgim të përjetshëm, urdhra për burgim, për gjobë, dënime plotësuese dhe dënime alterntaive). Urdhrat për ekzekutim të dënimeve me burgim zënë 32,15% (për qind) të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori.



VEPRAT PENALE KUNDËR PËRSONIT, KRIME KUNDËR JETËS

KREU II, SEKSIONI I

“KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE”

Në Seksionin e Parë, Kreu i Dytë i Kodit Penal parashikohen “Krimet Kundër Jetës të Kryera me Dashje”. Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 20 ndërsa për vitin 2010 është 19.28. Është e qartë tendenca për ulje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 3,79 % (për qind) për vitin 2009 dhe 3,19 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Parë, Kreu i Dytë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet Kundër Jetës të Kryera me Dashje.

	2009					2010				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
VP kunder Personit										
Neni 76 Vrasja	192	111	115	118	111	199	99	177	109	76
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	83	45	66	53	61	58	39	36	48	55
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	25	26	25	34	25	37	22	33	24	24
Neni 81 Vrasja e foshnjës	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	3	2	3	2	3	2	4	2	4	4
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme	5	1	4	1	1	1	3	1	3	6
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/gjakmarrje	1	1	2	2	3	4	1	3	1	0
Neni 84 Kanosja	331	153	187	171	149	313	141	200	157	117
Totali	641	339	402	381	353	616	309	452	346	282

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një ulje prej 3,9 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për krime kundër personit në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 8,84 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 12,43 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 9,18 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,11 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 605 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 579 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 4,49% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010, në përqindje, shifra është 10,05% (për qind) në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, në krahasim me vitin 2009 dhe është 57,68 % (për qind) në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim.

Nga të pandehurit, 25 kanë qenë të pandehur të mitur, meshkuj dhe 1 femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 11 femra dhe 395 meshkuj. Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton ulje e të pandehurve femra në vitin 2010. Kështu, në vitin 2009 numri i të pandehurve femra ka qenë 17 ndërsa në vitin 2010 rezulton të jetë 12, pra është ulur 29,41% (për qind). Po kështu me ulje rezulton në vitin 2010 edhe numri i të pandehurve të mitur, prej 7,14% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 311 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 115 me arsim të mesëm dhe 4 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar. Megjithatë, për të tre të dhënat e mësipërme që lidhen me

arsimin e të padehurve për këtë grup veprash penale vihet re ulje përkatësisht prej, 13,12% (për qind), 8,7% (për qind) dhe 42,85% (për qind).

Të papunë rezultojnë të jenë 265 të pandehur, që do të thotë ulje prej 18,71 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të punësuarit, 93 të pandehur të punësuar nga sektori privat dhe 1 i pandehur nga sektori shtetëror. Vihet re rritje e të pandehurve nga sektori privat në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009 prej 8,13% (për qind).

Rezultoni se 224 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 189 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 390 të pandehur, që do të thotë ulje prej 13,14% (për qind) për këtë të dhënë në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009; vetëm 3 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 19 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, që do të thotë ulje prej 17,39% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 76 i Kodit Penal "Vrasja me dashje"**, në vitin 2010, prej 3,64 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal "Vrasja me dashje", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 6.22, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 6.01 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka ulje prej 3,52% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 8,39% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 23,5% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 3,64% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 76 "Vrasja me dashje" i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të rregjistruara sipas rretheve :

Neni 76 "Vrasja me dashje"




Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se: në Tiranë, në vitin 2010 janë regjistruar 40 procedime penale, që do të thotë rritje prej 14,28% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Shkodër , në vitin 2010 janë regjistruar 21 procedime penale, që do të thotë rritje prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Vlorë , në vitin 2010 janë regjistruar 8 procedime penale, që do të thotë ulje prej 27,27% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Elbasan, në vitin 2010 janë regjistruar 20 procedime penale, që do të thotë rritje prej 122,22% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Durrës , në vitin 2010 janë regjistruar 15 procedime penale, që do të thotë ulje prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Lezhë , në vitin 2010 janë regjistruar 13 procedime penale, që do të thotë rritje prej 160% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Korçë , në vitin 2010 janë regjistruar 11 procedime penale, që do të thotë ulje prej 38,88% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Fier , në vitin 2010 dhe në vitin 2009 janë regjistruar nga 10 procedime penale; në Lushnje , në vitin 2010 janë regjistruar 8 procedime penale, që do të thotë rritje

prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Dibër, në vitin 2010 janë regjistruar 8 procedime penale, që do të thotë ulje prej 27,27% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Berat, në vitin 2010 janë regjistruar 8 procedime penale, që do të thotë rritje prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Kukës, në vitin 2010 janë regjistruar 7 procedime penale, që do të thotë rritje prej 133,33% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Sarandë, në vitin 2010 janë regjistruar 6 procedime penale, që do të thotë ulje prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Krujë, në vitin 2010 janë regjistruar 6 procedime penale, përkundrajt 7 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2009; në Kavajë, në vitin 2010 janë regjistruar 6 procedime penale, përkundrajt 2 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2009; në Tropojë, në vitin 2010 janë regjistruar 3 procedime penale, përkundrajt vitit 2009 kur është regjistruar 1 procedim penal; në Pogradec në të vitet janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Mat gjatë vitit 2010 janë regjistruar 3 procedime penale, përkundrajt vitit 2009 kur janë regjistruar 4 procedime penale; në Kurbin, në vitin 2010 janë regjistruar 2 procedime penale, që do të thotë ulje prej 81,81% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Gjirokastër, në vitin 2010 është regjistruar 1 procedim penal përkundrajt 5 procedimeve të regjistruara në vitin 2009.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim”**, në vitin 2010, prej 30 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal “Vrasja me paramendim”, për 100 000 banorë në vitin 2010 është 1.8 ndërsa për vitin 2009 ka qenë 2,59 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka ulje prej 16,66% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 janë regjistruar 65 procedime penale për këtë veprë penale, që do të thotë se jemi në të njëjtat kuota për këtë tregues si edhe në vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 18,46% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 rezulton me rritje prej 7,79% (për qind) numri i procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 rezulton ulje prej 30% (për qind) numri i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë veprë penale rezulton nga të dhënat statistikore se:

Në rrethet Berat, Fier, Kavajë, Mat, Pogradec dhe Pukë është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale, që do të thotë 2% (për qind); në rrethet Korçë dhe Kukës janë regjistruar nga 2 procedime penale për këtë veprë penale, që do të thotë nga 3% (për qind); në Krujë dhe Lushnje janë regjistruar nga 3 procedime penale ose 5% (për qind);


Neni 78 "Vrasja me paramendim" viti 2010



Në rrethet, Dibër dhe Shkodër janë regjistruar nga 4 procedime penale për këtë veprë penale ose 7% (për qind); në Elbasan janë regjistruar 5 procedime penale ose 9% (për qind); në Lezhë janë regjistruar 6 procedime penale ose 10% (për qind); në Tiranë janë regjistruar 7 procedime penale ose 12% (për qind); në Durrës janë regjistruar dhe në Vlorë janë regjistruar nga 8 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal "Vrasja me paramendim" ose 14% (për qind).

Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal "Vrasja me paramendim", për vitet 2009 dhe 2010.


Neni 78 "Vrasja me paramendim" 2009-2010



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", në vitin 2010, prej 48 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,15 ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,78 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në vitet, 2005-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Sikurse vihet re edhe nga grafiku, në vitin 2006 janë regjistruar 18.75% (për qind) më pak procedime penale për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 paraqitet me ulje prej 30.76% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë regjistruar 31 procedime penale për këtë vepër penale pranë organit të prokurorisë, që do të thotë rritje prej 14.81% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë regjistruar 25 procedime penale, që do të thotë ulje prej 19.35% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë regjistruar 37 procedime penale, që do të thotë rritje prej 48% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë vepër penale rezulton nga të dhënat statistikore se:


Sikurse rezulton nga të dhënat statistikore, në rrethin e Beratit janë regjistruar 2 procedime penale për këtë vepër penale, ose 5% (për qind); në rrethet Durrës dhe Shkodër janë regjistruar nga 5 procedime penale ose 14% (për qind); në rrethet Kavajë, Krujë, Lushnje dhe Sarandë është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë vepër penale ose nga 3% (për qind); në Korçë janë regjistruar 4 procedime penale ose 11% (për qind); në Kurbin dhe Tiranë janë regjistruar nga 6 procedime penale ose 15 % (për qind); në Lezhë janë regjistruar

3 procedime penale ose 8% (për qind) dhe në rrethin e Vlorës janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit penal "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", ose 5 % (për qind). Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Neni 79 "Vrasja ne rrethana te tjera cilesuese" 2010



Më poshtë paraqitet grafikisht numri i veprave penale të regjistruar në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal "Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme" në vitet 2006-2010.




Sikurse rezulton edhe nga grafiku në lidhje me këtë veprë penale gjatë vitit 2010 është regjistruar vetëm 1 procedim penal në rrethin e Tiranës, përkundrej 5 procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2009.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 84 i Kodit Penal "Kanosja"** në vitin 2010, prej 5.43 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal "Kanosja", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 9.79 % (për qind), ndërsa për vitin 2009 ka qenë 10.36 % (për qind) për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga grafiku i mësipërm, vihet re se në vitin 2006 janë regjistruar 476 procedime penale për këtë veprë penale ose 9.42% (për qind) më shumë në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 janë regjistruar 451 procedime penale ose 5.25% (për qind) më pak në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë regjistruar 391 procedime penale ose 13.3% (për qind) më pak në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë regjistruar 331 procedime penale, që do të thotë 15,34% (për qind) më pak në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë regjistruar 313 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja”, që do të thotë ulje prej 5,43% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Më poshtë paraqitet shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal “Kanosja” gjatë vitit 2010 me përqindjet përkatëse.

Neni 84 "Kanosja" 2010



Në Tiranë janë regjistruar 70 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 30 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 24 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 23 procedime penale; në Fier janë regjistruar 21 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 18 procedime penale; në Lushnje janë regjistruar 17 procedime penale; në Berat dhe Vlorë janë regjistruar nga 15 procedime penale; në Gjirokastrë janë regjistruar 12 procedime penale; në Kukës janë regjistruar 10 procedime penale; në Lezhë dhe Mat janë regjistruar nga 8 procedime penale; në Dibër dhe Kurbin janë regjistruar nga 7 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 6 procedime penale; në Kavajë, Pogradec, Sarandë dhe Pukë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Tropojë janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal "Kanosja".

NE SEKSIONIN E TRETË, KREU I DYTË TË KODIT PENAL, PARASHIKOHEN "KRIMET KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE".

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 25.86% ndërsa për vitin 2010 është 34.11%. Është e qartë tendenca për rritje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 4,88 % (për qind) për vitin 2009 dhe 5,65 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Tretë, Kreu i Dytë i Kodit Penal dhe konkretisht me “Krimet Kundër Shëndetit të Kryera me Dashje”.

V.P. K/shëndetit me dashje	2009					2010				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 86 Tortura	2	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 87 Tortura me pasoja të rënda	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88 Plagosje e rëndë	108	76	101	90	79	142	107	119	117	96
Neni 88/a Plagosje e rëndë tronditje psikike	10	7	8	7	5	16	12	17	12	15
Neni 88/b P.R. në kapërcim të mbrojtjes	6	5	9	5	6	2	2	2	2	2
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	686	316	500	397	232	920	406	802	501	267
Neni 90 Dëmtime të tjera	14	0	4	0	7	9	2	10	5	1
Totali	826	404	622	499	329	1090	529	950	637	381

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 31,96 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për krime kundër shëndetit në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 30,94 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 52,73 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 27,65 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 15,8 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 1091 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 591 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 84,6% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010, në përqindje, shifra është rritur në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë dhe është 39 % (për qind); gjithashtu, shifra në përqindje e të pandehurve të dërguar gjyqit në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim është 58,38 % (për qind).

Nga të pandehurit, 70 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 22 femra dhe 687 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton rritje e të pandehurve femra në vitin 2010. Kështu, në vitin 2009 numri i të pandehurve femra ka qenë 4 ndërsa në vitin 2010 rezulton të jetë 22, pra është rritur 4,5 herë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 517 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 227 me arsim të mesëm dhe 18 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe

e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjecar. E dhënë kjo që për vitin 2010 rezulton të jetë rritur shumë në krahasim me vitin 2009, rezulton pra më një rritje prej 137,15%. Gjithashtu, me rritje prej 74,6% (për qind) rezulton të jetë edhe shifra e të pandehurve me arsim të mesëm në krahasim me vitin 2009.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 2 të pandehur (që do të thotë ulje prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2009). Të dy këta të pandehur rezultojnë të jenë nëpunës të thjeshtë.

Të papunë rezultojnë të jenë 395 të pandehur, që do të thotë rritje prej 60,56 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të punësuarit, 123 të pandehur të punësuar nga sektori privat. Vihet re rritje e ndjeshme e të pandehurve nga sektori privat në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009, rritje prej 48,19% (për qind).

Rezulton se 459 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 307 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 740 të pandehur, vetëm 4 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 18 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 4 vdekje, 84 plagosje e rëndë dhe 357 plagosje e lehtë. Në krahasim me vitin 2009 rezultojnë më rritje të tre këta tragues. Në vitin 2009 rezultojnë me të dhëna zero pasoja në dëm të shëndetit “vdekje” dhe “plagosje e rëndë” dhe me 4 raste pasoja në dëm të shëndetit “plagosje e lehtë”.


TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 88 i Kodit Penal “Plagosje e rëndë”**, në vitin 2010, prej 31,48 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal “Plagosje e rëndë”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 4.44, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3.38 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):


Neni 88 "Plagosje e rënde" 2006-2010



Sikurse rezulton nga të dhënat statistikore, në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale prej 7.25% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 2.6% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë; në vitin 2009 ka ulje prej 3,57% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 vihet re rritje e ndjeshme prej 31,48% (për qind) e procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit penal "Plagosje e rëndë".

Më poshtë paraqitet shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal "Plagosje e rëndë" gjatë vitit 2010 me përqindjet përkatëse:

Neni 88 "Plagosje e rende" 2010




Nga të dhënat statistikore rezulton se në rrethin e Beratit janë regjistruar 8 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 6 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 18 procedime penale për këtë veprë penale; në Elbasan janë regjistruar 12 procedime penale; në Fier janë regjistruar 8 procedime penale; në Gjirokastrë janë regjistruar 4 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 3 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 11 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 2 procedime penale për këtë veprë penale; në Kurbin janë regjistruar 3 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 6 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 5 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 8 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 10 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 38 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal "Plagosje e rëndë".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 89 i Kodit Penal "Plagosje e lehtë me dashje"**, në vitin 2010, prej 34,11 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal "Plagosje e lehtë me dashje", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 28.79, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 21.47 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 89 "Plagosje e lehte me dashje"




Sikurse rezulton nga të dhënat statistikore, në vitin 2007 ka një ulje prej 11,3% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje të pakonsiderueshme në krahasim me vitin 2007, në vitin 2009 vihet re rritje e procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale prej 4,73% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 vihet re një rritje e ndjeshme e procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale prej 34,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Më poshtë paraqitet shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal "Plagosje e lehtë me dashje" gjatë vitit 2010 me përqindjet përkatëse si dhe të dhëna në lidhje me numrin e procedimeve penale të regjistruara për çdo rreth:

Në Pukë janë regjistruar 5 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 6 procedime penale; në Mat janë regjistruar 7 procedime penale; në Kurbin janë regjistruar 8 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 9 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 13 procedime penale; në Kukës janë regjistruar 15 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 16 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 22 procedime penale; në Berat janë regjistruar 26 procedime penale; në Gjirokastrë janë regjistruar 27 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 29 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 34 procedime penale; në Lushnje janë regjistruar 40 procedime penale; në Fier janë regjistruar 41 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 57 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 80 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 85 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 143 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 255 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal "Plagosje e lehtë me dashje". Sikurse vihet re, kjo veprë penale është e pranishme në të gjithë territorin e vendit.


Neni 89 "Plagosje e lehte me dashje



Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitet 2009-2010:

Nga të dhënat statistikore rezulton se në rrethin e Beratit janë regjistruar 8 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 6 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 18 procedime penale për këtë vepër penale; në Elbasan janë regjistruar 12 procedime penale; në Fier janë regjistruar 8 procedime penale; në Gjirokastrë janë regjistruar 4 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 3 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 11 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 2 procedime penale për këtë vepër penale; në Kurbin janë regjistruar 3 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 6 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 5 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 8 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 10 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 38 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal "Plagosje e rëndë".

Neni 89 "Plagosje e lehte me dashje" 2009-2010



VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS (NENET 93-99)

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 7,54 ndërsa për vitin 2010 është 3,25. Është e qartë tendenca për ulje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 1,42 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,53 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës (nenet 93-99) të Kodit Penal:

V. P. që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës	2009					2010				
	Nr. Proc d. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenu ar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenu ar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautorizuar	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	17	8	2	9	3	14	2	4	3	3
Neni 97 Mosdhënia ndihmë	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	220	4	4	4	2	88	3	4	3	4
Totali	241	12	7	13	5	104	5	8	6	7

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një ulje prej 56,84 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 58,33% (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 14,28 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 53,84 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 40 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 14 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 29 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 50% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në të dy vitet, në përqindje, shifra është 6 në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë dhe është 46 % (për qind) në raport me shifrën totale të të pandehurve në hetim.

Në lidhje me gjininë e të pandehurve, duke u krahasuar me vitin 2009 rezultojnë 2 të pandehur femra në vitin 2010, përkundrejt 3 të pandehur femra në vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit meshkuj, rezulton nga të dhënat statistikore se gjatë vitit 2010 kanë qenë 8 të pandehur meshkuj, përkundrejt vitit 2010 kur rezultojnë 7 të tillë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 3 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 7 të pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 4 të pandehur, përkundrejt 6 të pandehurve të regjistruar për vitin 2009. Nga këta, 3 të pandehur janë “nëpunës të thjeshtë”.

Nga sektori privat është regjistruar 1 i pandehur, e njëjtë shifra për këtë tregues edhe për vitin 2009. Të papunë rezultojnë të jenë 2 të pandehur për vitin 2009 dhe 2 të pandehur për vitin 2010. Rezulton se 8 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 2 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 9 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është i dënuar më parë. Të dëmtuar-viktima në këtë grup veprash penale rezultojnë 31, për vitin 2009, përkundrejt 55 të tillë në vitin 2010.

Pasojat në dëm të shëndetit rezultojnë me 30 vdekje, 0 plagosje e rëndë dhe 1 plagosje e lehtë. Në krahasim me vitin 2009 rezulton ulje e ndjeshme e pasojës “vdekje”, ulje prej 73,45% (për qind) në krahasim me vitin 2009.


TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”**, në vitin 2010, prej 56,84 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2.75, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 6.88 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Rezultoni nga grafiku i mëposhtëm se: gjatë vitit 2007 ka një rritje të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale prej 13,98% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 19,93% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 15,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka përsëri ulje prej 60% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal "Shkaktimi i vetëvrasjes".




Më poshtë, paraqitet në mënyrë grafike shpërndarja gjeografike e veprës penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal "Shkaktimi i vetëvrasjes" për vitin 2010:

Neni 99 "Shkaktimi i vetevrasjes"



Rezulton nga të dhënat statistikore se në rrethet Berat, Lushnje dhe Tropojë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Dibër janë regjistruar 2 procedime penale; në Kukës janë regjistruar 4 procedime penale; në Pukë dhe Shkodër janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 6 procedime penale; në Kavajë dhe Vlorë janë regjistruar nga 7 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 9 procedime penale; në Gjirokastër janë regjistruar 10 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 12 procedime penale dhe në Fier janë regjistruar 18 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal "Shkaktimi i vetëvrasjes".

Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me ecurinë e veprës penale të parashikuar nga neni 96 i Kodit penal "Mjekimi i Pakujdesshëm" gjatë viteve 2006-2010:



Rezultoni se në vitin 2007, për këtë veprë penale ka ulje të procedimeve penale të regjistruara prej 42,85% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 31,25% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 19% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka përsëri ulje të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë prej 17,64% (për qind), në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se për këtë veprë penale në rrethet Durrës, Gjirokastër, Kukës dhe Mat është regjistruar nga 1 procedim penal; në rrethet Elbasan dhe Fier janë regjistruar nga 2 procedime penale për këtë veprë penale dhe në rrethet Korçë dhe Tiranë janë regjistruar nga 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal “Mjekimi i pakujdesshëm” për vitin 2010.

SEKSIONI IV, “KRIME SEKSUALE”

Në Seksionin e Katërt, Kreu i Dytë i Kodit Penal parashikohen Krimet Seksuale.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 2.25 ndërsa për vitin 2010 është 1.97. Është e qartë tendenca për ulje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 0,42% (për qind) për vitin 2009 dhe 0,32 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e katërt Kreu i Dytë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet Seksuale.

Krime Seksuale	2009					2010				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur	19	10	11	12	11	16	10	15	11	9
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me 14-18 vjeç	16	9	11	12	8	9	0	10	0	3
Neni 102 M. Seksuale me dhunë	22	4	16	4	3	16	5	8	5	3
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë	4	2	2	2	0	4	2	3	2	3
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale shpërdorim detyre	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale në gjini	1	1	1	1	0	6	0	4	0	1
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale në vende publike	2	1	2	2	3	1	2	2	4	2
Neni 108 Vepra të turpshme	7	3	4	4	5	11	6	11	8	5
Totali	72	30	47	37	30	63	25	53	30	26

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një ulje prej 12,5 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 16,66 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 12,76 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 18,91 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 13,33 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 71 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 61 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 16,39% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 8 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 44 meshkuj dhe asnjë femër.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 49 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 3 me arsim të mesëm dhe asnjë i pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Të papunë rezultojnë të jenë 34 të pandehur, që do të thotë ulje prej 12,82 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton se 32 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 15 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë, 52 të pandehur.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në uljen e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 101 i Kodit Penal "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjec"**, në vitin 2010, prej 43,75 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjec", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,28 ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0.5 krime për 100. 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 101 "Marredhenie seksuale dhe homoseksuale me dhune me te mitur te moshes 14-18 vjec"




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale prej 45.45% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 28,12% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 30.43% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 vihet re përsëri ulje e procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë prej 43.75% (për qind), për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjec".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë veprë penale theksojmë se nga të dhënat statistikore të organit të prokurorisë rezulton se në Berat janë regjistruar 2 procedime penale; në Durrës, Kavajë dhe Korçë janë regjistruar nga 1 procedim penal dhe në Tiranë janë regjistruar 4 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjec” për vitin 2010.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 102 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitura”**, në vitin 2010, prej 27,27 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitura”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0.5, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0.68 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Sikurse rezulton nga të dhënat statistikore, në vitin 2006 ka rritje të procedimeve penale të regjistruar prej 8,82% (për qind) në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje prej 37,83% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2009 ka ulje 4,34% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 vihet re përsëri ulje prej 27,27% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë veprë penale, rezulton nga të dhënat statistikore se: në Durrës, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Mat, Pogradec dhe Tiranë është regjistruar nga 1 procedim

penal gjatë vitit 2010; në Elbasan janë regjistruar 3 procedime penale; në Lushnje dhe Vlorë janë regjistruar nga 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritur”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, në vitin 2010, prej 5 herë në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,18, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0.03 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Sikurse vihet re edhe nga grafiku, gjatë viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009 në shkallë vendi është regjistruar nga 1 procedim penal; në vitin 2010 janë rregjistruar 6 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”.

Këto procedime janë regjistruar përkatësisht 2 në Dibër; në rrethet Fier, Mat, Tiranë, Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”.

VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

KREU II, SEKSIONI VII

Ne Seksionin e Shtatë Kreu i Dytë i Kodit Penal parashikohen veprat penale kundër lirisë së personit.

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 3,09 ndërsa për vitin 2010 është 3,72. Është e qartë tendenca për rritje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 0,58 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,61 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Shtatë, Kreu i Dytë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet Kundër Lirisë së Personit.

V.P. K/lirise se personit	2009					2010				
	Nr. Proc d. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit	9	1	7	5	2	13	2	3	2	1
Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese	2	0	0	0	1	1	0	0	0	0
Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise	24	3	12	4	5	24	13	19	21	9
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë	42	18	43	31	26	48	16	35	23	19
Neni 111Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 112 Dhunimi i baneses	21	14	17	18	15	33	16	33	24	15
Totali	99	36	79	58	49	119	47	90	70	44

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 20,20 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për krime kundër lirisë së personit në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 30,55 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 13,92 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 20,68 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 10,20 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 124 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 106 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 16,98% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Është ngritur akuzë në gjykatë gjatë vitit 2010 për 70 të pandehur që do të thotë rritje prej 20,68 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 3 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe 1 femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 7 femra dhe 100 meshkuj (rritje prej 31,57%).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 72 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (rritje prej 89,47%) dhe 35 me arsim të mesëm (ulje prej 22,22%) dhe 4 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 3 të pandehur (që do të thotë ulje prej 72,72 % (për qind) në krahasim me vitin 2009). Nga këta, 3 të pandehur janë nëpunës të thjeshtë.

Nga sektori privat janë regjistruar 38 të pandehur (ritje prej 35,71% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 66 (rritje prej 40,42% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 55 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 34,1%) ndërsa 52 prej tyre në komuna (rritje prej 13,04%).


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 106 të pandehur, vetëm 5 prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, përkundrajt 2 të tillë në vitin 2009.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 112 i Kodit Penal “Dhunimi i banesës”**, në vitin 2010, prej 57,14 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal “Dhunimi i banesës”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1.032, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0.65 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka ulje prej 7,4% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 janë regjistruar 25 procedime penale sikurse në vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 16% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 57,14% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 112 "Dhunimi i banesës" i Kodit Penal.

Grafiku paraqet të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike:




Rezulton nga të dhënat statistikore se në Kavajë dhe Sarandë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Berat, Kukës dhe Vlorë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Fier janë regjistruar 3 procedime penale; në Elbasan, Korçë dhe Tiranë janë regjistruar nga 4 procedime penale dhe në Durrës e Gjirokastrë janë regjistruar nga 5 procedime penale gjatë vitit 2010 për veprën penale të parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal “Dhunimi i banesës”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”**, në vitin 2010, prej 14,28 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal “Heqja e paligjshme e lirisë”, për 100 000 banorë në vitin 2010 është 1.5, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1.31 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka ulje prej 7,89% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 42,85% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 16% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 14,28% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 “Heqja e paligjshme e lirisë” i Kodit Penal.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se gjatë vitit 2010 në rrethet Berat, Gjirokastrë, Kukës, Kurbin dhe Lezhë është rregjistruar nga 1 procedim penal; në rrethet Elbasan, Korçë dhe Vlorë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në rrethet Fier, Lushnje, Mat dhe Pukë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 4 procedime penale; në Shkodër dhe Tiranë janë

regjistruar nga 5 procedime penale dhe në Durrës janë regjistruar 11 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 110 “Heqja e paligjshme e lirisë” i Kodit Penal.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca konstante e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 109/b i Kodit Penal “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”**. Në vitin 2010 dhe në vitin 2009 janë regjistruar nga 24 procedime penale për këtë vepër penale.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, për 100 000 banorë në vitin 2010 dhe në vitin 2009 është 0,75 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 janë regjistruar 17 procedime penale përkundrejt 10 procedimeve të regjistruara në vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 29,41% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 është regjistruar numër i njëjtë procedimesh penale për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” i Kodit Penal, 24 procedime penale.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se gjatë vitit 2010, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka regjistruar 14 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 3 procedime; në Lushnje janë regjistruar 4 procedime; në Vlorë, Shkodër dhe Lezhë është regjistruar nga 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal “Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”.

SEKSIONI X, KREU II, VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me veprat penale kundër lirisë së besimit. Sikurse rezulton nga të dhënat statistikore, në këtë grup veprash penale, gjatë vitit 2010 është regjistruar vetëm 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 132 i Kodit Penal “Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit”, kohë në të cilën në vitin 2009 është regjistruar nga 1 procedim penal për të tre veprat penale që përbëjnë këtë seksion të Kodit Penal.

	2009					2010				
	Nr. Procd . Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
VP kunder Personit										
Neni 131 Pengimi i veprimtarive te organizatave fetare	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0
Neni 132 Shkatërrimi ose demtimi I objekteve te kultit	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare	1	1	2	2	2	0	0	0	0	1
Totali	3	2	3	3	2	1	0	0	0	1

TRAFIQET E PALIGJSHME

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 14,49 ndërsa për vitin 2010 është 18,81. Është e qartë tendenca për rritje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 2,73 % (për qind) për vitin 2009 dhe 3,11 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale që lidhen me trafiket e paligjshme:

	2009					2010				
	Nr. Procd . Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Trafikimi Q.Nj										
Neni 110/a Trafikimi i Personave	1	0	0	0	0	9	4	6	6	7
Neni 114/b Trafikimi i femrave	8	5	5	7	5	21	5	12	5	10
Neni 128/b Trafikimi i te miturve	1	0	0	0	5	7	2	9	4	1

Neni 138/a Trafikimi I veprave te artit dhe kultures	2	0	3	0	0	1	1	5	4	0
Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	268	22	27	24	23	343	14	49	15	9
Neni 278/a Trafikimi i armeve dhe i municionit	25	18	23	21	36	30	12	36	18	2
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasuese, djegëse helmuese dhe radioaktive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve	47	32	79	75	91	46	19	64	47	67
Neni 298 Ndhimja per kalim te paligjshem te kufirit	111	102	107	149	183	144	96	139	126	160
Totali	463	179	244	276	343	601	153	320	225	256

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 29,8% (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për trafikim të paligjshme në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 14,52 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar në vitin 2009 prej 31,4 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 18,47 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 25,36 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 415 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 434 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 4,37% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2009 për 276 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë për këtë grup veprash penale, ndërsa për vitin 2010 kjo shifër rezulton të jetë 225 të pandehur të dërguar gjyqit, që do të thotë ulje prej 18,47% (për qind) e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 1 ka qenë i pandehur i mitur mashkull dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 7 femra dhe 293 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2010. Kështu, në vitin 2009 numri i të pandehurve meshkuj ka qenë 355 ndërsa në vitin 2010 rezulton të jetë 293, që do të thotë ulje prej 17,46% (për qind).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 152 (ulje prej 18,71%) të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 144 me arsim të mesëm (ulje prej 17,71%) dhe 6 të pandehur me arsim të lartë, përkundrejt 5 të tillë në vitin 2009.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 2 të pandehur (që do të thotë ulje prej 88,23 % (për qind) në krahasim me vitin 2009. Nga sektori privat janë regjistruar 76 të pandehur (ulje prej 44,52% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 193 (ulje prej 8,96% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.


Rezulton se 169 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 124 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 294 të pandehur, vetëm 4 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 3 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i personave”, në vitin 2010, prej afërsisht 8 herë në krahasim me vitin 2009.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Sikurse vihet re edhe nga grafiku, gjatë viteve 2006, 2007 dhe 2008 janë regjistruar nga 3 procedime penale për këtë veprë penale; në vitin 2009 është regjistruar vetëm 1 procedim penal dhe në vitin 2010 janë regjistruar 9 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal “Trafikimi i personave”.

Ne Tiranë janë regjistruar 7 procedime penale për këtë veprë penale në vitin 2010 dhe 2 procedime penale në Prokurorinë për Krime të Rënda”.


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 114/b i Kodit Penal “Trafikimi i femrave”**. Në vitin 2010 janë regjistruar 21 procedime penale për këtë veprë penale ndërsa në vitin 2009 janë regjistruar 8 procedime penale.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal “Trafikimi i femrave”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,65, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,25 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si më poshtë:

Në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të regjistruara prej 14,28% në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 66,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 60% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2009 ka një rritje prej 162,5% (për qind) në krahasim me vitin 2009, për veprën penale të parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal “Trafikimi i femrave”.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Rrethet Berat, Fier dhe Sarandë kanë regjistruar nga 1 procedim penal për këtë vepër penale dhe 18 procedime penale janë regjistruar pranë Prokurorisë për Krime të Rënda.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 128/b i Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”**, në vitin 2010; janë regjistruar 7 procedime penale përkundrejt 1 procedimi penal gjatë vitit 2009.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Procedimet në lidhje me këtë veprë penale janë regjistruar pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe 1 procedim penal është regjistruar në Prokurorinë e rrethit Gjyqësor Korçë.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni **141/a i Kodit Penal "Trafikimi i mjeteve motorike"**, në vitin 2010, prej 27,98 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal "Trafikimi i mjeteve motorike", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 10,73, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 8,39 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Vihet re ulje e procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2007 prej 2,99% (për qind) në krahasim me vitin 2006; ka rritje në vitin 2008 prej 75,3% (për qind) në krahasim me vitin 2007; rezulton me ulje 5,63% (për qind) numri i procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka një rritje prej 27,98% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale, në krahasim me vitin 2009.


Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike e veprës penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal "Trafikimi i mjeteve motorike" dhe përqindjet përkatëse për çdo rreth:



Më poshtë paraqitet grafikisht edhe shpërndarja gjeografike për këtë vepër penale gjatë viteve 2009-2010:

Në Berat janë regjistruar 9 procedime penale gjatë vitit 2010, përkundrejt 7 procedimeve në vitin 2009; në Dibër janë regjistruar 2 procedime penale përkundrejt asnjë procedimi të regjistruar gjatë vitit 2009; në Durrës janë regjistruar 50 procedime penale gjatë vitit 2010 ose rritje prej 56,25% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Elbasan janë regjistruar 18 procedime penale përkundrejt 4 procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2009; në Fier në të dy vitet janë regjistruar nga 21 procedime penale; në Gjirokastrë në vitin 2009 janë regjistruar 12 procedime penale ndërsa në vitin 2010 janë regjistruar 13 procedime penale; në Kavajë, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 2 procedime penale, përkundrejt 6 procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2009, që do të thotë ulje prej 66,66% (për qind); në Krujë, janë regjistruar 3 procedime penale gjatë vitit 2010 përkundrejt 5 në vitin 2009; në Kukës ka rritje të procedimeve penale të regjistruar prej 66,66% në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009; në Lezhë janë regjistruar 4 procedime penale në vitin 2010 që do të thotë ulje prej 55,55% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Pogradec janë regjistruar 11 procedime penale në vitin 2010, pra një rritje prej 83,33% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Sarandë janë regjistruar 11 procedime penale ose rritje prej 266,66% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Shkodër janë regjistruar 24 procedime penale ose rritje prej 41,17% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Tiranë janë regjistruar 116 procedime penale që do të thotë rritje prej 20,83% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Vlorë janë regjistruar 20 procedime penale gjatë vitit 2010, përkundrejt 22 të tillë në vitin 2009.


Neni 141/a "Trafikimi i mjeteve motorike"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 278/a i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”**, në vitin 2010, prej 20 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0.93, ndërsa për vitin 2009 ka qënë 0.78 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në vitin 2007 janë regjistruar 35 procedime penale për këtë veprë penale, ndërsa në vitin 2006 janë regjistruar 8 procedime; në vitin 2008 ka ulje prej 5,71% (për qind) të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 24,24% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka rritje prej 20% të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal "Trafikimi i armëve dhe i municionit".


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike theksojmë se për këtë veprë penale gjatë vitit 2010 janë regjistruar 7 procedime penale në Kavajë; 1 procedim penal në Kukës, Sarandë dhe Shkodër; nga 10 procedime penale ka regjistruar Prokuroria e rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 10 procedime penale prokuroria për Krime të Rënda.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca konstante e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 283/a i Kodit Penal "Trafikimi i narkotikëve"**, në vitin 2010 janë regjistruar 46 procedime dhe në vitin 2009 janë regjistruar 47 procedime.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal "Trafikimi i narkotikëve", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,43, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1.74 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 283/a "Trafikimi i narkotikeve"




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 25,71% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 47,72% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 27,69% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 2,12% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a "Trafikimi i narkotikëve" i Kodit Penal.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 298 i Kodit Penal "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit"**, në vitin 2010, prej 29,72% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 298i Kodit Penal "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 4.5, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,47 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):


Neni 298 "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit"



Sa më sipër, në vitin 2007 ka rritje prej 31% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 6,76% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 49,77% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka rritje prej 29,72% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit".

Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike e kësaj vepre penale gjatë vitit 2010.

Neni 298 "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit"



Në Dibër dhe Lezhë janë regjistruar nga 1 procedim penal; në Lushnje dhe Kavajë janë regjistruar 2 procedime penale; në Fier dhe Shkodër janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 5 procedime penale; në Kukës janë regjistruar 6 procedime penale; në Berat janë regjistruar 7 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 8 procedime penale; në Tiranë janë regjistruar 11 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 22 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 28 procedime penale dhe në Gjirokastrë janë regjistruar 43 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit".

VEPRAT PENALE, TË PRODHIMIT, TRAFIKIM, KULTIVIMIT DHE SHITJES TË NARKOTIKËVE

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 19,38 ndërsa për vitin 2010 është 19,74. Është e qartë tendenca për rritje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 3,66 % (për qind) për vitin 2009 dhe 3,27 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të narkotikëve, kultivimit dhe shitjes së tyre .

Kultivim, Prodhim, Narkotikeve	2009					2010				
	Nr. Proc d. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pan d. Regj .	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 283 Prodhim & shitje	339	211	332	332	309	442	287	547	405	297
Neni 284 Kultivim i bimeve narkotike	280	59	46	135	57	186	32	62	37	37
Neni 284/a Organizim & drejtim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope	0	0	0	0	2	1	1	1	1	0
Neni 285 Mbajtja prodhimi dhe transportimi i sustancave kimike	0	0	0	0	0	2	2	2	4	3
TOTALI	619	270	378	467	368	631	322	612	447	337

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 1,94 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për lëndët narkotike në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 19,3 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 62 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 4,3 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 8.42 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 721 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 597 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 20,77% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010 është ngritur akuzë në gjykatë për 447 të pandehur dhe në vitin 2009 për 467 të pandehur, që do të thotë ulje prej 4,28% (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 27 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe 1 femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 14 femra dhe 467 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton ulje e të pandehurve femra në vitin 2010. Kështu, në vitin 2009 numri i të pandehurve femra ka qenë 18 ndërsa në vitin 2010 rezulton të jetë 14, pra është ulur 22,22% (për qind). Me rritje rezulton edhe treguesi i të pandehurve të mitur meshkuj në vitin 2010, 27 të tillë, përkundrejt vitit 2009 kur janë regjistruar 12 të pandehur të mitur meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 368 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 135 me arsim të mesëm dhe 7 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar. Në rritje rezultojnë të jenë të gjithë këta tregues në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009. Ajo që bie në sy është fakti se kemi rritje në vitin 2010 të të pandehurve

më arsim të lartë, janë regjistruar 7 të tillë në vitin 2010 përkundrejt 2 të pandehurve me arsim të lartë në vitin 2009.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 6 të pandehur “nëpunës i thjeshtë”, në vitin 2010 përkundrejt vitit 2009 kur nuk është regjistruar asnjë i pandehur.

Nga sektori privat janë regjistruar 72 të pandehur (rritje prej 5,88% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 289 (rritje prej 11,58% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 319 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 192 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 475 të pandehur, vetëm 12 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 23 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, në vitin 2010, prej 30,38 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 13,83, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 10,61 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në vite, 2005-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Në vitin 2006 ka rritje prej 81,76% të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje prej 18,33% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 30,93% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 9,7% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka përsëri rritje të ndjeshme të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Më poshtë paraqitet grafiki shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve":

Në Krujë janë regjistruar 3 procedime penale; në Kurbin 5 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 6 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 6 procedime penale; në Lushnje janë regjistruar 10 procedime penale; Kavajë dhe Sarandë janë regjistruar nga 14 procedime penale; në Berat janë regjistruar 18 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 19 procedime penale; në Fier janë regjistruar 25 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 34 procedime penale; në Gjirokastër janë regjistruar 35 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 36 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 41 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 54 procedime penale; dhe në Tiranë janë regjistruar 118 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Neni 283 "Prodhimi dhe shitja e narkotikeve" 2010




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 284 i Kodit Penal "Kultivimi i bimëve narkotike"**, në vitin 2010, prej 33,57 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal "Kultivimi i bimëve narkotike", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 5,82, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 8,76 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në vitet 2005-2010 paraqitet si më poshtë:


Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 ka ulje prej 68,25% (për qind) në krahasim me vitin 2005 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale prej 86,39% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje 33,57% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 23,49% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka përsëri ulje prej 33,57% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal "Kultivimi i bimëve narkotike".

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2010 për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal "Kultivimi i bimëve narkotike", si dhe përqindjet përkatëse.

Neni 284 "Kultivimi i bimeve narkotike" 2010



Nga të dhënat statistikore rezulton se ka një ulje të procedimeve penale në Fier për vitin 2010 prej 90% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Gjirokastër ka ulje prej 47,6% (për qind); në Korçë ka rritje prej 62,5% në krahasim me vitin 2009; në Krujë ka ulje prej 86,36% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Mat në vitin 2009 janë regjistruar 3 procedime penale për këtë veprë penale ndërsa në vitin 2010 janë regjistruar 7 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 89 procedime penale në vitin 2009 dhe 96 për vitin 2010 që do të thotë rritje prej 7,86% në vitin 2010 dhe në Vlorë janë regjistruar 10 procedime penale në vitin 2010, përkundrajt 66 procedimeve të regjistruara në vitin 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal "Kultivimi i bimëve narkotike".

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME SHFRYTËZIMIN E PROSTITUCIONIT

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 2,28 ndërsa për vitin 2010 është 2,56. Është e qartë tendenca për rritje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 0,43 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,0025 % (për qind) për vitin 2010 përkundrajt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale për prostitucionin dhe shfrytëzimin e prostitucionit:

	2009					2010				
	Nr. Procd . Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand enua r	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand enua r
Shfrytëzimi i Prostitucionit										
Neni 113 Prostitucioni	37	28	45	43	39	29	19	35	32	29
Neni 114 Shfrytezim prostitucioni	16	10	8	12	14	11	1	11	6	3
Neni 114/a Shfrytezim prostitucioni renduese	19	11	11	21	24	41	11	27	15	12
Neni 115 Mbajtja e lokaleve per prostitucion	1	1	3	3	1	1	3	3	4	2
TOTALI	73	50	67	79	78	82	34	76	57	46

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 12,32 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për këto grup veprash penale në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 32 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 13,43 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 27,84 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 41 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 96 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 89 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 7,86% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2010 për 57 të pandehur është ngritur akuza në gjykatë dhe në vitin 2009 ky tregues është 79ë, që do të thotë ulje prej 27,84% (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 2 kanë qenë të pandehur të mitur femra; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 45 femra dhe 36 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton rritje e të pandehurve femra në vitin prej 25% (për qind), dhe ulje e të pandehurve meshkuj prej 25% (për qind) për këtë grup veprash penale.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 54 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 19 me arsim të mesëm dhe asnjë të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur për këtë grup veprash penale në vitin 2010.

Të papunë rezultojnë të jenë 36 të pandehur, që do të thotë ulje prej 16,27 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton se 51 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 20 prej tyre në komuna. Pra, tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 68 të pandehur, vetëm 6 prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni”**, në vitin 2010, prej 21,62 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0.9, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,15 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Sikurse vihet re nga grafiku, rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 36,11% (pr qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 44,89% (për

qind) të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 37% në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka ulje prej 21,62% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni”.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, vihet re nga të dhënat statistikore se rrethet: Berat, Dibër, Lushnje, Sarandë dhe Vlorë kanë regjistruar nga 1 procedim penal për këtë vepër penale gjatë vitit 2010; në rrethet Fier, Korçë, Pogradec dhe Shkodër janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 3 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 4 dhe në Tiranë janë regjistruar 9 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 114/a i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”**, në vitin 2010, prej 115,78% (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,28, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,59 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si më poshtë: në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të regjistruar për këtë vepër penale prej 1627% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 2,77% në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje të theksuar prej 48,64% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka rritje të ndjeshme prej 115,78% (për qind) të procedimeve penale të regjistruar pranë organit të prokurorisë për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal “Shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese”.

Sa më paraqitet në grafikun që vijon:



Më poshtë paraqitet grafiksht shpërndarja gjeografike për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a "Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese", dhe përqindjet përkatëse.



Në rrethet Kavajë, Krujë, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale gjatë vitit 2010. Në Kukës janë regjistruar 2 procedime penale. Në rrethet Berat, Durrës, dhe Korçë janë regjistruar nga 4 procedime penale për këtë veprë penale; në Elbasan dhe Fier janë regjistruar nga 5 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 12 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal "Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese".

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME KORRUPSIONIN

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 2,69 ndërsa për vitin 2010 është 3,5. Ka tendencë për rritje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 0,50 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,58 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e lehtë e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për veprat penale në lidhje me korrupsionin:

	2009					2010				
	Nr. Proc d. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pan d. Regj .	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenu ar	Nr. Proc d Regj	Nr. proce d per gjykim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenu ar
V.P. Korrupsion dhe te lidhura me detyren										
Neni 164/a Korrupsion aktiv privat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 164/b Korrupsion pasiv privat	2	1	2	2	5	4	4	5	10	15
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave me funksione publike	2	2	5	5	2	1	0	2	7	0
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionare te	7	1	1	2	6	4	2	8	7	5
Neni 245/1 ushtrimi i ndikimit te pers. te paligj. ndaj persona. qe ushtr. funks.publik	6	3	6	6	3	12	10	13	22	13
Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike	63	16	30	34	20	79	33	68	66	11
Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionareve te larte	1	1	0	2	0	4	2	3	2	1
Neni 312 Korrupsioni aktiv i deshmitarit,ekspertit ose perkthyesit	2	1	0	2	0	1	0	0	0	2
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit	0	0	0	0	0	1	0	0	1	0
Neni 319/a Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit	2	0	0	0	0	6	3	2	5	2
Neni 328 Dhenia e shperblimeve,	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	86	25	44	53	36	112	54	101	120	49

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 30,23 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me korrupsionin në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 116 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 129,54 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 126,41 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 36,11 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 151 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 89 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 69,66% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në të vitin 2010, ka rritje të të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 126,41% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, të rritur (mbi 18 vjec) 9 femra janë regjistruar për vitin 2010, përkundrejt vitit 2009 kur nuk rezulton asnjë e pandehur femër për këtë grup veprash penale; 92 meshkuj të pandehur rezultojnë për vitin 2010, që do të thotë rritje prej 113,95 në krahasim me vitin 2009. Gjithashtu, për vitin 2010 rezulton edhe 1 i pandehur i huaj për këtë grup veprash penale.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 3 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar, 48 të pandehur me arsim të mesëm (që do të thotë rritje 220 për qind) dhe 49 të pandehur me arsim të lartë (që do të thotë rritje prej 132,55 për qind).

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 34 të pandehur (që do të thotë rritje prej 36 % (për qind) në krahasim me vitin 2009). Nga këta, 1 i pandehur është funksionar, dhe 3 të pandehur janë nëpunës të nivelit të lartë, 5 të pandehur nëpunës i nivelit të ulët dhe 25 të pandehur janë nëpunës i thjeshtë.

Nga sektori privat janë regjistruar 10 të pandehur (rritje nga 3 të tillë për vitin 2009) dhe të papunë 4 të pandehur (ulje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2009).

Rezulton se 87 të pandehur kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 24 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë, 101 të pandehur, për vitin 2010, përkundrejt vitit 2009 kur rezultojnë 34 të pandehur të papunë për këtë grup veprash penale.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 245 Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”**, në vitin 2010, prej 42,85 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Është rritur numri i të pandehurve të regjistruar për këtë veprë penale. Kështu, në vitin 2010 janë regjistruar 8 të pandehur, përkundrejt 1 të pandehuri të regjistruar në vitin 2009; për 7 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë gjatë vitit 2010, përkundrejt 2 të pandehurve të dërguar në gjykatë në vitin 2009. Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, nga të dhënat statistikore, rezulton se në rrethet, Tiranë, Shkodër, Fier dhe Korçë është regjistruar nga 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i funksionrëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”.


Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 245/1 i Kodit Penal “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”**, në vitin 2010, prej 100 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,37, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,18 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të kësaj veprë penale, rezulton nga të dhënat statistikore se në Durrës, Korcë, Krujë, Lezhë, Shkodër dhe Fier është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale; në Elbasan janë regjistruar 4 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 259 i Kodit Penal "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike"**, në vitin 2010, prej 25,39 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2.47, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,97 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Sikurse vihet re, në vitin 2007 ka rritje prej 21,42% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 73,52% (për qind) në krahasim me vitin 2007, në vitin 2009 ka rritje prej 6,77% (për qind) të procedimeve penale të regjistruar për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 vihet re përsëri rritje e procedimeve penale të regjistruara prej 25,39% (për qind) në krahasim me vitin 2009, për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike nga të dhënat statistikore rezultojnë se në rrethet Kavajë, Kukës dhe Lushnjë është regjistruar nga 1 procedim penal, në Durrës dhe Sarandë janë regjistruar nga 3 procedime penale, në Gjirokastrë dhe Shkodër janë regjistruar nga 4 procedime penale, në Vlorë janë regjistruar 5 procedime penale, në Berat dhe Elbasan janë regjistruar nga 6 procedime penale, në Korçë janë regjistruar 9 procedime penale; në Fier janë regjistruar 14 procedime penale, përkundrajt 6 të tilla të regjistruara në vitin 2009, në Tiranë janë regjistruar 22 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 259 "Korrupsioni pasiv i personave qe ushtrojne funksione publike"




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 260 i Kodit Penal "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë"**, në vitin 2010, janë regjistruar 4 procedime penale për këtë vepër penale, përkundrajt vitit 2009 kur është regjistruar vetëm 1 procedim penal. Këto procedime janë regjistruar 3 në Pogradec dhe një procedim penal në Lezhë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 319/a i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”**, në vitin 2010, janë regjistruar 6 procedime penale për këtë vepër penale pranë organit të prokurorisë, përkundrejt 2 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2009.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në lidhje me këtë vepër penale, rrethet Durrës, Fier, Gjirokastrë dhe Tiranë kanë regjistruar nga 1 procedim penal dhe në Vlorë janë regjistruar 2 procedime penale.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME DETYRËN

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 14,68 ndërsa për vitin 2010 është 13,23. Është e qartë tendenca për ulje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 2,77 % (për qind) për vitin 2009 dhe 2,19 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale në lidhje me detyrën

V.P. te lidhura me detyren shteterore	2009					2010				
	Nr. Proc. d. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Proc. d. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
Neni 248 Shperdorim detyre	399	72	86	154	127	365	65	134	126	79
Neni 249 Kryerja e funksionit pas dhenies fund te tij	3	1	2	1	1	4	2	0	2	1
Neni 70 KPU Shperdorim detyre	2	0	4	0	0	6	2	5	4	0
Neni 250 Veprime arbitrare	41	6	9	7	9	29	5	16	9	4
Neni 251 Mosmarrja e masave per te nderprere gjendjen e paligjshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 252 Mbajtja ne burg pa vendim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 253 Shkelja e barazise se shtetasve	1	0	2	0	0	0	0	0	0	0
Neni 254 Shkelja e paprekshmerise se baneses	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 255 Pengimi dhe shkelja e fshehtesise se korrespondences	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 256 Shperdorim i kontributeve te dhena nga shteti	1	0	0	0	0	1	1	11	11	11
Neni 257 Perfitim i paligjshem	0	0	0	0	2	3	1	1	1	0
Neni 257/a Refuzimi per deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rrem i pas. te pers te zgj. dhe nenp. Publ.	12	10	8	10	8	11	8	7	8	5
Neni 258 Shkelja e barazize ne tendera	10	7	1	34	28	3	4	3	17	13
TOTALI	469	96	112	206	175	423	88	177	178	113

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një ulje prej 9,8 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për krime të lidhura me detyrën në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 8,33 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 58,04 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 13,59 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 35,42 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 305 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 296 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 3% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Për 174 të pandehur gjatë vitit 2010 është ngritur akuzë në gjykatë, ose ulje prej 15,53% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në treguesin e gjinisë së të pandehurve, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton rritje e të pandehurve femra në vitin 2010. Kështu, në vitin 2009 numri i të pandehurve femra ka qenë 18 ndërsa në vitin 2010 rezulton të jetë 24, pra është rritur 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Edhe për të pandehurit meshkuj rezulton rritje në vitin 2010 prej 24,83% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 26 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (përkundrejt 9 të pandehurve në vitin 2009) dhe 70 me arsim të mesëm (përkundrejt 39 në vitin 2009) dhe 113 të pandehur me arsim të lartë (përkundrejt 117 në vitin 2009).

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 124 të pandehur (që do të thotë ulje prej 2,36 % (për qind) në krahasim me vitin 2009). Nga këta, 5 të pandehur janë funksionarë (ulje prej 58,33%), 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të lartë (përkundrejt 9 të tillë në vitin 2009); 28 të pandehur janë nëpunës të nivelit të mesëm (rritje prej 12%); 31 të pandehur rezultojnë të jenë nëpunës të nivelit të ulët (rritje prej 40,9%); 3 të pandehur nëpunës të nivelit ekzekutues (përkundrejt 10 të tillë në vitin 2009) dhe 56 të pandehur janë nëpunës të thjeshtë (përkundrejt 49 të tillë në vitin 2009).

Nga sektori privat janë regjistruar 23 të pandehur (rritje prej 109% përqind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 26 (përkundrejt 5 të tillë në vitin 2009) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton se 152 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 40,74%) ndërsa 56 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 203 të pandehur (rritje prej 23,78%), vetëm 3 prej tyre është përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 2 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.


TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës”**, në vitin 2010, prej 8,52 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 11,42, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 12,49 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale prej 11,64% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 52,41% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 15,82% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka ulje të procedimeve penale të regjistruara prej 8,52% (për qind) në krahasim me vitin 2009.




Më poshtë paraqitet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal "Shpërdorimi i detyrës".



Rezulton nga të dhënat statistikore se në rrethet Kurbin dhe Lushnje janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 4 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 5 procedime penale; në Krujë, Kukës dhe Pogradec janë regjistruar nga 7 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 8 procedime penale; në Durrës, Gjirokastrë dhe Pukë janë regjistruar nga 9 procedime penale; në Mat, janë regjistruar 14 procedime penale; në Berat janë regjistruar 17 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 19 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 29 procedime penale; në Fier janë regjistruar 30 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 32 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 33 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 40 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 79 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës”.

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për vitet 2009-2010:


Neni 248 "Shperdorimi i detyres"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 250 i Kodit Penal "Kryerja e veprimeve arbitrare"**, në vitin 2010, prej 29,26 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal "Kryerja e veprimeve arbitrare", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,9, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1.28 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 27% (për qind) të procedimeve penale të regjistruar për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje 63% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 46,75% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka ulje prej 29,26% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal "Kryerja e veprimeve arbitrare".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se në rrethet Berat, Durrës, Gjirokastrë, Pukë, Sarandë dhe Shkodër është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë vepër penale; në rrethet Dibër, Fier dhe Korçë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 6 procedime penale; në Tiranë janë regjistruar 8 procedime penale dhe në Vlorë janë regjistruar 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal "Kryerja e veprimeve arbitrare".

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 250 "Kryerja e veprimeve arbitrare"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 258 i Kodit Penal "Shkelja e barazisë në tendera"**. Kështu, në vitin 2010 janë regjistruar 3 procedime penale për këtë veprë penale, përkundrajt 10 procedimeve të regjistruar në vitin 2009. Procedimet janë regjistruar në rrethet Berat, Durrës dhe Elbasan, përkatësisht nga 1 procedim penal.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 258 "Shkelja e barazise ne tendera"



VEPRA PENALE NË LIDHJE ME PASTRIMIN E PARAVE

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 1,59 ndërsa për vitin 2010 është 2. Është e qartë tendenca për rritje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 0,3 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,33 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna me veprat penale që lidhen me pastrimin e parave:

Pastrimi i Parave	2009					2010				
	Nr. Procd. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 287 Produktet e vepres penale	41	1	5	1	1	59	0	23	3	1
Neni 287/a Llogari anonime	1	0	0	0	2	1	0	0	0	0
Neni 287/b Pervetesimi i parave	9	10	12	17	15	5	5	14	19	12
Totali	51	11	17	18	18	65	5	37	22	13

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 27,45 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e parave në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 54,54 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar në vitin 2010, janë regjistruar 37 të pandehur, përkundrejt vitit 2009 kur rezultojnë 17 të pandehur të regjistruar; një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 22,22 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 27,77 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 49 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 26 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 88,46% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010 është ngritur akuzë në gjykatë për 22 të pandehur, që do të thotë rritje e këtij treguesi prej 22,22% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 18 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 7 me arsim të mesëm.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori shtetëror nuk është regjistruar asnjë i pandehur. Nga të punësuarit, 8 të pandehur të punësuar nga sektori privat

Të papunë rezultojnë të jenë 13 të pandehur, përkundrejt vitit 2009, kur rezultojnë 12 të tillë.

Rezulton se 17 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 8 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 22 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 2 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale”**, në vitin 2010, prej 43,9% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,84, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,28 krime për 100 000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Sikurse rezulton nga të dhënat statistikore në përgjithësi, të dhënat flasin për një tendencë përgjithësisht në rritje të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë për vitet 2006-2010.

Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal " Pastrimi i produkteve të vepres penale" për vitin 2010:

Neni 287 "Pastrimi i produkteve te vepres penale"



Rezulton se: në rrethet Lezhë dhe Shkodër është regjistruar nga 1 procedim penal; në Elbasan dhe Lushnje janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Berat dhe Pogradec janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Gjirokastrë janë regjistruar 4 procedime penale; në Durrës dhe Vlorë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 10 procedime penale; në Fier janë regjistruar 11 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 12 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale”.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME KRIMIN E ORGANIZUAR

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 0,12 ndërsa për vitin 2010 është 0,09.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 0.023 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,015 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për veprat penale që lidhen me krimin e organizuar .

Krimi i Organizuar	2009					2010				
	Nr. Proc d. Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj .	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denu ar
Neni 333 Organizata kriminale	0	0	0	0	10	0	0	0	0	7
Neni 333/a Grupi i strukturuar kriminal	4	1	10	2	13	3	3	16	15	7
Neni 334 Kryerja e veprave penale nga org. kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	4	1	10	2	23	3	3	16	15	14

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 janë regjistruar 3 procedime penale për këtë grup veprash penale, përkundrejt vitit 2009 kur janë regjistruar 4 procedime penale. Ndërkaq kemi 3 procedime të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 60 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 6,5 herë dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 39,1 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 26 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 13 të pandehur në hetim.

Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 100% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010, për 15 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë, përkundrejt vitit 2010 kur rezultojnë 2 të tillë, që do të thotë një rritje prej 6,5 herë në vitin 2010 të këtij treguesi në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me moshën e të pandehurve 29 kanë qenë të rritur (mbi 18 vjec) meshkuj, përkundrejt 10 të tillëve në vitin 2009.


Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 7 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 21 të pandehur me arsim të mesëm. Të dy këta tregues rezultojnë me rritje në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 15 të pandehur (rritje prej 150% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 14 (rritje prej 250% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton se 10 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 19 prej tyre në komuna.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të pandehurit janë të padënuar më parë.

Ecuria në vitet 2006-2010 për veprën penale të parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal "Grupi i strukturuar kriminal", paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka një rritje prej 33,33% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 16,66%

(për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 vihet re përsëri ulje prej 60% (për qind) e procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010, rezultotn përsëri me ulje, nurmi i procedimeve penale të regjistruar prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE, KREU III, SEKSIONI I, “VJEDHJA E PASURISË”

Në Seksionin e Parë, Kreu i Tretë i Kodit Penal parashikohen Vjedhja e Pasurisë.

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 176,46 ndërsa për vitin 2010 është 241,19. Është e qartë tendenca për rritje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 33,32 % (për qind) për vitin 2009 dhe 39,95 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna për veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Parë, Kreu i Tretë i Kodit Penal dhe konkretisht me Veprat penale Kundër Pasurisë.

Vjedhja e Pasurisë	2009					2010				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 134 Vjedhja	5263	1018	1450	1457	1140	6524	1283	1779	1806	1550
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shpërd. detyrën	59	43	35	42	31	77	45	48	67	35
Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursim.	9	2	2	4	0	9	0	3	0	7
Neni 137 Vjedhja e energjisë elektr. ose imp. telefonik	106	98	66	101	166	819	461	503	461	316
Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës	1	0	0	0	0	5	0	0	0	0
Neni 139 Vjedhja me dhunë	109	43	54	69	62	135	43	81	73	59
Neni 140 Vjedhja me armë	84	18	29	24	18	126	29	54	45	30
Neni 141 Vjedhja me pasojë vdekjen	5	3	5	3	2	6	4	8	8	4
Neni 142 Sigurimi i mjeteve për vjedhje	0	0	0	0	0	5	4	6	5	2
Totali	5636	1225	1641	1700	1419	7706	1869	2482	2465	2003

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 36,73 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër pasurisë në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 52,57% (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij

totali në vitin 2009 prej 51,2% (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 45 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 41,2 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 3157 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 2157 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 46,36% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010, për 2465 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë, përkundrejt 1700 në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 45% (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 505 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe 2 femra (të mitur); në total shifra e të pandehurve të mitur rezulton të jetë rritur 30% (për qind); të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 58 femra (rritje prej 123% në krahasim me vitin 2009) dhe 1730 të pandehur meshkuj (që do të thotë rritje prej 66,18% përqind).

Rezulton 1 shtetas i huaj i regjistruar për këtë grup veprash penale gjatë vitit 2010.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 1763 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 476 me arsim të mesëm dhe 34 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 30 të pandehur që do të thotë rritje prej 66,66 % (për qind) në krahasim me vitin 2009. Nga këta, 14 të pandehur janë nëpunës të nivelit të mesëm dhe 2 nëpunës të nivelit të ulët, përkundrejt nga 1 të pandehur për të dy këta tregues për vitin 2009;13 të pandehur janë nëpunës të thjeshtë.

Nga sektori privat janë regjistruar 254 të pandehur (rritje prej 202% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 1384 (rritje prej 27,32% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 1469 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 818 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 1994 të pandehur, 157 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 135 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.


TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni **134 i Kodit Penal “Vjedhja”**, në vitin 2010, prej 23,95 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 204,19, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 164,78 krime për 100.000 banorë.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 31,12 % (për qind) për vitin 2009 dhe 33,82 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezulton nga të dhënat statistikore se ka një rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 9% (për qind) në vitin 2007 në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 19,56% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 20,76% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka rritje të procedimeve penale të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike nga të dhënat statistikore rezultojn se:


Në vitin 2009 dhe në vitin 2010 rrethet me problematikë më të madhe në lidhje me këtë veprë penale janë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Korçë, Shkodër, Sarandë dhe Fier. Kështu në Tiranë në vitin 2010 janë regjistruar 2203 procedime penale ndërsa në vitin 2009 janë regjistruar 1894 procedime penale, që do të thotë rritje prej 16,31% (për qind) e procedimeve penale të regjistruara në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009; në Durrës ka rritje prej 29% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009; në Vlorë ka rritje prej 53,86 (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009; në Elbasan ka rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 13% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Korçë ka rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 5,68% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Shkodër ka rritje prej 28,76% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009; në Sarandë ka rritje të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale prej 31,57% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Fier ka rritje të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale prej 6,28% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Lezhë ka rritje prej 60% të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2009; në Lushnje ka rritje prej 32% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2009.

NENI 134 "VJEDHJA"



Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike shpërndarja gjeografike sipas rretheve e procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal "Vjedhja" për vitet 2009 dhe 2010.


NENI 134 "VJEDHJA"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”**, në vitin 2010, prej 30,50 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2.41, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,84 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 48,71% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 36,20% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 25,31% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 30,50% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën” i Kodit Penal.


Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara sipas rretheve për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”.

Neni 135 "Vjedhja duke shperdoruar detyren"



Rezulton nga të dhënat statistikore se: në Berat gjatë vitit 2010 janë regjistruar 2 procedime penale, në vitin 2009 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në Dibër, gjatë vitit 2010 janë regjistruar 3 procedime penale, në vitin 2009 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në Durrës janë regjistruar 5 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë ulje prej 28,57% në krahasim me vitin 2009; në Elbasan janë regjistruar 3 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë ulje prej 50% (për qind); në Fier janë regjistruar 4 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë ulje prej 42,85% në krahasim me vitin 2009; në Gjirokastrë gjatë vitit 2010 është regjistruar 1 procedim penal, në vitin 2009 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në Kavajë gjatë vitit 2010 janë regjistruar 2 procedime penale, në vitin 2009 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në Korçë janë regjistruar 5 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 66,66% në krahasim me vitin 2009; në Krujë nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale, përkundrajt vitit 2009 kur është regjistruar vetën 1 procedim penal për këtë veprë penale; në Kukës në të dy vitet janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Kurbin gjatë vitit 2010 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale, përkundrajt vitit 2009 kur është regjistruar vetën 1 procedim penal; në Lezhë gjatë vitit 2010 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penal, përkundrajt vitit 2009 kur janë regjistruar 3 procedime penale; në Lushnje dhe Mat, gjatë vitit 2010 është regjistruar nga 1 procedim penal, përkundrajt vitit 2009 kur nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në Pogradec janë regjistruar 4 procedime penale gjatë vitit 2010, përkundrajt vitit 2009 kur është regjistruar vetëm 1 procedim penal; në Pukë gjatë vitit 2010 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale, përkundrajt vitit 2009 kur është regjistruar 1 procedim penal; në Sarandë në të dy vitet nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në Shkodër gjatë vitit 2010 janë regjistruar 5 procedime penale, përkundrajt 2 të tillë në vitin 2009; në Tiranë janë regjistruar 29 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 38,09% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Tropojë në të dy vitet nuk është regjistruar asnjë procedim penale për këtë veprë penale dhe në Vlorë janë regjistruar gjatë vitit 2010 11 procedime penale për këtë veprë penale, përkundrajt vitit 2009 kur janë regjistruar 5 procedime penale për këtë veprë penale.


Neni 135 "Vjedhja duke shperdoruar detyren" 2009-2010



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”**, në vitin 2010, prej afërsisht 7 herë në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 25,63, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,31 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej afërsisht 3 herë të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 16,38% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje të procedimeve penale prej 69,88% në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka një rritje të ndjeshme prej afërsisht 7 herë të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në Korçë dhe Pukë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Kavajë janë regjistruar 2 procedime penale; në Berat janë regjistruar 4 procedime penale; në Kurbin janë regjistruar 9 procedime penale; në Lushnje janë regjistruar 12 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 15 procedime penale; në Mat janë regjistruar 26 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 34 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 44 procedime penale; në Fier janë regjistruar 47 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 88 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 119 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 175 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 242

procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja më dhunë”**, në vitin 2010, prej 23,85 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal “Vjedhja më dhunë”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 4,22, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,41 krime për 100 000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si vijon: në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të regjistruara prej 32,22% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 70,49% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 4,8% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka përsëri rritje

prej 23,85% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009, për veprën penale të parashikuar në neni 139 të Kodit Penal "Vjedhja me dhunë".



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se: rrethet Berat, Tropojë dhe Kukës është regjistruar nga 1 procedim penale gjatë vitit 2010; në Pogradec janë regjistruar 2 procedime penale; në Gjirokastrë, Krujë janë regjistruar nga 3 procedime penale; dhe Lezhë, Shkodër dhe Lushnje janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Kurbin janë regjistruar 5 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 6 procedime penale; në Elbasan dhe Korçë janë regjistruar 7 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 8 procedime penale; në Fier janë regjistruar 10 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 18 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 51 procedim penale për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal "Vjedhja me dhunë".


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Rezulton nga të dhënat statistikore se në Berat është regjistruar vetëm 1 procedim penal përkundrejt 3 procedimeve të regjistruara në vitin 2009; në Tropojë dhe Kukës është regjistruar nga 1 procedim penal gjatë vitit 2010, përkundrejt asnjë procedimi të regjistruar për vitin 2009; në Pogradec gjatë vitit 2010 janë regjistruar 2 procedime penale, përkundrejt 1 procedimi të regjistruar gjatë vitit 2009; në Gjirokastrë në vitin 2010 janë regjistruar 3 procedime penale gjatë vitit 2010, përkundrejt vitit 2009 kur janë regjistruar 2 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 3 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë ulje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Lezhë janë regjistruar 4 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 100% (për qind); në Lushnje janë regjistruar 4 procedime penale gjatë vitit 2010, që do të thotë ulje prej 20% në krahasim me vitin 2009; në Shkodër janë regjistruar 4 procedime penale në vitin 2010, përkundrejt 1 procedimi të regjistruar në vitin 2009; në Kurbin janë regjistruar 5 procedime penale në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 66,66% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Sarandë janë regjistruar 6 procedime penale, që do të thotë rritje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Elbasan janë regjistruar 7 procedime penale, përkundrejt 3 procedimeve të regjistruara në vitin 2009; në Korçë janë regjistruar 7 procedime penale në vitin 2010, që do të thotë ulje prej 12,8% (për qind) në krahasim me vitin 2009; në Vlorë janë regjistruar 8 procedime penale; përkundrejt 7 procedimeve të regjistruara në vitin 2009; në Fier janë regjistruar 10 procedime penale, përkundrejt vitit 2009 kur është regjistruar vetëm 1 procedim penal; në Durrës janë regjistruar 18 procedime penale në vitin 2009, përkundrejt 20 procedimeve të regjistruara në vitin 2010 dhe në Tiranë janë regjistruar 51 procedime penale në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 30,76% (për qind) në krahasim me vitin 2009, për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal "Vjedhja me dhunë".

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike procedime penale të regjistruara për cdo rreth për vitet 2009-2010 për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal "Vjedhja me dhunë".


Neni 139 "Vjedhja me dhune" 2009-2010



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 140 i Kodit Penal "Vjedhja me armë"** në vitin 2010, prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal "Vjedhja me armë", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 9.94, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 2.63 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale prej 6,89% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 14,81% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 35,48% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka rritje prej 50% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal "Vjedhja me armë".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, nga të dhënat statistikore rezulton se:

Neni 140 "Vjedhja me arme"



Në Berat, Kurbini, Mat dhe Pogradec është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale; në Gjirokastrë, Krushjë dhe Lushnjë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 3 procedime penale; në Kavajë, Korçë dhe Shkodër janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Fier dhe Lezhë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 6 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 8 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 13 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 17 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 47 procedime penale gjatë vitit 2010 për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal "Vjedhja me armë".

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME MASHTRIMET, KREU III, SEKSIONI II, "MASHTRIMET"

Ne Seksionin e Dytë, Kreu i Tretë i Kodit Penal parashikohen Mashtrimet.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 19,6 ndërsa për vitin 2010 është 14,9. Është e qartë tendenca për ulje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 3,7 % (për qind) për vitin 2009 dhe 2,46 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Dytë, Kreu i Tretë i Kodit Penal dhe konkretisht, Mashtrimet.

Mashtrimet	2009					2010				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 143 Mashtrimi	559	266	270	286	237	460	223	236	246	238
Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 144 Mashtrimi në subvencione	3	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 145 Mashtrimi në sigurime	58	18	48	25	20	8	10	6	10	27
Neni 146 Mashtrimi në kredi	5	6	2	8	8	7	0	5	0	2
Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 148 Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 149 Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	626	290	321	319	265	476	233	247	256	267

Nga të dhënat rezultojnë se në vitin 2010 ka një ulje prej 24 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për mashtrime në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 19,7 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 23,1 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 19,7 % (për qind) dhe kemi thujse shifër të njëjtë të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata, 265 të dënuar nga gjykata në vitin 2009 dhe 267 të dënuar nga gjykata në vitin 2010.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 395 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 480 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 17,7% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010, është ngritur akuza në gjykatë për 256 të pandehur, që do të thotë ulje prej 19,74% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të këtij treguesi.

Në lidhje me gjininë e të pandehurve, nga të dhënat statistikore, në vitin 2010, rezultojnë 169 të pandehur meshkuj (të rritur mbi 18-vjec), që do të thotë ulje prej 26,2% (për qind) për këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009. Rezultojnë të jetë 33 numri i të pandehurve femra për vitin 2010, ndërkohë që në vitin 2009 ka qenë 34.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 103 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 79 me arsim të mesëm dhe 19 të pandehur me arsim të lartë. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në

ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjecar. Në këtë tregues, vihet re një rritje e ndjeshme e të pandehurve me arsim të lartë për këtë grup veprash penale (rezultojnë 6 të pandehur me arsim të lartë në vitin 2009 dhe 19 të pandehur me arsim të lartë në vitin 2010).

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 6 të pandehur, përkundrejt 5 të tillë në vitin 2009. Nga këta, 3 të pandehur janë nëpunës të nivelit të mesëm, 1 nëpunës i nivelit të ulët dhe 2 nëpunës i thjeshtë.

Të papunë rezultojnë të jenë 71 të pandehur, që do të thotë ulje prej 53,28 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të punësuarit, 40 të pandehur të punësuar nga sektori privat, që do të thotë ulje prej 60,78% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton se 148 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 54 prej tyre në komuna (që do të thotë ulje prej 68,42% për qind e këtij treguesi për vitin 2010, në krahasim me vitin 2009). Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 192 të pandehur, vetëm 3 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 7 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 143 i Kodit Penal “Mahtrimet”**, në vitin 2010, prej 17,7 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal “Mahtrimet”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 14,39, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 17,5 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 66,38% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal "Mashtrimet" në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 19,69% të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 22,59% (për qind) dhe në vitin 2010 ka ulje të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë prej 17,7% (për qind) në krahasim me vitin 2009, për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal "Mashtrimet".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, nga të dhënat statistikore rezulton se:

Neni 143 "Mashtrimet"




Në rrethet Pukë, Sarandë dhe Tropojë është regjistruar nga 1 procedim penal për këtë veprë penale; në Lushnje janë regjistruar 2 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 3 procedime penale; në Dibër, Kavajë dhe Mat janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Gjirokastër dhe Lezhë janë regjistruar nga 6 procedime penale; në Kukës dhe Pogradec janë regjistruar nga 7 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 12 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 14 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 17 procedime penale; në Fier janë regjistruar 24 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 37 procedime penale; në Berat janë regjistruar 43 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 46 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 218 procedime penale gjatë vitit 2010 për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal "Mashtimet", që do të thotë ulje prej 14,5% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 145 i Kodit Penal "Mashtimi në sigurime"**, në vitin 2010, prej 86,2 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal "Mashtimi në sigurime", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,25, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,81 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2007 ka rritje prej 75% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë regjistruar 34 procedime penale përkundrejt vitit 2007 kur janë regjistruar 7 procedim penale; në vitin 2009 ka rritje prej 70,6% (për qind) të procedimeve

penale të regjistruara prej 70,6% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka ulje të theksuar prej 86,2% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime”.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se: në Lezhë, Korçë, Fier dhe Berat kanë regjistruar nga 1 procedim penal; në rrethet Durrës dhe Tiranë janë regjistruar përkatësisht nga 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal “Mashtrimi në sigurime” gjatë vitit 2010.

VEPRAT PENALE TË LIDHURA ME SHKATËRRIMIN E PRONËS, KREU III, SEKSIONI III

Në Seksionin e Tretë, Kreu i Tretë i Kodit Penal parashikohet Shkatërrimi i pronës.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 24,48 ndërsa për vitin 2010 është 25. Është e qartë tendenca për rritje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 4,62 % (për qind) për vitin 2009 dhe 4,15 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Tretë, Kreu i tretë i Kodit Penal dhe konkretisht me Shkatërrimi i pronës:

	2009					2010				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Shkatërrimi i pronës										
Neni 150 Shkatërrimi i pronës	310	72	96	81	58	326	56	111	76	40
Neni 151 Shkatërrimi i pronës me zjarr	274	27	35	28	19	243	15	22	15	14
Neni 152 Shkatërrimi i pronës me eksploziv	46	1	1	1	2	52	1	2	1	0
Neni 153 Shkatërrimi i pronës me përmbytje	1	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 154 Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera	16	1	3	1	1	11	2	4	2	2
Neni 155 Shkatërrimi i rrugëve	4	2	2	3	1	7	4	7	6	4
Neni 156 Shkatërrimi i rrjetit elektrik	39	5	18	17	18	26	1	2	1	1
Neni 157 Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes	4	2	3	3	0	3	1	2	1	0
Neni 158	0	0	0	0	0	2	1	1	1	0
Neni 159 Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit	51	39	49	56	47	107	12	23	14	18
Neni 160 Shkatërrimi i veprave kulturore	4	1	1	1	0	0	1	0	1	1
Neni 161 Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia	33	4	4	5	6	22	5	11	5	3
Neni 162 Perplas. e mjeteve te trans. masiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	782	154	212	196	152	801	99	185	123	83

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 2,43 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me shkatërrimin e pronës në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 35,7 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 13 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 37,2 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 45,4 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 240 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 296 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 18,91% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010 për 123 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë, përkundrejt 196 të tillë në vitin 2009, që do të thotë ulje prej 37,24% (për ind) e këtij treguesi për vitin 2010.

Nga të pandehurit, 18 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; në vitin 2009 rezultojnë 12 të pandehur të mitur meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton ulje e të pandehurve femra në vitin 2010. Kështu, në vitin 2009 numri i të pandehurve femra ka qenë 9 ndërsa në vitin 2010 rezulton të jetë 5, pra është ulur 44,44% (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009. Me ulje rezultojnë edhe të pandehur meshkuj të rritur mbi 18 vjeç, ulja rezulton të jetë 22,11% (për qind) në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 132 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (ulje prej 14,28%) dhe 41 me arsim të mesëm (ulje prej 28%) dhe 4 të pandehur me arsim të lartë (ulje prej 55,55%). Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 36 të pandehur (ulje prej 30,76% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 75 (ulje prej 39,51% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 96 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (ulje e ndjeshme prej 31,91% për qind) ndërsa 81 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 168 të pandehur, vetëm 1 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 8 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”**, në vitin 2010, prej 11,3 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 7,6, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 8,56 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2007 ka rritje prej 115% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 27% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 31% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka ulje prej 11,3% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, nga të dhënat statistikore rezultojnë si vepër penale e shpërndarë në të gjithë territorin e vendit. Kështu në Mat është regjistruar 1 procedim penal; në Lezhë janë regjistruar 4 procedime penale; në Kavajë dhe Pukë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Kurbin janë regjistruar 6 procedime penale; në Krujë dhe Lushnjë janë regjistruar nga 10 procedime penale; në Berat, Dibër dhe Pogradec janë regjistruar nga 11 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 12 procedime penale; në Kukës janë regjistruar 13 procedime penale; në Fier dhe Sarandë janë regjistruar 15 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 16 procedime penale; në Gjirokastrë janë regjistruar 17 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 18 procedime penale; në Tiranë janë regjistruar 19 procedime penale; në Vlorë janë

regjistruar Vlorë 21 procedime penale dhe në Elbasan janë regjistruar 23 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës me zjarr".

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike shpërndarja gjeografike e kësaj vepre penale dhe përqindjet përkatëse për cdo rreth:


Neni 151 "Shkatërrimi i pronës me zjarr"




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 159 i Kodit Penal "Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit"**, në vitin 2010, prej 109,8 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal "Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 3,34, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,59 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë): rezulton nga të dhënat se në vitin 2007 ka rritje prej 120% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 113,6% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara, në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 8,51% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka përsëri rritje prej 109,8% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal "Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit".



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, për këtë veprë penale rezultojnë nga të dhënat statistikore se:




Vihet re një rritje e ndjeshme e procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në Tiranë, janë regjistruar 21 procedime penale në vitin 2010, përkundrajt vitit 2009 kur është regjistruar vetëm 1 procedim

penal; në Durrës në vitin 2010 janë regjistruar 69 procedime penale përkundrejt vitit 2009 kur janë regjistruar 5 procedime penale; në Elbasan, ka një ulje të ndjeshme të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale, kështu, në vitin 2010 janë regjistruar 6, përkundrejt vitit 2009 kur janë regjistruar 29 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 3 procedime penale gjatë vitit 2010 ndërsa në vitin 2009 është regjistruar vetëm 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 159 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit të ujësjellësit”. Rrethet Berat, Dibër, Krujë, Pogradec, Pukë dhe Sarandë kanë regjistruar nga 1 procedim penal për këtë vepër penale gjatë vitit 2010.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 150 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës”**, në vitin 2010, prej 5,16 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 150i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 10,20, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 9,7 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 17,41% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 24,15% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 5,8% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 5,16% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nganeni 150 i Kodit Penal “Shkatërrimi i Pronës”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”**, në vitin 2010, prej 13 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,62, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,44 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka ulje prej 14,8% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale; në vitin 2008 ka ulje prej 10,9% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 12,2% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 13,04% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit elektrik”**, në vitin 2010, prej 33,3 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit elektrik”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,81, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,22 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vihet re se ka ulje prej 18,42% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në vitin 2007 në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 48,39% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ulje prej 15,22% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 33,33% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë për veprën penale të parashikuar nga neni 156 i Kodit Penal "Shkatërrimi i rrjetit elektrik".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni **161 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia"**, në vitin 2010, prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,68, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,03 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 161 "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia"



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 5% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale; në vitin 2008 ka rritje prej 100% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 21% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka ulje prej 33% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike rezulton nga të dhënat statistikore se gjatë vitit 2010 në rrethet Berat, Kavajë, Pogradec, Shkodër dhe Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Gjirokastrë janë regjistruar 2 procedime penale; në Korçë dhe Tiranë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 4 procedime penale dhe në Elbasan janë regjistruar 5 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia".

VEPRAT PENALE NË FUSHËN E DOGANAVE, KREU III, SEKSIONI V

Në Seksionin e Pestë, Kreu i Tretë i Kodit Penal parashikohen Krimet në Fushën e Doganave.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 7,42 ndërsa për vitin 2010 është 12,45. Është e qartë tendenca për rritje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 1,4 % (për qind) për vitin 2009 dhe 2 % (për qind) për vitin 2010 përkundërt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Pestë, Kreu i Tretë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet në Fushën e Doganave.

Krime në Fushën e Doganave	2009					2010				
	Nr. Proce d Regj	Nr. pro ced per g j kim	Nr. i pan d. Per g j kim	Nr. Pan d. Per g j kim	Nr. Pan d den uar	Nr. Pro ced Reg j	Nr. pro ced per g j kim	Nr. i pan d. Reg j	Nr. Pan d per g j kim	Nr. Pan d den uar
Neni 171 Kontrabanda me mallra të ndaluar	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0
Neni 172 Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë	17	12	19	17	19	66	13	28	17	11
Neni 173 Kontrabanda me mallra të licensuar	5	3	3	3	2	2	0	0	0	0
Neni 174 Kontrabanda me mallra të tjera	125	38	60	45	33	207	51	102	57	43
Neni 175 Kontrabanda nga punënjës që lidhen me veprimtarinë doganore	2	1	5	1	0	6	1	2	1	0
Neni 176 Kontrabanda e vlerave kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 177 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm	9	1	3	1	2	5	2	1	2	0
Neni 178 Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë	60	17	42	20	25	91	28	81	32	18
Neni 179 Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrab.	5	5	5	6	6	13	8	9	8	5
Neni 179/a Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë	14	11	12	12	13	8	8	7	9	7
Totali	237	88	149	105	102	398	111	230	126	84

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 67,93 % (për qind) të numrit të procedimeve të rregjistruara për krime në fushën e doganave në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 26,14 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të rregjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 54,4 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 20 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 17,6 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 284 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 211 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 34,59% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2010 për 126 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë, që do të thotë rritje prej 20 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 2 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj; 152 të pandehur meshkuj të rritur mbi 18-vjec dhe 9 femra të rritur mbi 18 vjec, për vitin 2010.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezultojnë rritje e të pandehurve femra në vitin 2010. Kështu, në vitin 2009 numri i të pandehurve femra ka qenë 2 ndërsa në vitin 2010 rezultojnë të jetë 9.

Në këtë grup veprash penale rezultojnë për vitin 2010 edhe 5 shtetas të huaj, përkundrejt vitit 2009 kur rezultojnë vetëm 2 të tillë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 56 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (ulje prej 5% për qind) dhe 94 me arsim të mesëm (rritje prej 100% për qind) dhe 13 të pandehur me arsim të lartë (rritje prej 13,13% për qind).

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 22 të pandehur, përkundrejt 4 të tillë në vitin 2009. Të gjithë këta të pandehur janë nëpunës të nivelit të mesëm, përkundrejt vetëm 1 të tillë në vitin 2009.

Të papunë rezultojnë të jenë 60 të pandehur, që do të thotë ulje prej 13 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të punësuarit, 61 të pandehur të punësuar nga sektori privat, që do të thotë rritje prej 32,6% (për qind) e këtij treguesi për vitin 2009.

Rezultojnë se 129 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 35,78% për qind) ndërsa 32 prej tyre në komuna (rritje prej 45,45% për qind). Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 157 të pandehur (rritje prej 37,71% për qind), vetëm 4 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa asnjë i pandehur nuk është përsëritës për vepra penale të ndryshme.


TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”**. Në vitin 2010 janë regjistruar 66 procedime penale për këtë vepër penale, përkundrejt vitit 2009 kur janë regjistruar 17 procedime penale për këtë vepër penale.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0.53 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):


Neni 172 "Kontrabanda me mallra qe paguhet akcize"



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka ulje prej 12% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 59% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka përsëri ulje prej 13,3% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka një rritje të ndjeshme prej 288% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal "Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë".

Më poshtë paraqitet shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale gjatë vitit 2010:

Neni 172 "Kontrabanda me mallra qe paguhet akcize"




Nga të dhënat statistikore vihet re se në Sarandë është regjistruar 1 procedim penal; në Dibër, Elbasan dhe Lezhë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Fier janë regjistruar 4 procedime penale; në Pogradec dhe Shkodër janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Durrës, Gjirokastër dhe Vlorë janë regjistruar nga 6 procedime penale; në Tiranë janë regjistruar 9 procedime penale dhe në Korçë janë regjistruar 18 procedime penale, ndërkohë që në vitin 2009 është regjistruar vetëm 1 procedim penal për këtë vepër penale.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”**, në vitin 2010, prej 65,5% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 6,47, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,91 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë) rezulton se në vitin 2007 ka ulje të procedimeve penale të regjistruara prej 47,11% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 57,21% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 27,55% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka rritje të ndjeshme prej 65,6% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.




Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në rrethet Berat, Fier dhe Pukë është regjistruar nga 1 procedim penale; në Lezhë dhe Sarandë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Elbasan dhe Tropojë janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Pogradec dhe Shkodër janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Gjirokastër dhe Kukës janë regjistruar nga 15 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 22 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 27 procedime penale; në Durrës janë regjistruar

48 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 50 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”, për vitin 2010.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 174 "Kontrabanda me mallra te tjera"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, në vitin 2010, prej 51,67 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal “Tregimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2,84, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,87 krime për 100 000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si vijon. Në vitin 2007 ka rritje prej 4,16% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 98% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 39,39% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 51,67% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”.



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike rezultojnë nga të dhënat statistikore se në rrethet Fier, Lezhë, Pukë dhe Sarandë është regjistruar nga 1 procedim penale; në Kavajë dhe Pogradec janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Korçë, Mat dhe Vlorë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Tiranë janë regjistruar 7 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 10 procedime penale; në Elbasan dhe Kukës janë regjistruar nga 11 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 14 procedime penale dhe në Shkodër janë regjistruar 21 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë" për vitin 2010.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 178 "Tregtimi dhe transportimi i mallrave qe jane kontrabande"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 179 i Kodit Penal "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë"**. Në vitin 2010, janë regjistruar 13 procedime penale përkundrejt vitit 2009 kur janë regjistruar 5 procedime penale.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,4, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,15 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si vijon: në vitin 2007 ka rritje prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 64,29% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 jemi në të njëjtat shifra, pra janë regjistruar 5 procedime penale sikurse edhe në vitin 2008 ndërsa në vitin 2010 ka një rritje të ndjeshme prej 160% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë".

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 179 "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabande"



Përsa i përket shpërndarjes gjeografike, nga të dhënat statistikore rezulton se në Dibër, Durrës, Elbasan dhe Tiranë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Lushnje janë regjistruar 2 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 3 procedime penale dhe në Fier janë regjistruar 4 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë".


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni **179/a i Kodit Penal "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë"**, në vitin 2010, prej 42,9 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,25, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,43 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si më vijon. Në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje 100% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 75% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 42,86% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se 7 procedime penale janë regjistruar në prokurorinë e Tiranës dhe 1 procedim penal është regjistruar në Korçë, për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë".

Neni 179/a "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë"



VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET, KREU III, SEKSIONI IV

Në Seksionin e Gjashtë, Kreu i Tretë i Kodit Penal parashikohen Veprat Penale në lidhje me Taksat dhe Tatimet.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 3,04 ndërsa për vitin 2010 është 3,79. Është e qartë tendenca për rritje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 0,57 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,62 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Gjashtë, Kreu i Tretë i Kodit Penal dhe konkretisht me Veprat penale në lidhje me taksat dhe Tatimet.

Taksa e Tatime	2009					2010				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjkim	Nr. i pand . Regj .	Nr. Pand. Per gjkim	Nr. Pand denuar	Nr. Proec d Regj	Nr. proce d per gjkim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denuar
Neni 180 Fshehja e të ardhurave	5	3	1	11	10	38	8	29	26	1
Neni 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve	92	28	29	28	26	81	36	39	36	18
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore	0	0	0	0	0	2	1	0	2	0
Neni 182 Ndryshimi në aparatet matëse	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	97	31	30	39	36	121	45	68	64	19

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 24,74 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 45,16 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 127 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 64,1 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 47,2 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 82 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 77 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 6,49% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010 për 64 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë, përkundrejt vitit 2010 kur rezultojnë 39 të tillë, që do të thotë rritje prej 64,10% (për qind) e këtij treguesi për vitin 2010.

Nga të pandehurit, 47 kanë qenë të pandehur të rritur meshkuj (rritje prej 56,66%) dhe 3 femra të pandehur të rritur (mbi 18 vjec), e njëjtë shifra edhe për vitin 2009.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 13 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (rritje prej 62,5%) dhe 30 me arsim të mesëm (rritje prej 100%) dhe 7 të pandehur me arsim të lartë (ulje prej 30%).

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori privat janë regjistruar 24 të pandehur (rritje prej 4,34% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 3 (uje prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton se 44 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 37,5%) ndërsa 6 prej tyre në komuna (rritje prej 5 herë). Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë, 50 të pandehur, që do të thotë rritje prej 51,51% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”**, në vitin 2010, prej 6,6 herë në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,18, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,15 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Bazuar nga të dhënat vihet re se në vitin 2007 ka ulje prej 27,59% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 është regjistruar i njëjti numër procedimesh penale sikurse në vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 76,19% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka një rritje të ndjeshme prej 6,6 herë në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 180 I Kodit Penal "Fshehja e të ardhurave".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, të dhënat paraqiten si më poshtë:

Neni 180 "Fshehja e te ardhurave"




Nga të dhënat statistikore rezulton se në Durrës, Kavajë dhe Tiranë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Lezhë dhe Vlorë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Berat janë regjistruar 3 procedime penale; në Fier janë regjistruar 6 procedime penale dhe në Elbasan janë regjistruar 22 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 180 I Kodit Penal "Fshehja e të ardhurave".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 181 i Kodit Penal "Mospagimi i taksave dhe tatimeve"**, në vitin 2010, prej 11,96 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal "Mospagimi i taksave dhe tatimeve", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2,54, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 2,88 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si vijon: në vitin 2007 ka rritje prej 41,1% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 15,2% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka rritje prej 1,1% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 11,96% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, nga të dhënat statistikore rezulton se në Fier është regjistruar 1 procedim penal; në Gjirokastrë dhe Sarandë janë regjistruar 2 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 4 procedime penale; në Berat janë regjistruar 5 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 9 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 13 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 15 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 30 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME FALSIFIKIMIN E DOKUMENTEVE, KREU III, SEKSIONI VII.

Në Seksionin e shtatë, Kreu i Tretë i Kodit Penal parashikohen vepra penale në lidhje me Falsifikimin e Dokumenteve.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 37,63 ndërsa për vitin 2010 është 32,61. Është e qartë tendenca për ulje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 7,11 % (për qind) për vitin 2009 dhe 5,4 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Shtatë, Kreu i Tretë i Kodit Penal dhe konkretisht me vepra penale në lidhje me falsifikimin e dokumenteve.

Falsifikimi i Dokumenteve	2009					2010				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 186 Falsifikimi i dokumenteve	724	284	253	376	323	649	245	278	293	371
Neni 187 Falsifikimi i dokumenteve shkollore	25	12	14	15	17	61	28	35	30	33
Neni 188 Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore	3	2	4	4	7	2	0	0	0	0
Neni 189 Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaport.ose viza	225	175	162	179	194	184	118	144	123	174
Neni 190 Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve	120	44	48	56	64	77	32	34	38	47
Neni 191 Falsifikimi i akte. te gjendjes civile	98	32	44	43	43	58	16	19	16	24
Neni 192 Prodhimi i mjeteve për fals. e dokumenteve	2	0	0	0	0	4	2	1	3	0
Neni 192/a Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve	4	0	0	0	0	4	0	1	0	1
Neni 192/b Ndërhyrja në transmetimet kompjuterike	1	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Totali	1202	549	525	673	648	1042	441	512	503	650

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një ulje prej 13,3 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në lidhje me falsifikimin e dokumenteve në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 20 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar

përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 2,5 % (për qind); një ulje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 25,3 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 0,3 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 760 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 886 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re ulje prej 14,22 % (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë në vitin 2010 janë 503 ndërsa në vitin 2009 janë 673 që do të thotë ulje prej 25,26 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 9 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj (ulje prej 18,18%) dhe 2 femra; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 59 femra (ulje prej 4,83%) dhe 506 meshkuj (ulje prej 3,98%) në krahasim me vitin 2009. Në këtë tregues, rezultojnë 102 të pandehur të huaj në vitin 2010 që do të thotë rritje prej 22,89% për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 287 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (ulje prej 13,29%) dhe 239 me arsim të mesëm (rritje prej 7,65%) dhe 49 të pandehur me arsim të lartë (rritje prej 6,52%).

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë rregjistruar 55 të pandehur (që do të thotë rritje prej 96,42 % (për qind) në krahasim me vitin 2009). Nga këta, 1 i pandehur është funksionar, përkundrejt 3 të tillë në vitin 2009, dhe 2 të pandehur është nëpunës i nivelit të mesëm (ulje prej 71,42%) dhe 5 të pandehur nëpunës në nivelit të ulët, përkundrejt 2 të tillë në vitin 2009.

Të papunë rezultojnë të jenë 328 të pandehur, që do të thotë ulje prej 20,19 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të punësuarit, 89 të pandehur të punësuar nga sektori privat dhe 55 të pandehur nga sektori shtetëror.

Rezulton se 385 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 188 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 556 të pandehur, vetëm 6 prej tyre është përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 10 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.


TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 186 i Kodit Penal "Falsifikimi i Dokumenteve"**, në vitin 2010, prej 10,4% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal "Falsifikimi i Dokumenteteve", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 20,31, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 22,66 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):


Neni 186 "Falsifikimi i dokumenteve"



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka ulje prej 13% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje prej 89,1% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 28% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 10,4% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të dhënat paraqiten si më poshtë:


Neni 186 "Falsifikimi i dokumenteve"



Nga të dhënat statistikore rezulton se në Lushnje janë regjistruar 3 procedime penale; në Pukë janë regjistruar 4 procedime penale; në Mat dhe Tropojë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Kukës janë regjistruar 7 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 8 procedime penale; në Kurbini janë regjistruar 8 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 11 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 15 procedime penale; në Berat janë regjistruar 19 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 21 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 27 procedime penale; në Fier janë regjistruar 29 procedime penale; në Gjirokastrë janë regjistruar 31 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 36 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 42 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 43 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 78 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 87 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 170 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve".

Më poshtë paraqitet grafikisht procedimet penale të regjistruara për këtë vepër penale gjatë viteve 2009-2010:


Neni 186 "Falsifikimi i dokumenteve"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 187 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve shkollore"**, në vitin 2010, prej 144 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal "falsifikimi i dokumenteve shkollore", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,90, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,78 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 97,8% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 15% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 68% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 144% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve shkollore".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Kukës dhe Lezhë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Fier dhe Tiranë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Durrës dhe Vlorë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Berat janë regjistruar 4 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 8 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 12 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 22 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal "Falsifikimi i dokumenteve shkollore".

Neni 187 "Falsifikimi i dokumenteve shkollore"




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 189 i Kodit Penal "Falsifikimi i letërnjoftimeve apo vizave"**, në vitin 2010, prej 18,2 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal "Falsifikimi i letërnjoftimeve apo vizave", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 5,75, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 7 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):


Neni 189 "Falsifikimi i letërnjoftimeve apo vizave"



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka ulje prej 16% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 33% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 18,2% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve apo vizave”.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të dhënat rezultojnë si më poshtë:

Neni 189 "Falsifikimi i letërnjoftimeve apo vizave"




Nga të dhënat statistikore rezulton se, në Lezhë dhe Mat është regjistruar nga 1 procedim penal; në Berat dhe Sarandë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Korçë dhe Kukës janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 4 procedime penale; në Elbasan dhe Pogradec janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Gjirokastër janë regjistruar 7 procedime penale; në Fier janë regjistruar 8 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 9 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 10 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 17 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 45 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 62 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal “Falsifikimi i letërnjoftimeve apo vizave”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve”**, në vitin 2010, prej 35,8 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal “Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2,41, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,76 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka ulje prej 12% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka ulje prej 11,8% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 38,5 % (për qind) të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 35,8 % (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal "Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara, rezulton nga të dhënat statistikore se në Krujë dhe Lushnjë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Dibër, Kavajë, Lezhë dhe Shkodër janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Berat dhe Elbasan janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Fier janë regjistruar 4 procedime penale; në Korçë, Sarandë dhe Tiranë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 7 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 10 procedime penale dhe në Gjirokastër janë regjistruar 25 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal "Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve".

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 190 "Falsifikimi i vulave, stampave ose formulareve"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 191 i Kodit Penal "Falsifikimi i akteve të gjendjes civile"**, në vitin 2010, prej 40 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 191 i Kodit Penal "Falsifikimi i akteve të gjendjes civile", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,81, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale, rezulton nga të dhënat statistikore se: në rrethet Dibër, Fier, Krujë dhe Pogradec është regjistruar nga 1 procedim penal; në rrethet Durrës, Gjirokastrë, Kukës dhe Shkodër janë regjistruar nga 2 procedime penale; në rrethet Berat, Elbasan dhe Korçë janë regjistruar nga 3 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 37 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 191 i Kodit Penal "Falsifikimi i akteve të gjendjes civile".

Sa më sipër paraqitet grafikisht më poshtë:

Neni 191 "Falsifikimi i akteve te gjendjes civile"



VEPRA PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT, SEKSIONI IX, KREU III.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në lidhje me veprat penale në fushën e falimentimit gjatë vitit 2010 janë regjistruar 2 procedime penale, përkundrej asnjë të tillë në vitin 2009. Konkretisht, këto procedime penale janë regjistruar përkatësisht për: një procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 193 i Kodit Penal "Falimentimi i provokuar" në Korçë dhe një procedim penal është regjistruar në Sarandë për veprën penale të parashikuar nga neni 196 i Kodit Penal "Shkelja e detyrimeve".

VEPRAT PENALE TË FALSIFIKIMIT TË MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË, KREU III, SEKSIONI VII.

Ne Seksionin e Shtatë, Kreu i Tretë i Kodit Penal parashikohen vepra penale në lidhje me falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 2,84 ndërsa për vitin 2010 është 3,47. Është e qartë tendenca për rritje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 0,53 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,57 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Shatë, Kreu i Tretë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet në lidhje me falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë.

Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë	2009					2010				
	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 183, Falsifikimi i monedhave	90	25	48	36	16	104	35	97	69	29
Neni 184, Falsifikimi i letrave me vlerë	1	0	0	0	0	7	1	1	1	3
Neni 185, Prodhimi i mjeteve per falsifikim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	91	25	48	36	16	111	36	98	70	32

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 21,97 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 44% (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 104,16 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 94,44 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 100 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 129 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 59 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 118,64% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Gjatë vitit 2010 është ngritur akuzë në gjykatë për 70 të pandehur, që do të thotë rritje prej 94,44% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 10 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 2 femra dhe 78 meshkuj.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (rritje prej 40%) dhe 47 me arsim të mesëm (rritje prej 261,53%) dhe 3 të pandehur me arsim të lartë (përkundrejt asnjë të tillë në vitin 2009.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori privat janë regjistruar 17 të pandehur (rritje prej 325% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 18 (rritje prej 18,18% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezultoni se 73 të pandehur kanë vendbanimin në qytet ndërsa 17 prej tyre në komuna. Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjëndjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 88 të pandehur, vetëm 2 prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 183 i Kodit Penal "Falsifikimi i monedhave"**, në vitin 2010, prej 15,55 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal "Falsifikimi i monedhave", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 3,25, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 2,81 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezultoni se: në vitin 2007 ka ulje prej 23,52% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 5,12% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 140% (për qind) të procedimeve

penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka rritje prej 16,85% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në rrethet Kavajë, Kukës dhe Kurbin është regjistruar nga 1 procedim penal; në Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Mat dhe Pogradec janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Lushnje janë regjistruar 4 procedime penale; në Berat dhe Durrës janë regjistruar nga 6 procedime penale; në Korçë dhe Vlorë janë regjistruar nga 7 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 8 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 48 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal “Falsifikimi i monedhave”.



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 184 i Kodit Penal “Falsifikimi i letrave me vlerë”**.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Vihet re nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 janë regjistruar 2 procedime penale; në vitin 2007 është regjistruar 1 procedim penal; në vitin 2008 janë regjistruar 3 procedime penale; në vitin 2009 është regjistruar 1 procedim penale dhe në vitin 2010 janë regjistruar 7 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 184 i Kodit Penal “Falsifikimi i letrave me vlerë”.



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në rrethet Elbasan, Lezhë dhe Shkodër është regjistruar nga 1 procedim penal dhe në Berat dhe Tiranë janë regjistruar nga 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 184 i Kodit Penal “Falsifikimi i letrave me vlerë”.

VEPRAT PENALE QË CËNOJNË RREGJIMIN JURIDIK TË TOKËS, SEKSIONI XI.

Në seksionin e XI, kodit penal parashikohen veprat penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës. Koefficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2010 është 6,72.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e XI, Kreu i Dytë i Kodit Penal dhe konkretisht me Vepra Penale që çënojnë Rregjimin Juridik të Tokës.

Regjimi juridik i tokës	2009					2010				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 199 Shpërdorimi i tokës	117	37	41	37	21	11	25	5	25	24
Neni 199/a Ndërtimi i paligjshëm						148	91	98	92	65
Neni 200 Pushtimi i tokës	57	23	26	26	22	56	15	38	23	12
Totali	174	60	67	63	43	215	131	141	140	101


Nga të dhënat rezulton se për nenin 199/a “Ndërtimi i paligjshëm” janë regjistruar 148 procedime penale gjatë vitit 2010 dhe është pikërisht ky nen që ka edhe peshën specifike më të lartë në këtë grup veprash penale, prej 68,83% (për qind).

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 199 i Kodit Penal “Shpërdorimi i tokës”**, në vitin 2010, prej 90.59 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal “Shpërdorimi i tokës”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,34, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,66 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka ulje prej 54,54% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 1850% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 90,59% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199 “Shpërdorimi i tokës” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike rezulton nga të dhënat statistikore se, në Korcë dhe Tiranë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Vlorë janë regjistruar 4 procedime penale dhe në Sarandë janë regjistruar 5 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal “Shpërdorimi i tokës”.

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME ZHVILLIMIN E PALEJUAR TË LOJËRAVE TË FATIT, SEKSIONI X

Në Seksionin e X i Kodit Penal parashikohen veprat penale në lidhje me zhvillimin e palejuar të lojërave të fatit.

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 5,82 ndërsa për vitin 2010 është 6,66. Është e qartë tendenca për rritje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 1% (për qind) për vitin 2009 dhe 1,10 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e X Kreu i Dytë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet vepra penale në lidhje me zhvillimin e palejuar të lojërave të fatit.

Lojërat e Fatit	2009					2010				
	Nr. Proced Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Proced Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
Neni 197 Organizimi i llotarive të palejuara	176	107	96	110	97	207	167	161	171	130
Neni 197/a Paracaktimi i rezultateve ne garat sportive	2	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 197/b Shtremberimi i konkures ne garat sportive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 198 Vënia në dispozicion e lokaleve për lojra të palejuara	8	8	5	11	10	4	4	7	8	6
Totali	186	115	101	121	107	213	171	168	179	136

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 14,51 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 48,69 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 66,33 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 47,93 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 27,10 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 233 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 153 të pandehur në

hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 52,28% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010 është ngritur akuzë në gjykatë për 179 të pandehur që do të thotë rritje prej 47,93% (për qind).

Nga të pandehurit, 182 kanë qenë të pandehur meshkuj dhe 1 femër (të pandehur të rritur (mbi 18 vjec). Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton rritje e të pandehurve meshkuj në vitin 2010, prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 62 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (rritje prej 21,56 %) dhe 114 me arsim të mesëm (rritje prej 48%) dhe 7 të pandehur me arsim të lartë.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 16 të pandehur, përkundrejt asnjë të tillë në vitin 2009. të gjithë këta janë nëpunës i nivelit të mesëm.

Nga sektori privat janë regjistruar 113 të pandehur (rritje prej 63,76% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 22 (ulje prej 59,25% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton se 153 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 37,83%) ndërsa 30 prej tyre në komuna (rritje prej 36,36%). Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 177 të pandehur (rritje prej 40,47%), vetëm 3 prej tyre është përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 2 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”**, në vitin 2010, prej 17,61 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal “Organizimi i llotarive të palejuara”, për 100.00 banorë në vitin 2010 është 6.47, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 5.51 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si vijon:

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 71,42% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 691,66% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 85,26% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 17,61% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 197 “Organizimi i llotarive të palejuara” i Kodit Penal.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultojnë nga të dhënat statistikore se: në Krujë, Kukës dhe Pukë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Mat janë regjistruar 2 procedime penale; në Tiranë janë regjistruar 3 procedime penale; në Kurbin janë regjistruar 4 procedime penale; në Sarandë janë regjistruar 5 procedime penale; në Lezhë, Pogradec dhe Vlorë janë regjistruar nga 6 procedime penale; në Lushnjë janë regjistruar 8 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 13 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 14 procedime penale; në Fier janë regjistruar 14 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 27 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 29 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 30 procedime penale dhe në Berat janë regjistruar 37 procedime penale për vepën penale të parashikura nga neni 197 i Kodit Penal "Organizimi i llotarive të palejuara".

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për çdo rreth si dhe përqindjet përkatëse:

Neni 197 "Organizimi i llotarive te palejuara"



VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KREU IV.

Në Kreu e IV të Kodit Penal parashikohen Veprat penale kundër mjedisit.

Koefiçienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 7,13 ndërsa për vitin 2010 është 6. Është e qartë tendenca për ulje të koefiçientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 1,34 % (për qind) për vitin 2009 dhe 0,99 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e IV, të Kodit Penal dhe konkretisht me veprat penale kundër mjedisit.

V.P./ Mjedisit	2009					2010				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 201 Ndotja e ajrit	10	9	9	9	13	3	0	0	0	3
Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 203 Ndotja e ujërave	5	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 204 Peshkim i ndaluar	12	10	21	18	10	10	7	11	14	9
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	186	105	116	110	131	159	113	133	130	115
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë	9	2	2	4	4	8	0	3	0	0
Neni 206/a Shkatërimi me zjarr i pyjeve	4	0	0	0	0	10	0	0	0	0
Neni 206/b Shkatërimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve	1	0	1	0	0	1	0	0	0	0
Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	228	126	149	141	158	192	120	147	144	127

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një ulje prej 15,79 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi ulje prej 4,76 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 1,34 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 2,12 % (për qind) dhe kemi ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 19,62 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 199 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 162 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 22,83% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010 për 144 të pandehurve është ngritur akuzë në gjykatë që do të thotë rritje prej 2,12% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 2 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe asnjë femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 2 femra dhe 141 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton ulje e të pandehurve meshkuj në vitin 2010 prej 16,07% (për qind).

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 114 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (ulje prej 15,56%) dhe 31 me arsim të mesëm (ulje prej 11,43%) dhe asnjë i pandehur me arsim të lartë, përkundrejt 3 të tiilë në vitin 2009. Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 2 të pandehur përkundrejt asnjë të tillë në krahasim me vitin 2009). Nga këta, 2 të pandehur janë nëpunës i nivelit të mesëm.

Nga sektori privat janë regjistruar 32 të pandehur (ulje prej 57,89% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 72 (ulje prej 17,24% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton se 18 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (ulje prej 47,06 %) ndërsa 127 prej tyre në komuna (ulje prej 5,22 %). Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 136 të pandehur, vetëm 7 prej tyre është përsëritës për të njëjtën veprë penale, ndërsa 1 i pandehur është përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 201 i Kodit Penal "Ndotja e ajrit"**, në vitin 2010, prej 70 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal "Ndotja e ajrit", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0.093, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,31 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2006 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale; në vitin 2007 janë regjistruar 2 procedime penale; në vitin 2008 janë regjistruar 16 procedime


penale; në vitin 2009 janë regjistruar 10 procedime penale dhe në vitin 2010 janë regjistruar 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 201 “Ndotja e ajrit” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se 2 procedime penale janë regjistruar në Elbasan dhe 1 procedim penal është regjistruar në Vlorë, për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal “Ndotja e ajrit”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”**, në vitin 2010, prej 14,52 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal “Prerja e paligjshme e pyjeve”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 4.97, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 5.82 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka ulje prej 21,2% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 12,8% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 6,06% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 14,52% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 205 “Prerja e paligjshme e pyjeve” i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për cdo rreth:

Neni 205 "Prerja e paligjshme e pyjeve"



Nga të dhënat statistikore rezultojn se në rrethet, Fier, Kavajë, Kurbin, Lezhë dhe Sarandë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Krujë dhe në Tiranë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 4 procedime penale; në Kukës janë regjistruar 5 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 6 procedime penale; në Shkodër, janë regjistruar 7 procedime penale; në Mat janë regjistruar 9 procedime penale; në Dibër janë regjistruar 12 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 16 procedime penale; në Tropojë janë regjistruar 19 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 31 procedime penale dhe në Korçë janë regjistruar 41 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal "Prerja e paligjshme e pyjeve".

Sikurse rezultojn nga të dhënat statistikore, ka një rritje të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga **neni Neni 206/a Shkatërrimi me zjarr i pyjeve**". Kështu, në vitin 2010 janë regjistruar 10 procedime penale për këtë veprë penale, përkundrajt vitit 2009 kur rezultojnë 4 procedime penale të regjistruara për këtë veprë penale.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultojn se 5 procedime penale janë regjistruar në Lezhë, 4 procedime penale janë regjistruar në Gjirokastrë dhe 1 procedim penal është regjistruar në Kavajë.

Në lidhje me veprat penale të parashikuara nga Kreu i VII "Aktet terroriste" (nenet 234- 234/b-2), rezultojn nga të dhënat statistikore se është regjistruar vetëm 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 230 i Kodit Penal "Akte terroriste" gjatë vitit 2010, me 1 të pandehur të regjistruar.

Në lidhje me Nenin 232/a "Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste" rezultojn nga të dhënat statistikore se 1 procedim penal është dërguar për gjykim gjatë vitit 2010, për 1 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë dhe është dënuar nga gjykata 1 i pandehur gjatë vitit 2010.

KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT, KREU VIII, SEKSIONI I VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT

Në Seksionin e Parë, Kreu i Tetë i Kodit Penal parashikohen veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 16,56 ndërsa për vitin 2010 është 19. Është e qartë tendenca për rritje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 3,12 % (për qind) për vitin 2009 dhe 3,15 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Parë, Kreu i Tetë i Kodit Penal dhe konkretisht me Krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit.

Krime kundër Autoritetit të Shtetit	2009					2010				
	Nr. Proc d Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pan d. Regj .	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenu ar	Nr. Proc d Regj	Nr. proce d per gjykim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenu ar
Neni 235 Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik	23	15	27	22	8	28	20	18	23	24
Neni 236 Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	120	110	152	168	125	162	124	209	183	138
Neni 237 Goditjet për shkak të dety.	106	73	83	80	56	117	85	111	99	91
Neni 238 Kanosja për shkak të dety.	27	13	17	14	13	25	11	17	12	14
Neni 239 Fyerja për shkak të dety.	154	70	96	86	54	177	72	136	84	42
Neni 240 Shpifja për shkak të dety.	21	4	5	4	1	17	4	8	4	2
Neni 241 Shpifja ndaj Presidentit të Republikës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 242 Mosbindja ndaj urdhrat të punonj. të pol. rendit	71	63	72	73	59	74	60	69	77	92
Neni 243 Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 245/2 Përgjashtimi nga vuajtja e dënimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 246 Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore	5	2	2	3	4	5	4	6	5	2
Neni 247 Mbajtja pa të drejtë e uniformës	2	1	1	1	0	3	2	4	3	2
Totali	529	351	455	451	320	608	382	578	490	407

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 ka një rritje prej 14,93 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 8,83 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me

vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 27 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 8,64 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 27,18 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 713 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 576 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 23,78% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me treguesin e të pandehurve për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rezulton nga të dhënat statistikore se për 490 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë gjatë vitit 2010, që do të thotë rritje prej 6,75% në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 8 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj dhe 1 femër; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 14 femra dhe 491 meshkuj.

Në këtë tregues, duke u krahasuar me vitin 2009 rezulton rritje e të pandehurve femra në vitin 2010. Kështu, në vitin 2009 numri i të pandehurve femra ka qenë 4 ndërsa në vitin 2010 rezulton të jetë 14, pra është rritur 2,5 herë. Edhe për të pandehurit meshkuj rezulton rritje në vitin 2010 prej 39,48% (për qind) në krahasim me vitin 2008

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 255 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (rritje prej 18,6%) dhe 232 me arsim të mesëm (rritje prej 78,46%) dhe 29 të pandehur me arsim të lartë (rritje prej 52,63%). Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 20 të pandehur (që do të thotë rritje prej 233,33 % (për qind) në krahasim me vitin 2009). Nga këta, 5 të pandehur janë nëpunës nivelit të mesëm, përkundrejt 1 të rtille në vitin 2009; 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të ulët dhe 14 të pandehur janë nëpunës i thjeshtë, përkundrejt 5 të tillë në vitin 2009.

Nga sektori privat janë regjistruar 100 të pandehur (rritje prej 20,48% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 282 (rritje prej 14,63% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 358 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 44,35%) ndërsa 155 prej tyre në komuna (rritje prej 32,47%). Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 490 të pandehur, vetëm 3 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 18 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”**, në vitin 2010, prej 30 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 5, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,75 krime për 100.000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 27,86% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 1,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 24% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 35% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 236 “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se:

Neni 236 "Kundershtimi i punonjesit te policise se rendit publik"




Nga të dhënat statistikore rezulton se në Pukë është regjistruar 1 procedim penal; në Krujë, Kurbin, Pogradec, Sarandë dhe Tropojë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 4 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 5 procedime penale; në Gjirokastër dhe Vlorë janë regjistruar nga 6 procedime penale; në Dibër dhe Korçë janë regjistruar nga 7 procedime penale; në Elbasan, Lezhë dhe Lushnje janë regjistruar nga 8 procedime penale; në Fier janë regjistruar 12 procedime penale; në Berat janë regjistruar 13 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 21 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 46 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal "Kundershtimi i punonjësit të policisë së rendit publik".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 237 i Kodit Penal "Goditjet për shkak të detyrës"**, në vitin 2010, prej 10,27 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal "Goditjet për shkak të detyrës", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 3,66, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,31 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 237 "Goditjet per shkak te detyres"




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 4,19% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 24,83% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 5,35% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 10,37% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 237 "Goditjet për shkak të detyrës" i Kodit Penal.

Rezulton nga të dhënat statistikore se në Tropojë është regjistruar 1 procedim penal; në Lezhë, Pukë dhe Shkodër janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Gjirokastër, Mat, Sarandë dhe Pogradec janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Dibër, Kavajë dhe Lushnje janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Berat dhe Elbasan janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Krujë janë regjistruar 6 procedime penale; në Fier janë regjistruar 7 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 9 procedime penale; në Durrës dhe Korçë janë regjistruar 13 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 28 procedime penale për veprën penale të parashikura nga neni 237 i Kodit Penal "Goditjet për shkak të detyrës" gjatë vitit 2010.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për çdo rreth si dhe përqindjet përkatëse.

Neni 237 "Goditjet për shkak të detyres"




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 239 i Kodit Penal "Fyerja për shkak të detyrës"**, në vitin 2010, prej 14,93 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 239 i Kodit Penal "Fyerja për shkak të detyrës", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 5,53, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 4,82 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):


Neni 239 "Fyerja për shkak të detyres"



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 31,81% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 2,87% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 13,96% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 14,93% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 239 "Fyerja për shkak të detyres" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, më poshtë paraqitet grafikisht procedime penale të regjistruara për çdo rreth dhe përqindjet përkatëse: rezulton se në rrethet, Krujë, Lushnje dhe Mat është regjistruar nga 1 procedim penal; në Kurbin dhe Pukë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Lezhë, Pogradec dhe Sarandë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 4 procedime penale; në Dibër dhe Kavajë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Berat janë regjistruar 6 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 8 procedime penale; në Gjirokastrë janë regjistruar 10 procedime penale; në Fier, Korçë dhe Vlorë janë regjistruar 12 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 37 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 50 procedime penale për veprën penale të parashikura nga neni 239 i Kodit Penal "Fyerja për shkak të detyres" gjatë vitit 2010.

Neni 239 "Fyerja per shkak te detyres"



Seksioni i Katërt, Kreu i Tretë i Kodit Penal parashikohen Vepra Penale kundër Sekretit dhe Kufijve Shtetërore (nenet 294-299), rezulton nga të dhënat statistikore se nuk është regjistruar asnjë procedim penal gjatë vitit 2010 ndërkohë që në vitin 2009 është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 294 i Kodit Penal “Tregtimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar” dhe 1 procedim penal për veprën penale të patashikuar nga neni Neni 295/a “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”.

KREU VIII, SEKSIONI III, “VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE”

Në Seksionin e Tretë, Kreu i Tetë i Kodit Penal parashikohen veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 78,71 ndërsa për vitin 2010 është 84,78. Është e qartë tendenca për rritje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 14,86 % (për qind) për vitin 2009 dhe 14,04 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Seksionin e Tretë, Kreu i Tetë i Kodit Penal dhe konkretisht me veprat Penale Kundër Rendit dhe sigurisë Publike.

V.P./ Rendit Kushtetues dhe Sigurisë Publike	2009					2010				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 261 Pengimi në ushtrimin e së drejtës për t’u shprehur, grumbulluar apo manifestuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 262 Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme	6	2	2	4	1	18	6	33	21	6
Neni 263 Organizimi i grumbullimeve e manifestimeve të paligjshme me pjesëmarrje të personave të armatosur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 264 Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë	0	0	0	0	0	1	1	1	1	0
Neni 265 Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 266 Thirrja për urrejtje nacionale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 267 Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 268 Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 269 Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 270 Rebelimi i të burgosurve	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 271 Disinformimii ekupeve të urgjencës	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 272 Njoftimi i rremë në organet e rendit	4	2	2	2	0	15	3	5	4	2
Neni 273 Largimi nga vendi i aksidentit	126	48	43	50	44	110	44	38	45	44
Neni 274 Prishja e qetësisë publike	75	50	65	78	64	68	43	73	71	69
Neni 275 Përdor. me keqdashje i thirrj. telefonike	335	49	53	48	29	414	59	76	62	33
Neni 276 Përdorimi pa të drejtë i emblems së Kryqit të Kuq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 277 Vetëgjyqësia	118	63	72	77	61	110	52	83	67	51
Neni 278 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit	466	354	370	387	335	631	468	604	534	469
Neni 279 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta	40	35	36	37	24	54	47	60	53	41
Neni 280 Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të gjuetisë dhe sportive	49	48	45	50	42	77	63	78	71	46
Neni 281 Shkelja e rregullave mbi lendët helmuese	3	0	0	0	0	2	0	0	0	1
Neni 282 Shkelja e rregullave mbi lendët plasëse, djegëse dhe radioaktive	15	14	17	16	12	6	3	4	4	5
Neni 282/b Stërvitja për prodhimin dhe përd. e paligjshëm të armëve e lend. të tjera të rrezik.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 283/b Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përd. e drogës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/b Ndihma në zbuli. e krimeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 284/ç Prodhimi, tregëtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 285/a Përshtatja e lokalit për përdorim droge	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 285/b Hedhja ose braktisja e shiringave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 286 Nxitja për përdorimin e drogës	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0
Neni 286/a Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 288 Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin	1	0	0	0	0	7	2	2	2	3
Neni 288/a Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industr. dhe ushqimorë	16	10	11	12	2	16	8	15	9	11
Neni 289 Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	64	14	19	17	9	42	2	23	4	3
Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	851	390	546	399	335	773	396	579	406	316
Neni 291 Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi	335	324	340	351	284	339	361	342	379	408
Neni 292 Shkelja e disiplinës së punës në transport	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 293 Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit	8	3	5	4	7	15	5	34	27	20
Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhën.kompjuterike	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 293/b Nderhyrja ne te dhenat kompjuerike	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0
Neni 293/c Nderhyrja ne sistemet kompj.	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 293/ç Keqperdorimi i pajisjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	2514	1406	1626	1532	1251	2709	1563	2050	1760	1528

Nga të dhënat rezultojnë se në vitin 2010 ka një rritje prej 7,75 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 11,16 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 26,07 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 14,88 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 22,14 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 2455 të pandehur në hetim ndërsa në vitin 2009 në total kanë qenë 1990 të pandehur në hetim. Pra, edhe në këtë tregues vihet re rritje prej 23,36% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010 është ngritur akuzë në gjykatë për 1760 të pandehur ndërsa në vitin 2009 është ngritur akuzë në gjykatë për 1532 të pandehur që do të thotë rritje prej 14,88% (për qind) e këtij treguesi për vitin 2010, në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 133 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj (rritje prej 35,71%) dhe 1 femër, përkundrejt 4 të tilla në vitin 2009; të pandehur të rritur (mbi 18 vjec) 48 femra (rritje prej 41,17%) dhe 1658 meshkuj (rritje prej 16,59%).

Në vitin 2010 rezultojnë 7 të pandehur të huaj, përkundrejt vitit 2009 kur rezultojnë 3 të tillë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 1122 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (rritje prej 11,19%) dhe 652 me arsim të mesëm (rritje prej 34,43%) dhe 60 të pandehur me arsim të lartë (ulje prej 4,76%). Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 16 të pandehur (që do të thotë ulje prej 36 % (për qind) në krahasim me vitin 2009). Nga këta, 7 të pandehur nëpunës i nivelit të mesëm, përkundrejt 4 të tillë në vitin 2009 dhe 9 të pandehur janë nëpunës i thjeshtë përkundrejt 17 të tillë në vitin 2009.

Nga sektori privat janë regjistruar 420 të pandehur (rritje prej 24,62% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 1047 (rritje prej 7,27% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj vepre penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezulton se 1060 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 20,18%) ndërsa 772 prej tyre në komuna (rritje prej 15,56%). Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 1754 të pandehur, vetëm 12 prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 68 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme (rritje prej 41,66%).


TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 262 i Kodit Penal “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”**, në vitin 2010, prej 200 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,56, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,18 krime për 100.000 banorë.

Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 janë regjistruar 6 procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2007 janë regjistruar 2 procedimeve penale; në vitin 2008 janë regjistruar 7 procedime penale; në vitin 2009 janë regjistruar 6 procedime penale dhe në vitin 2010 janë regjistruar 18 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 262 “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme” i Kodit Penal

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm




Në lidhje me shpërndarjen gjeografike rezultojn nga të dhënat statistikore se, në Korçë, Krujë, Pukë dhe Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Lezhë dhe Shkodër janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Fier janë regjistruar 4 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 6 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme”, gjatë vitit 2010.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 272 i Kodit Penal “Njoftimi i rremë në organet e rendit”**, në vitin 2010 (15 procedime penale të regjistruara) në krahasim me vitin 2009 (4 procedime penale të regjistruara).

Rezultojn nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 janë regjistruar 10 procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2007 janë regjistruar 9 procedimeve penale; në vitin 2008 janë regjistruar 5 procedime penale; në vitin 2009 janë regjistruar 4 procedime penale dhe në vitin 2010 janë regjistruar 15 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 272 “Njoftimi i rremë në organet e rendit” i Kodit Penal.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Në lidhje me shpërndarjen gjeografike rezulton nga të dhënat statistikore se në rrethet Gjirokastrë, Kukës, Kurbin, Lushnje dhe Tiranë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Berat dhe Durrës janë regjistruar nga 2 procedime penale dhe në Elbasan janë regjistruar 6 procedim penale për veprën penale të parashikuar nga neni 272 i Kodit Penal "Njoftimi i rremë në organet e rendit".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal "Largimi nga vendi i aksidentit", në vitin 2010, prej 12,69 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga **neni 273 i Kodit Penal "Largimi nga vendi i aksidentit"**, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 3,44, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,94 krime për 100.000 banorë.

Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 55,55% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 7,14% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 38,46% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 12,69% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 273 "Largimi nga vendi i aksidentit" i Kodit Penal.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se: në Lushnje është regjistruar 1 procedim penal; në Berat, Fier, Kurbin dhe Shkodër janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 3 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 4 procedime penale; në Elbasan dhe Lezhë janë regjistruar nga 6 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 19 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 63 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal "Largimi nga vendi i aksidentit".




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 274 i Kodit Penal "Prishja e qetësisë publike"**, në vitin 2010, prej 9,33 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal "Prishja e qetësisë publike", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2.12, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 2.34 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 274 Prishja e qetësisë publike"




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 43,13% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 28,76% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 20,21% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 9,33% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 274 "Prishja e qetësisë publike" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se: në Dibër, Fier, Gjirokastrë, Kurbin dhe Mat është regjistruar nga 1 procedim penal; në Lushnjë dhe Shkodër janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Kavajë dhe Lezhë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 4 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 5 procedime penale; në Elbasan dhe Vlorë janë regjistruar nga 6 procedime penale; në Berat dhe Durrës janë regjistruar nga 7 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 18 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal "Prishja e qetësisë publike".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 275 i Kodit Penal "Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike"**, në vitin 2010, prej 23,58 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal "Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 12,95, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 10,48 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 51,74% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 6,89% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 37,86% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 23,58% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 275 "Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se: në Berat janë regjistruar 20 procedime penale, që do të thotë rritje prej 122,22%; në Dibër janë regjistruar 3 procedime penale në të dy vitet; në Durrës janë regjistruar 28 procedime penale ose ulje prej 17,64%; në Elbasan janë regjistruar 27 procedime penale ose rritje prej 35%; në Fier janë regjistruar 21 procedime penale ose ulje prej 22,22%; në Gjirokastrë janë regjistruar 16 procedime penale ose rritje prej 6,66%; në Kavajë janë regjistruar 9 procedime penale ose ulje prej 10%; në Korçë janë regjistruar 17 procedime penale ose rritje prej 54,54%; në Krujë janë regjistruar 4 procedime penale ose ulje prej 60%; në Kukës janë regjistruar 11 procedime penale ose rritje prej 175%; në Kurbin janë regjistruar 5 procedime penale ose ulje prej 28,57%; në Lezhë janë regjistruar 27 procedime penale ose rritje prej 42,10%; në Lushnjë janë regjistruar 13 procedime penale ose ulje prej 7,14%; në Mat janë regjistruar 6 procedime penale ose ulje prej 33,33%; në Pogradec janë regjistruar 9 procedime penale ose rritje prej 350%; në Pukë janë regjistruar 4 procedime penale ose rritje prej 100%; në Sarandë janë regjistruar 4 procedime penale ose rritje prej 33,33%; në Shkodër janë regjistruar 33 procedime penale ose rritje prej 22,22%; në Tiranë janë regjistruar 114 procedime penale ose

rritje prej 54.05%; në Tropojë janë regjistruar 10 procedime penale ose rritje prej 25% dhe në Vlorë janë regjistruar 33 procedime penale ose rritje prej 22.22%.


Më poshtë paraqitet grafiksht shpërndarja gjeografike e procedimeve penale për cdo rreth gjatë vitit 2010 si dhe përqindjet përkatëse.



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 277 i Kodit Penal "Vetëgjyqësia"**, në vitin 2010, prej 6,77 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal "Vetëgjyqësia", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 3,44, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,69 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 17,74% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 10,95% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 45,67% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 6,77% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 277 "Vetëgjyqësia" i Kodit Penal.

Rezulton nga të dhënat statistikore se: në Sarandë është regjistruar 1 procedim penal; në Berat dhe Dibër janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Gjirokastrë, Lezhë dhe Lushnjë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Korçë dhe Mat janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Krujë, Kurbin, Shkodër dhe Tropojë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 7 procedime penale; në Fier, Kavajë, Kukës dhe Vlorë janë regjistruar nga 8 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 9 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 20 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal "Vetëgjyqësia".

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal "Vetëgjyqësia" dhe përqindjet përkatëse për cdo rreth.

Neni 277 "Vetegjyqesia"




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”**, në vitin 2010, prej 35,40 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 19,74, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 14,59 krime për 100.000 banorë.

Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 2,52% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 4,51% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 0,21% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 35,4% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” i Kodit Penal.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 278 "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit"



Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarja gjeografike e procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit":

Neni 278 "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve luftarake dhe e municionit"




Nga të dhënat statistikore rezulton se në Berat janë regjistruar 28 procedime penale ose rritje prej 75%; në Dibër janë regjistruar 30 procedime penale ose rritje prej 30.43%; në Durrës janë regjistruar 62 procedime penale ose rritje prej 6.89%; në Elbasan janë regjistruar 55 procedime penale ose rritje prej 139.13%; në Fier janë regjistruar 15 procedime penale ose rritje prej 200%; në Gjirokastrë janë regjistruar 21 procedime penale ose rritje prej 133.33%; në Kavajë në të dy vitet nuk është regjistruar asnjë procedim penal; në Korçë janë regjistruar 15 procedime penale ose rritje prej 7.14%; në Krujë janë regjistruar 20 procedime penale ose ulje prej 31.03%; në Kukës janë regjistruar 13 procedime penale ose ulje prej 7.14%; në Kurbin janë regjistruar 45 procedime penale ose rritje prej 45.16%; në Lezhë janë regjistruar 47 procedime penale ose rritje prej 34.28%; në Lushnje janë regjistruar 9 procedime penale ose rritje prej 50%; në Mat janë regjistruar 15 procedime penale përkundrejt 1 procedimi penal të regjistruar në vitin 2009; në Pogradec janë regjistruar 14 procedime penale ose rritje prej 180%; në Pukë janë regjistruar 15 procedime penale ose rritje prej 15.38%; në Sarandë janë regjistruar 13 procedime penale ose ulje prej 23.52%; në Shkodër janë regjistruar 60 procedime penale ose rritje prej 7.14%; në Tiranë janë regjistruar 110 procedime penale ose rritje prej 34.14%; në Tropojë janë regjistruar 10 procedime penale ose rritje prej 25% dhe në Vlorë janë regjistruar 34 procedime penale ose rritje prej 88.88%.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 279 i Kodit Penal "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta"**, në vitin 2010, prej 35 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,69, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,25 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 13,72% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 9,09% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 35% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 279 “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve të ftohta” i Kodit Penal.

Neni 279 "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve te ftohta"




Nga të dhënat statistikore vihet re se, në Kukës dhe Lushnje është regjistruar nga 1 procedim penal; në Dibrë, Durrës, Krujë, Kurbin, Sarandë dhe Vlorë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Korçë, Mat dhe Shkodër janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Berat dhe Kavajë janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 11 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 12 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 280 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjetisë dhe sportive”**, në vitin 2010, prej 57,14 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjetisë dhe sportive”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 2.41, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1.53 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj veprë penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore vihet re se, në vitin 2007 ka ulje prej 31,14% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 19,04% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 2% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 57,14% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 280 "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se: në Dibë, Korçë dhe Pogradec është regjistruar nga 1 procedime penal; në Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Sarandë dhe Tropojë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Berat, Elbasan dhe Kurbin janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Durrës dhe Lushnjë janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Lezhë janë regjistruar 6 procedime penale; në Fier janë regjistruar 7 procedime penale; në Tiranë janë regjistruar 9 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 11 procedime penale dhe në Shkodër janë regjistruar 12 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 280 "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve te gjuetise dhe sportive"




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 282 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive"**, në vitin 2010, prej 60 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 282 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,18, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,46 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):

Neni 282 " Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive "




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 është regjistruar 1 procedim penal; në vitin 2007 janë regjistruar 3 procedime penale; në vitin 2008 janë regjistruar 8 procedime penale; në vitin 2009 janë regjistruar 15 procedime penale dhe në vitin 2010 janë regjistruar 6 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 282 "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se në Durrës, Korçë, Lezhë dhe Tiranë është regjistruar nga 1 procedime penal dhe në Elbasan janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 282 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive".

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 288 i Kodit Penal "Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin"**. Në vitin 2010 janë regjistruar 7 procedime penale për këtë vepër penale ndërsa në vitin 2009 është regjistruar vetëm 1 procedim penal.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm. Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 janë regjistruar 6 procedime penale; në vitin 2007 janë regjistruar 4 procedime penale; në vitin 2008 janë regjistruar 5 procedime penale; në vitin 2009 është regjistruar 1 procedim penale dhe në vitin 2010 janë regjistruar 7 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 288 i Kodit Penal "Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të dëmshme për shëndetin".

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se nga 1 procedim penal është regjistruar në Berat dhe në Tiranë; 2 procedime penale janë regjistruar në Vlorë dhe 3 procedime penale janë regjistruar në Berat për veprën penale të parashikuar nga neni 288 i Kodit Penal "Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të dëmshme për shëndetin", gjatë vitit 2010.




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 289 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë"**, në vitin 2010, prej 34,37 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë", për 100 000 banorë në vitin 2010 është 1, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 2 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):


Neni 289 "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë"



Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka ulje prej 6,45% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 15,51% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 4,47% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 34,37% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 289 "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë" i Kodit Penal.

Grafiku më poshtë paraqet të dhënat në lidhje me shpërndarjen gjeografike:

Neni 289 "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë"




Nga të dhënat statistikore rezulton se: në Lezhë, Pukë, Sarandë dhe Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Korçë dhe Krujë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Dibër dhe Fier janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Elbasan, Kukës, Shkodër dhe Tiranë janë regjistruar nga 5 procedime penale dhe në Durrës janë regjistruar 6 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 289 “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” i Kodit Penal.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”**, në vitin 2010, prej 9,16 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 24.19, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 26.64 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike e kësaj vepre penale në raport me totalin e procedimeve penale të regjistruara në vitin 2009 ka qenë 5% dhe në vitin 2010 është 4%.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 34,7% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 0,11% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka numër të njëjtë procedime penale të regjistruara me vitin 2008, 851 procedime penale dhe në vitin 2010 ka ulje prej 9,16% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” i Kodit Penal.


Grafiku, më poshtë paraqet të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor":

Neni 290 "Shkelja e rregullave te qarkullimit rrugor"



Nga të dhënat statistikore rezulton se: në Berat, janë regjistruar 13 procedime penale ose ulje prej 7.14%; në Dibër janë regjistruar 5 procedime penale ose ulje prej 37.5%; në Durrës janë regjistruar 70 procedime penale ose ulje prej 23.07%; në Elbasan janë regjistruar 118 procedime penale ose rritje prej 34.09%; në Fier janë regjistruar 40 procedime penale ose ulje prej 2.43%; në Gjirokastrë janë regjistruar 13 procedime penale ose ulje prej 60.60%; në Kavajë janë regjistruar 44 procedime penale ose rritje prej 51.72%; në Korçë janë regjistruar 51 procedime penale ose rritje prej 27.5%; në Krujë janë regjistruar 37 procedime penale ose rritje prej 60.86%; në Kukës janë regjistruar 9 procedime penale ose rritje prej 125%; në Kurbin janë regjistruar 21 procedime penale ose ulje prej 38.23%; në Lezhë janë regjistruar 26 procedime penale ose ulje prej 35%; në Lushnje janë regjistruar 40 procedime penale ose ulje prej 28.57%; në Mat janë regjistruar 8 procedime penale ose rritje prej 100%; në Pogradec janë regjistruar 18 procedime penale ose ulje prej 40%; në Pukë janë regjistruar 2 procedime penale ose ulje prej 60%; në Sarandë janë regjistruar 3 procedime penale ose ulje prej 40%; në Shkodër janë regjistruar 42 procedime penale ose ulje prej 25%; në Tiranë janë regjistruar 173 procedime penale ose ulje prej 16.0%; në Tropojë janë regjistruar 7 procedime penale ose rritje prej 75%; në Vlorë janë regjistruar 33 procedime penale ose ulje prej 17.5%, për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor".


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur”, në vitin 2010, prej 1,19% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçenti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal "Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 10.61, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 10,48 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 84,11% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 23,35% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 37,86% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje të lehtë prej 1,19% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 291 "Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur" i Kodit Penal.

Në lidhje me të dëmtuarit nga lkjo vepër penale, rezultojnë nga të dhënat statistikore se 25 janë të rritur mbi 18 vjec meshkuj (ulje prej 30,55 %) dhe 2 femra (ulje prej 80%); pasojat në dëm të shëndetit, rezultojnë 4 plagosje e rëndë, shifër e njëjtë edhe me vitin 2009 dhe 41 raste me pasojë "plagosje e lehtë" që do të thotë ulje prej 51,76 % në krahasim me vitin 2009.

Më poshtë paraqitet grafikisht shpërndarje gjeografike e procedimeve penale për cdo rreth si dhe përqindjet përkatëse:


Ne ni 291 "Drejtimi i automjetit ne gjendje te dehur apo pa deshmi"



Rezulton nga të dhënat statistikore se: në Berat janë regjistruar 14 procedime penale qe do të thotë ulje prej 26.31%; në Dibër në të dy vitet janë regjistruar nga 5 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 55 procedime penale ose rritje prej 44.73%; në Elbasan janë regjistruar 24 procedime penale ose ulje prej 14.28%; në Fier janë regjistruar 12 procedime penale ose rritje prej 71.42%; në Gjirokastrë nuk është regjistruar asnjë procedim penale për këtë vepër penale, përkundrajt vitit 2009 kur rezultojnë 8 procedime penale; në Kavajë janë regjistruar 16 procedime penale ose rritje prej 6.66; në Korçë janë regjistruar 10 procedime penale ose rritje 100%; në Krujë janë regjistruar 6 procedime penale ose ulje prej 45.45%; në Kukës nuk është regjistruar asnjë procedim penale gjatë vitit 2010; në Kurbin janë regjistruar 23 procedime penale ose rritje prej 64.28%; në Lezhë janë regjistruar 33 procedime penale ose rritje prej 3.12%; në Lushnje janë regjistruar 18 procedime penale ose ulje prej 21.73%; në Mat në të dy vitet janë regjistruar nga 8 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 2 procedime penale; në Pukë është regjistruar 1 procedim penal; në Sarandë janë regjistruar nga 1 procedim penal për të dy vitet; në Shkodër janë regjistruar 30 procedime penale ose ulje prej 9.09%; në Tiranë janë regjistruar 67 procedime penale ose ulje prej 14.10%; në Tropojë nuk është regjistruar asnjë procedim penal dhe në Vlorë janë regjistruar 14 procedime penale ose rritje prej 75%.


Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Neni 291 "Drejtimi ia automjetit ne gjendje te dehur apo pa deshmi"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 293 i Kodit Penal "Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit"**; në vitin 2010 janë regjistruar 15 procedime penale përkundrejt vitit 2009 kur janë regjistruar 8 procedime penale.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 dhe në vitin 2007 janë regjistruar 3 procedimeve penale; në vitin 2008 janë regjistruar 6 procedime penale; në vitin 2009 janë regjistruar 8 procedime penale dhe në vitin 2010 janë regjistruar 15 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 293 "Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezultoni nga të dhënat statistikore se në Berat, Fier, Gjirokastrë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Pogradec, Tiranë dhe Tropojë është regjistruar nga 1 procedim penal dhe në rrethet Durrës, Mat dhe Vlorë janë regjistruar nga 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 293 "Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit" i Kodit Penal.

VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË, KREU X.

Në Kreun e Dhjetë të Kodit Penal parashikohen vepra penale kundër drejtësisë.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë grup veprash penale për 100.000 banorë në vitin 2009 ishte 10,52 ndërsa për vitin 2010 është 10,42. Është e qartë tendenca për ulje të koeficientit të kriminalitetit për këtë grup veprash penale në shkallë Republike.

E shprehur në përqindje për të dy vitet, pesha specifike që ky grup veprash penale zë, është 1,98 % (për qind) për vitin 2009 dhe 1,72 % (për qind) për vitin 2010 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë Republike. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreun e Dhjetë i Kodit Penal dhe konkretisht me veprat penale kundër drejtësisë.

	2009					2010				
	Nr. Proc d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pan d. Regj .	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand enua r	Nr. Proc d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand enua r
V.P. Kundër Drejtësisë										
Neni 300 Moskallzimi i krimit	10	6	48	57	48	18	21	92	126	86
Neni 301 Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës	7	6	10	16	12	2	2	11	10	10
Neni 302 Përkrahja e autorit të krimit	3	3	7	12	8	4	3	10	10	11
Neni 303 Fshehja ose asgjësimi i kufomës	0	0	1	2	1	0	0	0	0	0
Neni 304 Detyrimi për të kallzuar provën	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0
Neni 305 Kallzimi i rremë	39	45	38	54	38	32	36	30	40	38
Neni 305/a Deklaratat e rreme përpara prokurorit	1	1	1	1	1	1	2	1	2	3
Neni 305/b Deklaratat e rreme përpara of.pol.gjyq.	16	24	26	43	40	22	20	31	35	25
Neni 306 Dëshmia e rreme	27	26	25	35	32	31	25	27	25	24
Neni 307 Refuzimi për të dëshmuar	0	0	0	0	1	2	1	1	1	0
Neni 308 Përkthimi i rremë	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 309 Ekspertimi i rremë	20	5	3	6	1	12	1	1	1	0
Neni 310 Mosparaqitja e dëshmitarit, ekspertit apo përkthyesit	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 311 Kanosja për të mos kallëzuar	5	2	3	2	3	5	0	1	0	0
Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit, ose përkthyesit	2	1	0	2	0	1	0	0	0	2
Neni 312/a Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë	2	0	0	0	0	2	0	3	0	0
Neni 313 Fillimi i paligjshëm i ndjekjes penale	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0
Neni 313/a Zhdukja ose humbja e fashikull	2	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 313/b Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 314 Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 315 Dhënia e një vendimi të padrejtë	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 316 Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit	6	2	7	2	1	1	1	1	2	2
Neni 317 Kanosja e gjyqtarit	4	1	4	1	0	4	2	2	3	0
Neni 318 Fyerja e gjyqtarit	9	3	5	3	1	6	5	6	5	3
Neni 320 Pengime për ekzekutimin e e vendimeve të gjykatës	115	53	70	53	40	135	75	95	76	63
Neni 320/a Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës	22	0	2	0	0	2	1	5	1	0
Neni 321 Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës	11	7	7	7	6	12	2	6	2	2
Neni 322 Prishja e vulave dhe shenjave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Neni 323 Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit	22	20	21	20	13	37	34	38	35	25
Neni 324 Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim	4	1	4	1	0	1	0	0	0	1
Totali	336	205	283	317	246	333	231	361	374	295

Nga të dhënat rezultojnë se në vitin 2010 ka një ulje prej 89 % (për qind) të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër drejtësisë në krahasim me vitin 2009. Ndërkaq kemi rritje prej 12,68 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2009. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2009 prej 27,56 % (për qind); një rritje të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit prej 17,98 % (për qind) dhe kemi rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 19,91 % (për qind) përkundrejt vitit 2009.

TE PANDEHURIT

Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2010 në total janë 481 tregues vihet re rritje prej 19,95% (për qind) e të pandehurve në hetim në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2010 për 374 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë, që do të thotë rritje prej 15,24% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të pandehurit, 17 kanë qenë të pandehur të mitur meshkuj (rritje prej 76,47%) dhe 5 femra; të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) 39 femra dhe 316 (rritje prej 25%) meshkuj.

Nuk rezultojnë asnjë shtetas i huaj në vitin 2010 i pandehur, përkundrejt vitit 2009 kur rezultojnë 2 të tillë.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezultojnë se 243 të pandehur janë me arsim deri 9-vjeçar (rritje prej 16,46%) dhe 106 me arsim të mesëm (rritje prej 37,73%) dhe 25 të pandehur me arsim të lartë (rritje prej 40%). Sikurse vihet re faktorë kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë së pari me nivelin arsimor të të pandehurve, ku pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të jenë me arsim deri 9-vjeçar.

Përsa i përket gjëndjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej nga sektori shtetëror janë regjistruar 7 të pandehur (që do të thotë shifër e njëjtë për të dy vitet. Nga këta, 1 i pandehur është nëpunës i nivelit të mesëm dhe 5 të pandehur nëpunës i thjeshtë.

Nga sektori privat janë regjistruar 51 të pandehur (rritje prej 3,92% për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe të papunë 209 (rritje prej 6,22% (për qind) në krahasim me vitin 2009. Pra, faktorët kriminogjenë që ndikojnë në ecurinë e kësaj veprash penale kanë të bëjnë me arsimimin e personave të marrë si të pandehur si dhe me nivelin e papunësisë.

Rezultojnë se 277 të pandehur kanë vendbanimin në qytet (rritje prej 34,29%) ndërsa 94 prej tyre në komuna (ulje prej 8,5 %). Pra tendenca është e tillë që ka një prani më të madhe të këtij fenomeni në zonat urbane.


Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve janë të padënuar më parë, 318 të pandehur, vetëm 9 prej tyre është përsëritës për të njëjtën vepër penale (rritje prej 88,88%), ndërsa 45 të pandehur janë përsëritës për vepra penale të ndryshme (rritje prej 60%).

TENDENCA

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 300 i Kodit Penal “Moskallëzimi i krimit”**, në vitin 2010, prej 80 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal “Moskallëzimi i krimit”, për 100 000 banorë në vitin 2010 është 0,65, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,31 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 50% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 16,67% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 80% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 300 “Moskallëzimi i krimit” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në rrethet Berat, Durrës, Kukës, Lezhë, Mat dhe Sarandë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Elbasan dhe Kavajë janë regjistruar nga 2 procedime penale dhe në Shkodër dhe Tiranë janë regjistruar nga 4 procedime penale për veprën penale të parashikura nga neni 300 i Kodit Penal “Maskallëzimi i krimit”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të rregjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 305 i Kodit Penal “Kallzimi i rremë”**, në vitin 2010, prej 17,94 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal “Kallzimi i rremë”, për 100 000 banorë në vitin 2010 është 1, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 1,22 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2007 ka rritje prej 36% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka ulje prej 11,76% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 30% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka ulje prej 17,94% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 305 “Kallzimi i rremë” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në rrethet Kukës, Kurbin, Mat dhe Shkodër është regjistruar nga 1 procedim penal; në Berat dhe Sarandë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Durrës, Fier, Korçë, Tiranë dhe Vlorë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Lushnje janë

regjistruar 4 procedime penale dhe në Elbasan janë regjistruar 5 procedime penale për veprën penale të parashikura nga neni 305 i Kodit Penal "Kallzimi i rremë".


Sa në sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 305/b i Kodit Penal "Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore"**, në vitin 2010, prej 37,5 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal "Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore", për 100 000 banorë në vitin 2010 është 0,68, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,5 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2008 ka rritje prej 160% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 23% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 37,5% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 305/b "Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se në rrethet Durrës, Elbasan, Korçë, Kukës, Kurbin, Lushnje dhe Sarandë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Shkodër janë regjistruar 3 procedime penale; në Berat janë rregjistruar 4 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 8 procedime penale.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


Neni 305/b "Deklaratat e rreme perpara oficerit te policise gjyqesore"



Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 306 i Kodit Penal "Deshmia e rreme"**, në vitin 2010, prej 14,81 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 306 i Kodit Penal "Deshmia e rreme", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,97, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,84 krime për 100 000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2007 ka ulje prej 14,28% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 38,88% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 8% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 14,81% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 306 "Dëshmia e rreme" i Kodit Penal.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale të regjistruara për çdo rreth si dhe përqindjet përkatëse:




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në rrethet Krujë dhe Pogradec është regjistruar nga 1 procedim penal; në Korçë dhe Lezhë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Berat dhe Fier janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Durrës dhe Vlorë janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 5 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 6 procedime penale për veprën penale të parashikura nga neni 306 i Kodit Penal “Dëshmia e rreme”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 309 i Kodit Penal “Ekspertimi i rremë”**, në vitin 2010, prej 40 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal “Ekspertimi i rremë”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0,37, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,62 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):




Rezultoni nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka rritje prej 111,11% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 5,26% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 janë rregjistruar 20 procedime penale sikurse dhe në vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka ulje prej 40% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 309 “Ekspertimi i rremë” i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të procedimeve penale për këtë vepër penale, rezultoni nga të dhënat statistikore se në rrethet Elbasan, Fier, Gjirokastër dhe Lushnje është regjistruar nga 1 procedim penal; në Korçë dhe Tiranë janë regjistruar nga 2 procedime penale dhe në Vlorë janë regjistruar 4 procedime penale për veprën penale të parashikura nga neni 309 i Kodit Penal “Ekspertimi i rremë”.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 320 i Kodit Penal "Pëngime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës"**, në vitin 2010, prej 17,39 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal "Pëngime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës", për 100.000 banorë në vitin 2010 është 4,22, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,6 krime për 100 000 banorë.


Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara pranë organit të prokurorisë):



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka ulje prej 14,7% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 5,17% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 88,52% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 17,39% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 320 "Pëngime për ekzekutimin e vendimeve penale" i Kodit Penal.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se: në Gjirokastrë dhe Sarandë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Kavajë janë regjistruar 2 procedime penale; në Kukës dhe Mat janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Fier, Lezhë dhe Lushnjë janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 5 procedime penale; në Dibër dhe Korçë janë regjistruar nga 6 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 7 procedime penale; në Durrës janë regjistruar 10 procedime penale; në Berat janë regjistruar 11 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 16 procedime penale; në Shkodër janë regjistruar 19 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 33 procedime penale për veprën penale të parashikura nga neni 320 i Kodit Penal "Pëngime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës".

Neni 320 "Pengime per ekzekutimin e vendimeve te gjykates"




Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga neni 320/a i Kodit Penal "Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës", në vitin 2010, prej 90 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koefiçienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga **neni 320/a i Kodit Penal "Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës"**, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 0.06 ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0.68 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si vijon:

Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2006 janë regjistruar 2 procedime penale; në vitin 2007 janë regjistruar 3 procedime penale; në vitin 2008 janë regjistruar 6 procedime penale; në vitin 2009 janë regjistruar 22 procedime penale dhe në vitin 2010 janë regjistruar 2 procedime penale, për veprën penale të parashikuar nga neni 320/a "Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës" i Kodit Penal.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se, 1 procedim penal është regjistruar në Tiranë dhe 1 procedim penal është regjistruar në Elbasan për veprën penale të parashikuar nga neni 320/a i Kodit Penal “Mosekzekutimi pa shkaqe të përlegjura i vendimit të gjykatës” gjatë vitit 2010.


Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprën penale të parashikuar nga **neni 323 i Kodit Penal “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”**, në vitin 2010, prej 68,18% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, për 100.000 banorë në vitin 2010 është 1,15, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,68 krime për 100.000 banorë.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2006-2010 paraqitet si vijon:


Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2007 ka ulje prej 18,18% (për qind) në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 111,11% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka rritje prej 15,78% (për qind) në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara dhe në vitin 2010 ka rritje prej 68,18% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 323 “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” i Kodit Penal.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, rezulton nga të dhënat statistikore se: në Fier, Mat dhe Vlorë është regjistruar nga 1 procedim penal; në Elbasan, Kavajë dhe Korçë janë regjistruar nga 2 procedime penale; në Durrës dhe Gjirokastrë janë regjistruar nga 3 procedime penale; në Berat dhe Krujë janë regjistruar nga 4 procedime penale; në Lezhë dhe Tiranë janë regjistruar nga 7 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit".

Neni 323 "Largimi i te burgosurit nga vendi i qendrimit"



KREU X, VEPRAT PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE.

Ne Kreu e X i Kodit Penal parashikohen veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”.

Rezulton nga të dhënat statistikore se në këtë kre, janë regjistruar gjatë vitit 2010 vetëm 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga Neni 326 i Kodit Penal ”Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve”. Është dërgua në gjyq 1 procedim penal, janë regjistruar 15 të pandehur. Për 15 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë dhe rezultojnë 20 të dënuar nga gjykata (llogaritur këtu dhe vendimet për të pandehurit që kanë qënë nga dosjet e mbartura)

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna në lidhje me veprat penale të cilat parashikohen në Kreu e X i Kodit Penal dhe konkretisht me veprat penale kundër zgjedhjeve të lira.


	2009					2010				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand . Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
V.P për zgjedhjet e lira										
Neni 325 Pengimi I subj.për zgjedhjet në orga. përfaqësese	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 326 Fals. I dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve	1	1	0	1	1	3	1	15	15	20
Neni 327 Shkelja e fshehtësisë së votimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 328 Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 329 Kanosja e zgjedhësit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 330 Kanosja e kandidatëve	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 331 Shkelja e të drejtës së zgjedhjes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 332 Shpërdorimi i autoritetit ushtar.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	9	1	0	1	1	3	1	15	15	20

Neni 90 i ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë, parashikon shprehimisht se: “Ushtrimi i palicencuar i veprimtarisë”

1. Ushtrimi i veprimtarisë bankare ose i çdo veprimtarie tjetër financiare, të parashikuar në nenet 4 dhe 54 të këtij ligji, pa licencë të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, përbën krim dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.
2. Kur nga veprimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni u janë shkaktuar pasoja të rënda interesave të shtetasve ose atyre shtetërore, kryerja e veprimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

Në lidhje me këtë nen, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2010 ka rritje të procedimeve penale të regjistruar për këtë veprë penale prej 51,42% (për qind) ne krahasim me vitin 2009.


Më poshtë paraqitet grafikisht procedimet penale të regjistruara në katër vitet e fundit:



Rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2008 ka ulje prej 29,80% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka ulje prej 52% (për qind) të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka rritje prej 51,42% të procedimeve penale të regjistruara për nenin 90 të Ligjit nr. 9662.


Më poshtë paraqiten grafikisht të dhëna në lidhje me shpërndarja gjeografike për këtë vepër penale për vitin 2009, sipas rretheve dhe përqindjet përkatëse:

Neni 90 Ligji per Bankat



Rezulton nga të dhënat statistikore se: në Dibër dhe Mat është regjistruar nga 1 procedim penal; në Kavajë janë regjistruar 2 procedime penale; në Pogradec janë regjistruar 4 procedime penale; në Vlorë janë regjistruar 6 procedime penale; në Lushnje janë regjistruar 7 procedime penale; në Korçë janë regjistruar 8 procedime penale; në Elbasan janë regjistruar 9 procedime penale; në Berat janë regjistruar 10 procedime penale; në Durrës dhe Shkodër janë regjistruar 11 procedime penale; në Fier janë regjistruar 16 procedime penale dhe në Tiranë janë regjistruar 20 procedime penale për nenin 90 të Ligjit 9662 “Për Bankat”, gjatë vitit 2010.

Më poshtë paraqitet grafiksht shpërndarja gjeografike për këtë vepër penale për vitet 2009-2010 sipas rretheve:



NË LIDHJE ME DINAMIKËN E VEPRAVE PENALE TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR.8003, DATË 28.9.1995(I NDRYSHUAR) “KODI PENAL USHTARAK”


Nga të dhënat statistikore, vihet re se në lidhje me veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak, vihet re një tendencë për ulje të ndjeshme për procedimet e rregjistruara në lidhje me veprat penale të parashikuara nga Kreu i Tretë i Kodit Penal Ushtarak, “Shmangia nga shërbimi ushtarak” ku vihet re një ulje e ndjeshme e procedimeve penale të rregjistruara në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009, prej 72,13% (për qind). Kështu në vitin 2010 janë rregjistruar 107 procedime penale për këtë grup veprash penale ndërsa në vitin 2009 janë rregjistruar 384 procedime penale për këtë grup veprash penale.

Vihet re rritje e procedimeve penale të regjistruara për vepra penale të parashikuara nga Kreu i V i Kodit Penal Ushtarak “Vjedhje, shpërdorime, falsifikime”. Kështu, në vitin 2009 janë regjistruar 8 procedime penale, ndërsa në vitin 2010 janë regjistruar 19 procedime penale për këtë grup veprash penale.

TË DHËNAT PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2010

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehur në hetim në pesë vitet e fundit (2006 – 2010). Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur të cilët janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të regjistruar nga organi i prokurorisë dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë.

TE DHENA PER TE PANDEHURIT 2010



Sikurse shihet nga grafiku i mësipërm, të dhënat tregojnë për një rritje në përgjithësi të numrit të pandehurve në hetim nga viti në vit dhe me një ulje të lehtë në vitin 2009.

Në lidhje me të pandehurit e regjistruar, nga të dhënat statistikore rezultojnë se dinamika e këtij treguesi në pesë vite është si më poshtë:

Në vitin 2006 janë regjistruar 8031 të pandehur, që do të thotë 7,62% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 janë regjistruar 9015 të pandehur, që do të thotë 12,25% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 janë regjistruar 9548 të pandehur, që do të thotë 5,9% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 janë regjistruar 8130 të pandehur, që do të thotë ulje prej 14,85% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë regjistruar 10558 të pandehur që do të thotë rritje prej 29,86% në krahasim me vitin 2009.

Të pandehur të mbartur, nga viti në vit, duke marrë në referencë vitet 2006-2009 rezultojnë se:

Në vitin 2006 janë mbartur 1920 të pandehur, që do të thotë 3,95% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 janë regjistruar 1908 të pandehur, që do të thotë 0,625% (për qind) më pak se në vitin 2006; në vitin 2008 janë mbartur 2230 të pandehur, që do të thotë 16,87% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 janë mbartur 2962 të pandehur, që do të thotë rritje prej 32,82% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë mbartur 2828 të pandehur që do të thotë ulje prej 4,52% (për qind) në krahasim me vitin 2009.


Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezulton se:

Në vitin 2006 janë rifilluar hetimet për 146 të pandehur, që do të thotë 12,3% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 janë rifilluar hetimet për 237 të pandehur, që do të thotë 62,32% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 janë rifilluar hetimet për 136 të pandehur, që do të thotë 42,6% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 janë rifilluar hetimet për 152 të pandehur, që do të thotë rritje prej 11,76% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë rifilluar hetimet për 156 të pandehur, që do të thotë rritje prej 2,63% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në vitin 2006 është ngritur akuza në gjykatë për 7529 të pandehur ose 7% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 është ngritur akuza në gjykatë për 7719 të pandehur ose 2,52% më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 është ngritur akuzë në gjykatë për 8726 të pandehur ose 13% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 është ngritur akuzë në gjykatë për 8352 të pandehur ose 4,28% (për qind) më pak se në vitin 2008 dhe në vitin 2010 është ngritur akuza në gjykatë 9261 të pandehur që do të thotë rritje prej 10,88% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Më poshtë paraqiten grafikisht të dhëna mbi të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë ne gjykatë, të pandehur të gjykuar dhe të dënuar, në pesë vitet e fundit (2005-2009):

TE DHENA PER PERSONAT E GJYKUAR DHE TE DENUAR



Në lidhje me të pandehurit të gjykuar në raport me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rezultojn nga të dhënat statistikore se:

Në vitin 2006, 09% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2007, 87,53% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2008, 86% e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar; në vitin 2009, 89,2% e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar dhe në vitin 2010, 87,12% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit janë gjykuar.

Në lidhje me të pandehurit e dënuar të dhënat rezultojnë si vijon:

Në vitin 2006 janë dënuar 6795 të pandehur ose 90% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit; në vitin 2007 janë dënuar 5859 të pandehur ose 75,9% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit; në vitin 2008 janë dënuar 7278 të pandehur ose 83,4% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2009 janë dënuar 7172 të pandehur ose 85,87% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit dhe në vitin 2010 janë dënuar 7763 të pandehur ose 83,82% (për qind) e të pandehurve të dërguar gjyqit.

Rezultojn se treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve ka ardhur në rritje, kështu:

Për vitin 2005 rreth 94,86% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2006 rreth 96,94% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2007 rreth 86,71% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata; për vitin 2008 rreth 96,76% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe në vitin 2009 rreth 96,29% (për qind) e

personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata dhe për vitin 2010 rreth 96,20% (për qind) e personave të gjykuar janë shpallur fajtorë nga gjykata.

Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite, në ngritjen e akuzës në fazën e hetimit paraprak rezulton se:

Në vitin 2006 rreth 74,56 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2007 rreth 69,16 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim; në vitin 2008 rreth 73,24 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2009 rreth 74,27 % (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim dhe në vitin 2010 rreth 68,38% (për qind) e personave për të cilët është ngritur akuzë në fazën e hetimit paraprak janë dërguar për gjykim.


GJINIA E TË PANDEHURVE

Rezultoni nga të dhënat statistikore për të pandehurit meshkuj se:

Në vitin 2007 janë 8489 të pandehur ose rritje prej 9,94% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë 8870 të pandehur ose rritje prej 4,48% (për qind) në krahasim me vitin 2007 dhe në vitin 2009 janë 7555 të pandehur ose ulje prej 14,82% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë 9425 të pandehur ose rritje prej 24,75% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Për të pandehurit femra rezultoni nga të dhënat statistikore se: në vitin 2007 janë 523 të pandehura ose rritje prej 14,94% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 janë 457 të pandehura ose ulje prej 12,6% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 janë 378 të pandehura ose ulje prej 17,28% (për qind) në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 janë 458 të pandehura ose rritje prej 21,16% në krahasim me vitin 2009.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




TË PANDEHUR TË MITUR.

Në lidhje me të pandehurit të mitur, nga të dhënat statistikore rezulton se: në vitin 2006 rezultojnë 431 të mitur të pandehur ose 27,89% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007 rezultojnë 580 të mitur të pandehur ose 34,57% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 889 të mitur të pandehur ose 53,27% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 665 të mitur të pandehur ose 25,19% (për qind) më pak se në vitin 2008 dhe në vitin 2010 rezultojnë 870 të mitur ta pandehur ose rritje prej 30,82% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

TE PANDEHUR TE MITUR



Në lidhje me të pandehurit të mitur, rezultojnë nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 nga 665 të pandehur, 636 janë meshkuj dhe 29 janë femra.

Në vitin 2010, nga 870 të pandehur të mitur, 853 janë meshkuj, që do të thotë rritje prej 34,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009 dhe 17 janë femra, që do të thotë ulje prej 41,37% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Nga të dhënat e vitit 2009 rezultojnë se janë marrë si të pandehur edhe 119 shtetas të huaj dhe në vitin 2010 janë marrë të pandehur 136 shtetas të huaj, që do të thotë rritje prej 14,28% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me arsimimin e të pandehurve, nga të dhënat statistikore vihet re se:


Me arsim deri 9-vjecar, rezultojnë në vitin 2006, 5130 të pandehur ose 7,4% (për qind) më shumë në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 rezultojnë 5338 të pandehur ose 4% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 5942 të pandehur ose 11,31% (për qind) më shumë se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 5123 të pandehur ose 13% (për qind) më pak se në vitin 2008 dhe në vitin 2010 rezultojnë 6069 të pandehur që do të thotë rritje prej 18,46% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Me arsim të mesëm, rezultojnë 2643 të pandehur në vitin 2006 ose 8,8% (për qind) më shumë se në vitin 2005; në vitin 2007, rezultojnë 3140 të pandehur ose 18,8% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 2965 të pandehur ose 5,57% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 2416 të pandehur ose 18,5% (për qind) më shumë se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 3279 të pandehur që do të thotë rritje prej 35,72% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Me arsim të lartë, rezultojnë 360 të pandehur në vitin 2006 ose 2% (për qind) më pak se në vitin 2005; në vitin 2007, rezultojnë 489 të pandehur ose 35,83% (për qind) më shumë se në vitin 2006; në vitin 2008 rezultojnë 431 të pandehur ose 11,8% (për qind) më pak se në vitin 2007; në vitin 2009 rezultojnë 397 të pandehur ose 7,88% (për qind) më pak se në vitin 2008; në vitin 2010 rezultojnë 486 të pandehur, që do të thotë rritje prej 22,41% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

TE DHENA MBI ARSIMIN E TE PANDEHURVE 2006-2010




Përsa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, për të pandehur të cilët janë të punësuar në sektorin shtetëror, rezulton se në vitin 2010 janë 602, përkundrejt 506 të tillë në vitin 2009, që do të thotë se ka një rritje prej 18,97% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Rezulton nga të dhënat statistikore se të pandehur të cilët janë të punësuar në sektorin privat në vitin 2010 të jenë 1833 përkundrejt 1500 të tillë në vitin 2009, që do të thotë se ka rritje prej 22,2% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Të pandehur të papunë, rezultojnë nga të dhënat statistikore se janë gjithsej 5082 të pandehur, përkundrejt 4888 në vitin 2009, që do të thotë rritje prej 3,96% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Sa më sipër, paraqitet në grafikun më poshtë:

TE DHENA MBI GJENDJEN SHOQERORE TE TE PANDEHURVE



Në lidhje me vendbanimin e personave të cilet janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton:


Të pandehur me vendbanim në qytet rezultojnë në vitin 2009 gjithsej 4634 të pandehur dhe në vitin 2010 rezultojnë 6166 të pandehur, që do të thotë rritje prej 33,05% (për qind) në krahasim me vitin 2009;

Në lidhje me të pandehurit me vendbanim në komunë, rezulton nga të dhënat statistikore se në vitin 2009 gjithsej 3247 të pandehur dhe në vitin 2010 rezultojnë 3635 të pandehur, që do të thotë rritje prej 11,94% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Pavarësisht tendecave në rritje për të dy kategoritë, kriminaliteti mbetet një fenomen i pranishëm më shumë në zonat urbane sesa në zonat rurale.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

TE DHENA MBI VENDBANIMIN E TE PADENHURVE




Përsa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2009 rezultojnë të pandehur të cilët janë përsëritës për të njëjtën veprë penale 174 persona dhe në vitin 2010 rezultojnë 245 të tillë që do të thotë rritje prej 40,80% (për qind) në krahasim me vitin 2009;

Përsëritës për vepra penale të ndryshme rezultojnë 304 persona në vitin 2009 dhe 380 të tillë në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 25% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Të pandehur të padënuar më parë, rezultojnë 7407 persona në vitin 2009 dhe 9181 të tillë në vitin 2010, që do të thotë rritje prej 23,95% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

TE DHENA MBI GJENDJEN GJYQESORE TE TE PANDEHURVE 2009-2010



Në lidhje me pasojat e veprave penale, në dëm të shëndetit, nga të dhënat statistikore rezultojnë se ka një rënie të pasojës me vdekje nga veprat penale gjatë vitit 2010 prej 36,11% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (540 raste në vitin 2009 dhe 345 në vitin 2010);


Me ulje, rezulton pasoja nga veprat penale “plagosje e rëndë” dhe ulja është prej 12,31% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (276 raste në vitin 2009 dhe 242 në vitin 2010).

Me ulje rezulton të jetë dhe pasojë e veprës penale “plagosje e lehtë” rezulton me ulje prej 8,32% (për qind) në krahasim me vitin 2009 (685 raste në vitin 2009 dhe 628 në vitin 2010).

Në shifrat e mësipërme përfshihen pasojat në dëm të jetës dhe të shëndetit të personave, për cdo fakt të dyshuar kriminal të hetuar, pavarësisht nga mënyra e përfundimit të procedimit rreth tij.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

TE DHENA MBI PASOJAT NE DEM TE SHENDETIT 2009-2010



■ 2009 ■ 2010

Gjatë vitit 2009, rezultojnë të dëmtuar-viktima të veprave penale 941 persona, nga të cilët, të dëmtuar-viktima të mitur janë 61 meshkuj dhe 16 femra; të rritur rezultojnë nga të dhënat statistikore, 722 meshkuj dhe 142 femra.

Gjatë vitit 2010, rezultojnë të dëmtuar-viktima të veprave penale 1045 persona, nga të cilët, të dëmtuar-viktima të mitur janë 101 meshkuj (rritje prej 27%) dhe 27 femra (rritje prej 68,75%); të rritur rezultojnë nga të dhënat statistikore, 777 meshkuj (rritje prej 7,61%) dhe 140 femra (rritje prej 1,4%).

Ne total do të thotë rritje e viktimave në vitin 2010 prej 11,051% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KERKUARA NGA PROKURORËT


Të dhënat statistikore tregojnë për rritje të dënimeve me gjobë (kërkesa të prokurorëve) gjatë vitit 2010 dhe rritja është prej 13,09 % (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Vihet re se: në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 23% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 53,92% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 3,35% (për qind) dhe në vitin 2010 ka rritje prej 13,9% (për qind) kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi.

Vihet re se në vitin në vitin 2007 ka ulje të vendimeve të gjykatës për dënimin me gjobë prej 19,75% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 51,88 % (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 2,44% (për qind) dhe në vitin 2010 ka rritje prej 11,32% (për qind) të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.

Në lidhje me dënimin me gjobë, grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e tij në pesë vitet e fundit (2006-2010)

TE DHENA MBI DENIMIN ME GJOBE 2006-2010




Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum:

Vihet re se në vitin 2007 ka ulje të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim krahasuar me vitin 2006 prej 13,54% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 31,81% (për qind) në krahasim me vitin 2007 të këtij treguesi; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 4,32% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi dhe në vitin 2010 vihet re përsëri ulje e kërkimit të prokurorëve për këtë lloj dënimi prej 30,67% (për qind) në krahasim me vitin 2009

Vihet re se në vitin 2007 ka një ulje prej 19,85% (për qind) të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në minimum, krahasuar me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje të ndjeshme prej 29,65% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 2,1% (për qind), të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi dhe në vitin 2010 ka një ulje prej 22,03% (për qind) të vendimit të gjykatës për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2009

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë në pesë vitet e fundit të masës së dënimit me burgim në minimumin e parashikuar nga ligji:




Në lidhje me dënimin me burgim mesatar:

Vihet re se në vitin 2007 ka një ulje prej 1,95% (për qind) të kërtimeve të prokurorëve për dënimin me burgim mesatar, krahasuar me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 1,1% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 2,75% (për qind), kërtime të prokurorit për këtë lloj dënimi; në vitin 2010 ka një rritje të theksuar prej 14,45% (për qind) të kërtimeve të prokurorit për dënim mesatar.

Vihet re se në vitin 2007 ka një ulje prej 2,90% (për qind) të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim mesatar, krahasuar me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje të lehtë prej 0,93% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje prej 4,79% (për qind), vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2010 ka rritje prej 21,08% (për qind) të vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi.


Në pesë vite, kërkimet e prokurorëve dhe vendimet e gjykatës për masë dënimi mesatar, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

DENIM MESATAR 2006-2010



Grafiku i mëposhtëm paraqet masën e dënimit me burgim në maksimum gjatë pesë viteve të fundit:

DENIM NE MAKSIMUM 2006-2010




Vihet re se në vitin 2007 ka një ulje prej 8,75% (për qind) të kërkimeve të prokurorëve për dënimin me burgim në maksimum, krahasuar me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 24,35% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,87% (për qind), kërkime të prokurorit për këtë lloj dënimi; në vitin 2010 ka rritje të ndjeshme prej 56,27% (për qind) të kërkimeve të prokurorit për këtë lloj dënimi, në krahasim me vitin 2009.

Vihet re se në vitin 2007 ka ulje të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum prej 12,44% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 30,33% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 4,76% (për qind), vendimeve të gjykatës për këtë lloj dënimi; në vitin 2010 ka ulje prej 5,84% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të vendimeve të gjykatës për dënimin me burgim në maksimum.

Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji në pesë vitet e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

ULJA E DENIMIT NEN KUFIJTE E PARASHIKUAR NGA LIGJI 2006-2010




Ecuria në pesë vitet fundit (2006-2010) paraqitet e tillë që: në vitin 2006 ka një ulje prej 71,42% (për qind) të kërkimeve të prokurorëve për ulje të dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, krahasuar me vitin 2005; në vitin 2007 ka ulje të këtij treguesi prej 10% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 33,33% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një rritje prej 3,5 herë për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2008 dhe në vitin 2010 përsëri vihet re rritje e ndjeshme prej 333,33% për këtë kërkim nga prokurori në krahasim me vitin 2009.

Ecuria në pesë vitet fundit (2006-2010) paraqitet e tillë që: në vitin 2006 ka një ulje prej 75,75% (për qind) të kërkimeve të prokurorëve për ulje të dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, krahasuar me vitin 2005;

në vitin 2007 ka rritje të këtij treguesi prej 156,25% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një ulje prej 39,02% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një rritje prej 36% (për qind) për këtë lloj dënimi në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009 ka rritje të ndjeshme prej 261,76% (për qind) në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” si kërkime të prokurorit, në pesë vitet e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm:


**NENI 59 PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TE VENDIMIT ME BURGIM DHE
VENIA NE PROVE 2006-2010**



Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2007 ka ulje të kërkimeve të prokurorëve për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” prej 1,29% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 0,65% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje të lehtë prej 0,97% (për qind), kërkime të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në parashikim të nenit 59 të kodit penal dhe në vitin 2010 ka rritje prej 17,63% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të këtij treguesi.

Nga të dhënat statistikore, vihet re se: në vitin 2007 ka ulje të vendimeve të gjykatës për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, prej 13,64% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 18% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një rritje të lehtë prej 1,02% (për qind), kërkime të prokurorit për “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” në parashikim të nenit 59 të Kodit Penal; në vitin 2009 ka rritje prej 13,71% në krahasim me vitin 2009 të këtij treguesi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e dënimit me burgim të përjetshëm për vitet 2005-2009:




Nga të dhënat statistikore rezulton se:


Në vitin 2007 ka ulje të kërkimeve të prokurorit për këtë masë dënimi prej 56,25% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 214,28% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje prej 31,81% (për qind), kërkime të prokurorit për masën e dënimit, burgim i përjetshëm; në vitin 2010 ka ulje prej 26,66% (për qind) në krahasim me vitin 2009 për këtë masë dënimi.

Nga të dhënat statistikore rezulton se: në vitin 2007 ka ulje të vendimeve të gjykatës për këtë masë dënimi prej 61,53% (për qind) në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka një rritje prej 160% (për qind) në krahasim me vitin 2007; në vitin 2009 ka një ulje prej 61,53% (për qind), kërkime të prokurorit për masën e dënimit, burgim i përjetshëm; në vitin 2010 ka rritje prej 20% (për qind) në krahasim me vitin 2009 të vendimeve të gjykatës për këtë masë dënimi.


TE DHENA LIDHUR ME KERKESEN E PROKURORIT DHE VENDIMIN E GJYKATES PER VITIN 2010




LLOJET E DENIMEVE TE KERKUARA NGA PROKURORET DHE VENDIMI I GJYKATES PER DENIMIN ME BURGIM PER VITIN 2010




KERKESA E PROKURORIT PER DENIMIN ME BURGIM



VENDIMI I GJYKATES



KËRKESAT E PROKURORIT



TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2010.

Pjesë shumë e rëndësishme e punës së organit të prokurorisë janë edhe marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja. Në vijim paraqesim të dhëna statistikore në lidhje me ekstradimet nga jashtë brenda:

Nga të dhënat statistikore rezulton se në gjatë vitit 2010 janë ekstraduar fizikisht në Shqipëri 52 persona. Këto ekstradime janë realizuar si më poshtë vijon: 24 persona të ekstraduar nga Italia, 9 nga Greqia, 3 nga Belgjika, 3 Mbretëria e Bashkuar, 3 nga Gjermania, 2 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 2 Spanja, 2 Holanda dhe nga 1 Franca, Turqia dhe Bullgaria etj. Sikurse vihet re edhe nga të dhënat statistikore rezulton se numri më i madh i personave të ekstraduar gjatë vitit 2010 rezulton të jetë me shtete fqinje si Italia dhe Greqia ku edhe numri i shtetasve shqiptare është edhe më i lartë. Tendencë kjo e njëjtë me atë të viteve të mëparshme.

Në lidhje me kërkesat për ekstradime, nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2010 janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë në total 69 kërkesa për ekstradim dhe konkretisht: në Itali 18 kërkesa, në Greqi 14 kërkesa, në Mbretërinë e Bashkuar 10 kërkesa, në Gjermani 7 kërkesa, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 6 kërkesa, etj.

Për çdo rast për të cilin Prokuroria e Përgjithshme është njoftuar nga ZQK INTERPOL TIRANA për lokalizim apo arrestim të personave për qëllim ekstradimi, është paraqitur brenda afatit ligjor, kërkesë për ekstradim nga prokuroria në Ministrinë e Drejtësisë.

Në përmbledhje, rezulton se gjatë vitit 2010 ka ulje të numrit të arrestimeve apo lokalizimeve për qëllime ekstradimi dhe për pasojë ulje të kërkesave për ekstradim, në krahasim me vitin 2009.

Në lidhje me kërkesat për ekstradim nga autoritetet e huaja për jashtë shtetit, gjatë vitit 2010 rezulton nga të dhënat statistikore se në total janë bërë 43 arrestime me qëllim ekstradimi, dhe më konkretisht 12 kërkesa nga Gjermani, 4 nga Zvicra, 3 nga Italia, 3 nga UNMIKU, 2 nga Sllovenia 2 nga Belgjika si dhe vende të tjera Holanda, Danimarka, Hungaria, Sllovenia, Greqia, Polonia, Maroku etj. Kjo shifër e krahasuar me atë

të vitit 2009 ku ishin realizuar 5 arrestime me qëllim ekstradimi tregon një rritje të dukshme për këtë tregues.

Përsa i takon ekstradimeve nga Shqipëria jashtë, gjatë vitit 2010 janë realizuar 26 ekstradime dhe konkretisht:

4 të ekstraduar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga të cilët 3 shtetas shqiptarë; 9 shtetas të huaj ekstraduar në Gjermani; 3 shtetas të huaj ekstraduar në Zvicër; 2 shtetas të huaj ekstraduar në Slloveni; 2 shtetas të huaj ekstraduar në Itali.

Nga 1 shtetas i huaj ekstraduar respektivisht në Danimarkë, Sllovaki, Mal i Zi, Holandë, Kosovë e Maqedoni.

Kjo shifër e krahasuar me atë të vitit 2009 ku ishin ekstraduar fizikisht 3 persona tregon një rritje të dukshme të këtij treguesi.

Në lidhje me transferimin e personave të dënuar nga gjykatat shqiptare për jashtë shtetit, gjatë vitit 2010 ka patur 3 persona të transferuar, respektivisht në Kosovë, Maqedoni e Greqi.

Gjatë vitit 2010 janë transferuar nga jashtë shtetit në Shqipëri për të vuajtur dënimin në burgjet shqiptare 5 persona të dënuar, respektivisht 4 persona të transferuar nga Italia dhe 1 nga Suedia.

Lidhur me fluksin e letërporosive, kemi patur 1194 letërporosi nga jashtë shtetit dhe për jashtë shtetit.

Në vitin 2009 është kërkuar njohja e vendimeve penale të huaja për 58 shtetas shqiptarë nga të cilët 8 nga autoritetet italiane dhe të shoqëruara me kërkesën për arrestim provizor. Pjesa tjetër e kërkesave për njohje janë përgjithësisht nga vendet fqinje si Kosova dhe Maqedonia dhe kanë të bëjnë kryesisht me dënime me gjoba të ulta për kalim të paligshëm të kufirit.

Vihet re një reduktim i ndjeshëm i kërkesave për njohje të vendimeve penale të huaja sidomos nga autoritetet italiane pas konstatimit të një fenomeni shqetësues lidhur me këto procedura, atë të uljes drastike të masave të dënimit të dhëna nga gjykatat shqiptare të të gjitha niveleve.

Në vitin 2010 kemi patur 51 raste të komisioneve rogatore dhe takimeve info-operative me partnerët ndërkombëtarë. Vlen të përmendim këtu veçanërisht bashkëpunimin me autoritetet italiane, britanike, belge, franceze, holandeze e gjermane. Po kështu shumë rezultate kanë rezultuar edhe takimet info-operative të kërkuara nga autoritetet shqiptare dhe të zhvilluara jashtë Shqipërisë, e shtrirë kryesisht në hetimin e çështjeve që lidhen me trafiqet dhe krimin e organizuar, nga ku do të veçonim operacionet ‘Motorino’ dhe sidomos ‘Kontenieri Latin’ në përfundim të të cilit u bë i mundur konfiskimi i sasisë më të madhe të kokainës të kapur në Shqipëri.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm dhe rezultativ i bashkëpunimit me autoritetet e huaja ka qënë trajtimi i rasteve të trafikimit të makinave të vjedhura, një problem që ka qënë i vazhdueshëm, serioz, me shtrirje të gjerë dhe me efekte në marrëdhëniet me autoritetet e huaja. Falë këtij bashkëpunimi, gjatë vitit 2010 është arritur t’u kthehen pronarëve të ligjshëm në shtetet e huaja 28 automjete. Vlen të përmendim këtu bashkëpunimin me autoritetet italiane, franceze, vendet nordike, gjermane, etj.

Trafiku i mjeteve motorike vazhdon të ngelet problem shqetësues për agjencitë e specializuara të zbatimit të ligjit në Shqipëri dhe autoritetet e huaja, veçanërisht në zbulimin dhe goditjen e autorëve të këtij fenomeni transnacional.

Gjatë vitit 2010, kemi hasur problematika përsa i takon Ligjit të ri për bashkëpunimin ndërkombëtar me autoritetet e huaja, i cili detyron prokurorinë për përkthimin e letërkërkesave. Kjo gjë, nuk është shoqëruar me ndryshime në staf apo në buxhet në mënyrë që të përballohet kjo ngarkesë dhe t'i përgjigjemi këtij detyrimi duke sjellë vështirësi serioze të punës dhe të bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

Në lidhje me njohjet e vendimeve penale të huaja, vihet re një tendencë e gjykatave për të ulur ndjeshëm dënimet e dhëna nga gjykata të huaja; së dyti, kemi raste kur arrestohen personat dhe procesi i njohjes së vendimit penal të huaj deri në marrjen e vendimit formë të prerë zgjat me tepër se 6 muaj. Kjo gjë ka sjellë si pasojë ndryshimin e masës arrest në burg ndaj personit, duke bërë më pas të pamundur ekzekutimin e vendimit kur ky vendim ka marrë formë të prerë pasi personat i janë fshehur drejtësisë; dhe së fundi, kemi raste në rritje kur gjykatat kanë rrëzuar kërkesat e prokurorit për njohje.

Mungesa e marrëveshjeve dypalëshe për lejimin e ekstradimit të shtetasve shqiptar jashtë vendit si dhe pamundësia e përdorimit të instrumentave lehtësues të bashkëpunimit ndërkombëtar si Urdhëri i Arrestit European, ka sjellë vështirësi lidhur me ekzekutimin e urdhërave të arresteve ndërkombëtare të lëshuara nga vende të ndryshme ndaj shtetasve shqiptare. Kjo, sidomos në kushtet kur transferimi i procedimit dhe kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj janë të drejta ekskluzive të vendit që procedon apo që ka dhënë vendimin e formës së prerë.

Nga ana tjetër vështirësi të madhe paraqet hetimi i këtyre personave nga prokuroria shqiptare, kjo pasi ngjarjet, dëshmitë, provat dhe gjithçka lidhet me ngjarjen dhe personat gjenden jashtë territorit të Shqipërisë, shtuar këtu edhe koston e jashtëzakonshme dhe të papërbalueshme që kanë këto lloj hetimesh. Kjo problematikë është veçanërisht shqetësuese me Italinë edhe për shkak të afërsisë gjeografike dhe numrit të konsiderueshëm të komunitetit shqiptar i cili jeton në Itali por që merr një zgjidhje përfundimtare me ratifikimin nga pala italiane e marrëveshjes për ekstradimin, e miratuar dhe ratifikuar prej vitesh nga pala shqiptare.

ANALIZË E GRUP TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË

I. Arritjet në përmbushjen e angazhimeve për prioritetet në luftën kundër kriminalitetit.

Në luftën kundër kriminalitetit, prioritet tona gjatë vitit 2010 kanë qenë: rekomandimet e Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, strategjitë kombëtare të miratuara, progresi i raportit dhe rekomandimet që vijnë nga partnerët e huaj për shkak të angazhimeve të shtetit shqiptar në organizmat ndërkombëtare, si dhe problematikat e punës së organit të prokurorisë dhe tendencat e kriminalitetit të evidentuara gjatë vitit 2009; - korrupsioni; - krimi i organizuar; - terrorizmi; - trafiket e paligjshme; - pastrimit të parave; - veprave penale të vjedhjes së pasurisë; - veprave penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor.

Pas miratimit të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për raportimin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjëndjen e kriminalitetit në vend”, më datë 10.06.2010, rekomandimet e bëra prezent në këtë rezolutë janë konsideruar si prioritet nga organi i akuzës për periudhën në vazhdim.

KRIMI I ORGANIZUAR DHE TRAFIQET E PALIGJSHME

Lufta kundër krimit të organizuar ka qenë dhe mbetet prioritet i punës së organit të akuzës edhe për vitin 2010. Për shkak të parashikimeve ligjore kompetencën në shkallë vendi për të njekur penalisht aktivitetin kriminal në kuadër të krimit të organizuar e ka në mënyrë të posacme Prokuroria për Krimet e Rënda. Në analizë të treguesve të punës së kësaj zyre na rezulton një tablo si më poshtë, në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar.

Gjatë vitit 2010 në Prokurorinë për Krimet e Rënda janë hetuar 2 Organizata Kriminale që kanë kryer aktivitet kriminal si “Rrëmbim personi”, “Vrasje me paramendim” dhe “Vjedhje me dhunë” parashikuar nga nenet 109, 78 dhe 139 të K. Penal. Gjithashtu janë hetuar dhe 17 grupe të strukturuar kriminale që kanë ushtruar aktivitet në fushën e “Trafikimit të narkotikëve”, “Shfrytëzimit dhe trafikimit të femrave për prostitucion”, “Dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, dhe “Vjedhjeve” apo “Vjedhjeve me dhunë”. Për këto procedime penale janë ndjekur penalisht 34 persona, është ngritur akuzë në gjykatë për 15 persona, për të cilët vazhdon gjykimi. Në gjykim janë edhe 3 çështje me 19 persona që akuzohen për vepra penale të kryera në kuadër të organizatave kriminale. Nga analiza e treguesve të kriminalitetit në kuadër të krimit të organizuar rezulton se kryesisht veprimtaria kriminale shfaqet formën e “Grupit të strukturuar kriminal” dhe shumë më pak në formën e “Organizatës kriminale”, që ne e vlerësojmë si një tregues pozitiv që lidhet edhe me efektivitetin e goditjes së krimit të organizuar nga agjensitë e zbatimit të ligjit në vendin tonë.

Nga analiza e treguesve statistikore për trafikimet e paligjshme për vitin 2010 evidentohet tendencë në rritje për këtë grup veprash për çështjet e ndjekura penalisht që na rezultojnë 897 procedime në ndjekje, ndërsa në vitin 2009 kanë qenë 663, ose në rritje 35.29%. Gjithashtu evidentohet tendencë në rritje edhe për numrin e personave ndaj të cilëve është ngritur akuzë. Nga 320 persona në vitin 2010, në 244 për vitin 2009, ose 76 persona të marrë të pandehur më shumë.

Brenda këtij grup veprash penale kemi të njëjtën situatë si vitin e kaluar që shfaqet në “Trafikimin e narkotikëve” ndërkohë, në analizë të treguesve statistikore evidentohet tendencë në rritje e regjistrimit të procedimeve për veprat penale që lidhen me “Trafikimin e femrave për prostitucion” dhe “Trafikimit të të miturve”. Kështu nga 9 procedime të regjistruara në vitin 2009 për këtë grup veprash penale, për vitin 2010 janë regjistruar 36 të tilla, pra 3 herë më shumë. Në analizë të rasteve të hetuara, duhet theksuar se faktet e trafikimit nuk kanë ndodhur kryesisht në vitin 2010, por lidhen edhe me fakte të ndodhura në vitet e kaluara, por që janë evidentuar dhe referuar gjatë vitit 2010. Kjo lidhet edhe me një rritje të ndjeshme të vëmendjes të agjensive të zbatimit të ligjit si dhe organizmave ndërkombëtarë të specializuar ndaj këtij fenomeni.

E njëjta tendencë vihet re edhe në regjistrimin e veprave penale që lidhen me “Trafikimin e armëve” ku nga 4 procedime të regjistruara në vitin 2009, janë regjistruar 17 në vitin 2010. Pavarësisht numrit të rritur të çështjeve të regjistruara për këtë vepër penale, pothuaj në të gjitha rastet kemi të bëjmë më sasi të vogla armësh dhe municionesh objekt trafikimi.

Me qëllim goditjen e krimit të organizuar në të gjitha dimensionet e tij, Prokuroria për Krimet e Rënda ka trajtuar me prioritet të gjitha rastet që lidhen me hetimin pasuror në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, në ndryshim nga vitet e kaluara ku ka patur probleme me zbatimin e ligjit të mëparshëm, këtë vit ka patur një rritje të ndjeshme të numrit të hetimeve pasurore ku janë regjistruar 24 të tilla, ndërkohë që janë paraqitur 11 kërkesa për sekuestrim të cilat janë pranuar nga Gjykata. Në zbatim të

këtij ligji në vitin 2010 janë sekuestruar **2 802 023 €**, **2 930 \$** dhe **38 127 86** lekë. Përveç vlerave monetare janë sekuestruar 12 automjete të markave të ndryshme, **5 765 m²** truall, **13** objekte të ndryshme si Hotele, apartamente etj me një sipërfaqe totale prej **2 290 m²** si dhe aktiviteti i **3** shoqërive anonime me kapital fillestar **50 milion** lekë.

Në drejtim të forcimit të mardhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, nga analiza e të gjithë treguesve na rezulton se këto raporte janë konsoliduar e përmirësuar ndjeshëm. Vlen të përmenden këtu 2 rastet "Dorëzimit të kontrolluar, të sukseshme për trafik lëndësh narkotike, njëra me Hollandën me 3 të pandehur me 8 kg kokainë të sekuestruar dhe tjetra ne bashkepunim me DEA-n dhe Guardia di Finanzia me 1 kg kokainë të sekuestruar me 4 te pandehur.

Gjithashtu mund të cilësohen si të suksesshme edhe 2 hetime paralele të zhvilluara me autoritetet italiane për vepra penale që lidhen me trafikimin e lëndëve narkotike në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, me 18 te pandehur dhe rreth 35 kg lëndë narkotike e sekuestruar.

Trafikimi i mjeteve motorike për vitin 2010 rezulton me tendencë në rritje. Janë regjistruar 343 procedime penale, ose me rritje 27,98 % krahasuar me vitin 2009. Analiza e fakteve për procedimet e regjistruara tregon se shifra e tendecës në rritje, përfshin edhe rastet e trafikimit të mjeteve motorike të ndodhura në vitet e mëparshme por që janë evidentuar dhe referuar gjatë vitit 2010. Kjo është e lidhur me përmirësimin e funksionimit dhe rakordimit ndërmjet strukturave të zbatimit të ligjit që menaxhojnë regjistrimin dhe qarkullimin e automjeteve në territorin e Republikës.

Risjellim në vëmendjen Tuaj nevojën për miratimin e propozimit për ndryshimin e nenit 75/a të Kodit Procedurës Penale, për ndryshimin e kompetencës lëndore për kalimin e kësaj vepre penale në kompetencë të Gjykatës për Krimet e Rënda me qëllim rritjen e efikasitetit për luftën ndaj këtij lloj kriminaliteti i cili për nga vetë mënyra se si ajo kryhet, ka të gjitha tiparet e krimit të organizuar.

KORRUPSIONI DHE KRIMI EKONOMIK E FINANCIAR

Lufta kundër korrupsionit dhe veprave penale të lidhura me të ka qenë dhe mbetet prioritet i prokurorisë edhe për vitin 2010. Puna e organit të akuzes është përqëndruar në rritjen dhe përmirësimin e treguesve sasiorë dhe cilësorë të ndjekjes penale të veprave penale të korrupsionit, në forcimin dhe konsolidimin e strukturave të specializuara për të hetuar këto raste (Njesitë e Përbashkëta Hetimore), rritja e kapaciteteve dhe e aftësive profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për të ndjekur penalisht këto vepra penale.

Nga analiza e treguesve statistikorë rezulton se në vitin 2010 kanë qenë në ndjekje penale 169 procedime, me 167 të pandehur prej të cilëve për 120 të pandehur është ngritur akuzë në gjykatë. Ka përfunduar gjykimi për 50 persona prej të cilëve 49 janë deklaruar fajtorë dhe 1 i pafajshëm. Në terma krahasues me vitin 2009, evidentohet tendencë si: rritje 30,23 % (për qind) të procedimeve të regjistruara; rritje 116 % (për qind) të procedimeve të dërguara për gjykim ; rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar 129,54 % (për qind); rritje të numrit të të pandehurve dërguar gjyqit 126,41 % (për qind) dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata 36,11 % (për qind) si dhe evidentohet ulje e rasteve të pafajësise, 3 herë në krahasim me vitin 2009.

Brenda grup-veprave penale të korrupsionit vihet re në mënyrë të vecantë një tendencë në rritje për veprat penale:

- “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar në nenin 259 të Kodit Penal. Në vitin 2010 janë ndjekur 114 procedime penale me 97 persona të pandehur. Kemi rritje 25% (për qind) të procedimeve penale dhe rritje 76% (për qind) të personave të marrë si të pandehur.
- “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar në Nenin 245/1 të Kodit Penal. Ne vitin 2010 janë ndjekur 21 procedime penale me 29 të pandehur. Kemi rritje prej 2 herë të procedimeve në ndjekje penale dhe ka rritje prej 2.2 herë të të pandehurve në ndjekje penale.
- Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, parashikuar nga neni 319/a i Kodit Penal. Në vitin 2010 janë ndjekur penalisht 6 procedime penale me tre të pandehur. Kemi rritje 2 herë të procedimeve në ndjekje penale.

Vlen të evidentohet tendenca në rritje e procedimeve penale në fushën e krimit ekonomiko-financiar vecanerisht evazion fiskal dhe kontrabandës. Gjatë vitit 2010 rezulton se janë regjistruar 121 procedime penale në fushën e tatimeve kundrejt 97 gjatë vitit 2009. Me rritje rezulton gjithashtu dhe numri i personave të marrë të pandehur, nga 30 persona në vitin 2009 në 68 gjatë vitit 2010, si dhe janë dërguar në Gjykatë për tu gjykuar rreth 2 herë më tepër të pandehur se në vitin 2009 (64/39).

Gjatë vitit 2010 rezulton se janë regjistruar 398 procedime penale në fushën e doganave kundrejt 237 gjatë vitit 2009. Me rritje rezulton gjithashtu dhe numri i personave të marrë të pandehur, nga 149 persona në vitin 2009 në 230 gjatë vitit 2010, si dhe janë dërguar në Gjykatë për tu gjykuar 126 të pandehur nga 105 në vitin 2009.

Vlerësojmë se rritja e numrit të çështjeve të regjistruara në këtë fushë është rezultat i forcimit të bashkëpunimit me strukturat e organeve tatimore e doganore përsa i përket referimit të çështjeve, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër evazionit fiskal dhe kontrabandës.

Në lidhje me veprat penale për pastrimin e produkteve të veprës penale, vihet re tendenca në rritje e numrit të çështjeve të regjistruara dhe atyre në ndjekje gjatë vitit 2010. Nga të dhënat rezulton se në vitin 2010 janë regjistruar 59 procedime me 23 persona kundrejt 41 procedime me 5 persona në vitin 2009. Rritje të ndjeshme kanë edhe procedimet në ndjekje, nga 54 në vitin 2009 në 97 gjatë vitit 2010. Janë dërguar 3 të pandehur në gjyq, nga të cilët një i pandehur është deklaruar fajtor dhe dënuar nga gjykata.

VJEDHJET

Për shkak të tendencës së theksuar që vazhdon të jetë në rritje të kësaj kategorie veprash penale dhe të konsiderimit të luftës kundër kësaj kategorie si prioritet të punës tonë, vlerësojmë të evidentojmë disa nga treguesit e punës tonë dhe problematikat që janë shfaqur.

Nga analiza e të dhënave statistikore është rritur numri i procedimeve të dërguar për gjykim nga 1225 në vitin 2009 në 1869 në vitin 2010, si dhe është rritur numri i të pandehurve të dërguar gjyqit nga 1700 në vitin 2009 në 2465 në vitin 2010. Kjo tendencë në rritje evidentohet edhe për personat e deklaruar fajtor dhe dënuar nga Gjykata, konkretisht: nga 1419 të dënuar në vitin 2009, në 2003 persona të dënuar gjatë vitit

2010. Organi i Prokurorisë ka bërë kujdes në ashpërsimin e politikës së dënimit ndaj autorëve të këtyre veprave penale. Ky qëndrim evidentohet në analizën e treguesve statistikorë të kërkesave të prokurorëve për llojet dhe masat e dënimit. Kësaj politike dënimi, vlerësojmë se nuk i është përgjigjur me ashpërsinë e duhur Gjykata, e cila ka dhënë lloje dhe masa dënimi më të zbutura.

Me shqetësim evidentohet treguesi me tendencë në rritje i numrit të procedimeve të pezulluara për moszbulim të autorëve të krimit për këtë kategori grup-veprash nga 4071 në vitin 2009, në 4992 gjatë vitit 2010. Pësha specifike e procedimeve të pezulluara për grup-veprat penale të vjedhjes, përfaqson 73.25% të të gjitha procedimeve të pezulluara gjatë vitit 2010, për të gjitha veprat penale që parashikon Kodi Penal.

SHKELJET E RREGULLAVE TË QARKULLIMIT RRUGOR

Për shkak të peshës specifike dhe natyrës sensitive të pasojave që shkaktohen, vepra penale e "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor ka qenë gjatë vitit 2010 si prioritet të punës tonë. Nga analiza e të dhënave statistikore konstatohet një tendencë në ulje të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër penale gjatë vitit 2010. Kështu, rezulton se janë regjistruar 773 procedime me 579 të pandehur për vitin 2010, kundrejt 851 procedimeve me 546 të pandehur të evidentuar në vitin 2009. Nga krahasimi i shifrave rezulton me ulje 10% të numrit të procedimeve dhe rritje 6 % të numrit të personave të akuzuar për këtë vepër. Janë dërguar në gjyq 390 procedime me 399 të pandehur në vitin 2009, kundrejt 396 procedimeve me 406 të pandehur gjatë vitit 2010. Këto tregues evidentojnë rritjen e cilësisë dhe të efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale për këtë vepër penale, në përmbushje të angazhimit tonë të shpallur si prioritet për vitin 2010.

TENDENCAT

Problematika që evidentohet nga analiza e treguesve të tendencave të kriminalitetit për disa grup veprash penale dhe/ose vepra të vecanta për vitin 2010, të pasqyruara hollësisht në këtë raport, rezulton si më poshtë:

I. Tendencat në rritje

a. Korrupsioni dhe veprat penale të lidhura me të

Nga analiza e treguesve statistikorë, për vitin 2010, pasqyruara më sipër në raport, evidentohet një tendencë në rritje e kriminalitetit të këtyre grupveprash penale. Për këtë grupveprash penale vihet re tendencë në rritje e procedimeve penale të rregjistruara prej 30,23% (për qind). Në mënyrë të vecantë vihet re një tendencë në rritje e veprave penale të:

- "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 259 i K.Penal;
- "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.
- "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë", parashikuar nga neni 319/a i Kodit Penal.
- "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë" parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

Vlerësojmë se kjo tendencë rritje i këtyre grup-veprave duhet lexuar si një arritje pozitive e punës së njërive të përbashkëta hetimore të cilët kanë funksionuar për herë të parë gjatë vitit 2010.

b. Trafikët e paligjshme

Nga analiza e treguesve statistikorë, për vitin 2010, pasqyruara më sipër në raport, vihet re tendenca në rritje e procedimeve penale të regjistruara për këtë grup veprash penale prej 29,8% (për qind)

Në këtë grup veprash penale spikasin tendencat më në rritje të veprave penale:

- “Trafikimi i femrave”, parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal “
- “Trafikimi i të miturve” parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal
- “Trafikimi i armëve dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal
- “Trafikimi i mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal

Në analizë të të dhënave, sic trajtuam dhe më lart rastet e trafikut të personave dhe mjeteve motorike lidhen kryesisht me aktivitet kriminal të ndodhur para vitit 2010, por të evidentuar gjatë këtij viti, ndërsa trafiku i armëve dhe municionit lidhet kryesisht me trafikimin e sasirave të vogla.

c. Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike,

Nga analiza e treguesve statistikorë, për vitin 2010, të pasqyruara më sipër në raport, vihet re tendenca qartazi në rritje vit pas viti e veprave penale të regjistruara për këtë grup veprash penale. Peshën specifike më të madhe të tendencës në rritje në këtë grup-veprash e zënë:

- Vjedhja, neni 134 i Kodit Penal
- Vjedhja duke shpërdoruar detyrën, neni 135 i Kodit Penal.
- Vjedhja e energjisë elektrike..., neni 137 i Kodit Penal.
- Vjedhja me armë, neni 140 i Kodit Penal.
- Vjedhja me dhunë, neni 139 i kodit penal
- Vjedhja e bankave, neni 136 i Kodit Penal.
-

Në tendencën në rritje të këtij grup-veprash penale çmojmë se kanë ndikuar faktorët socialo-ekonomikë dhe ulja e zbulueshmërisë së autorëve të tyre.

d. Veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit

Nga analiza e treguesve statistikorë, për vitin 2010, pasqyruara më sipër në raport, vihet re tendenca në rritje e veprave penale të regjistruara për këtë grup veprash penale. Peshën specifike më të madhe të tendencës në rritje në këtë grup-veprash e zënë:

- Plagosja e rëndë më dashje, neni 88 i Kodit Penal
- Plagosja e lehtë më dashje, neni 89 i Kodit Penal

e. Veprat Penale të kryera kundër autoritetit të shtetit

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, për veprat penale të:

- "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", neni 278 i Kodit Penal.
- "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve te ftohta", neni 279 i Kodit Penal.
- "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", neni 280 i Kodit Penal.

f. Vepra penale e Organizimit të llotarive të palejuara

Nga analiza e treguesve statistikorë, për vitin 2010, pasqyruar më sipër në raport, vihet re tendenca në rritje vit pas viti të veprës penale "Organizimi i llotarive të palejuara", neni 197 i Kodit Penal. Kjo veprë, ndonëse nuk zë ndonjë peshë të madhe specifike, për shkak të pasojave ekonomike që i sjell shtetit nga evazioni fiskal që krijohet, tërheq vëmendjen për shtrirjen e saj pothuaj të njëtrajtshme në të gjithë teritorin e Republikës, me përjashtim të Tiranës. Sipas të dhënave rezultojnë se pesha specifike e kësaj vepre penale për Tiranën është vetëm 1 % në raport me totalin e procedimeve. Vlerësojmë se kjo përqindje për qytetin e Tiranës nuk përfaqëson realitetin e përhapjes së kësaj vepre penale dhe për këtë shkak puna jonë në të ardhmen do të orientohet në drejtim të evidentimit të aktivitetit kriminal që kryhet në këtë fushë duke forcuar bashkëpunimin me strukturat e tjera kompetente në këtë fushë.

II. Tendencat në ulje

- a- Për grup-veprat penale të falsifikimit të dokumenteve vit pas viti evidentohet tendenca në ulje vecanërisht kjo tendencë evidentohet për veprat penale të "Falsifikimit të akteve të gjendjes civile" neni 191 i Kodit Penal dhe të "Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave". Vlerësojmë se shkak për këtë tendencë për shkak të rritjes së sigurisë të dokumenteve zyrtare dhe futja në qarkullim i kartave të identitetit dhe i pasaportave biometrike, shkaqe të cilat janë evidentuar edhe në vitet e kaluara.
- b- Për veprën penale të "Kultivimit të bimëve narkotike", neni 284 i Kodit Penal, evidentohet në tendencë në ulje në vazhdimësi në nivel kombëtar si rrjedhojë e punës së agjencive të zbatimit të ligjit në goditjen e këtij fenomeni.
- c- Për veprën penale të "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande pulbrike" neni 258 i Kodit Penal. Është një tendencë në ulje në vazhdimësi rrjedhojë edhe e përmirësimit të procedurave të aplikimit elektronik.
- d- Një tendencë të lehtë në ulje ka edhe vepra penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", neni 290 i Kodit Penal. Kjo tendencë ka ardhur si rezultat i rritjes së efektivitetit të punës së organit të prokurorisë, strukturave të specializuara të policisë si dhe përmirësimi i infrastrukturës të qarkullimit rrugor.


III. Analizë e disa treguesve në rritje të ndjekjes penale në hetimet paraprake dhe në gjykim.

1. Të dhënat statistikore evidentojnë rritje të treguesve cilësorë të hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale në drejtim të forcimit të ligjshmërisë dhe efektivitetit në punën e prokurorëve. Këto tregues konsistojnë në marrjen e personave në cilësinë e të pandehurit, ngritjen e akuzës dhe përfaqësimin e saj në gjykim në emër të shtetit. Në vitin 2007 rreth 69% e personave të pandehur në ndjekje penale


në hetimet paraprake janë dërguar për gjykim, kjo shifër për vitet 2008, 2009 është rritur në 74%. Në vitin 2010 kjo shifër është 92,38 % (për qind).

2. Gjithashtu evidentohet rritje e numrit të personave ndaj të cilëve është ngritur akuzë në gjykatë dhe që janë deklaruar fajtorë e dënuar nga gjykata nga rreth 86% në vitin 2007 në rreth 96% në vitet 2008, 2009 dhe në vitin 2010.
3. Nga analiza e treguesve statistikorë evidentohet se organi i Prokurorisë ka qënë i orientuar drejt një politike të ashpër dënimi në kërkesat që janë paraqitur në gjykatë për dënimin e autorëve të veprave penale. Kjo politikë e ashpër dënimi spikat veçanarisht ndaj autorëve të veprave penale që rezultojnë me tendencë në rritje, si dhe ndaj autorëve të veprave penale që janë konsideruar prioritet i punës së organit të akuzës. Në ndryshim nga qëndrimi i organit të akuzës në drejtim të politikës së dënimit, nga krahasimi i të dhënave statistikore evidentohet se përgjithësisht gjykatat e të gjitha niveleve kanë aplikuar lloje dhe masa më të buta dënimi se ato të kërkuara nga prokurorët.


KËRKESA E PROKURORIT PËR DËNIME ME BURGIM NË MINIMUM




KËRKESA E PROKURORIT PËR DËNIME ME BURGIMMESATAR



KËRKESA E PROKURORIT PËR DËNIME NË MAKSIMUM



KËRKESA E PROKURORIT PËR DËNIME ME BURGIM



4. Analiza e treguesve të ndjekjes penale në hetimet paraprake dhe të procedimeve penale të përfunduara për vitin 2010, evidenton 6823 procedime të pezulluara për moszbulim të autorit, me tendencë në rritje 15 % të krahasuar me vitin 2009. Kjo tendencë rritje evidentohet vit pas viti. Në analizë të treguesve statistikore rezulton se 67,94 % e procedimeve penale të pezulluara i përkasin veprës penale të vjedhjes së pasurisë parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal “Vjedhja”, ndërsa 2,87% e procedimeve penale të pezulluara i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 141/a “Trafikimi i mjeteve motorike”. 2,33% (për qind) e procedimeve të pezulluara i përkasin përkatësisht veprave penale të parashikuara nga neni 137 “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” dhe neni 151 “Shkatërrimi i pronës me zjarr”; 2,15% (për qind) e procedimeve të pezulluara i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 284 “Kultivimi i bimëve narkotike”.

Kjo gjendje evidenton mangësi në zbulimin e autorëve nga strukturat përkatëse të shërbimeve të policisë së shtetit, si dhe nevojën për përmirësimin rrënjësor të punës nëpërmjet hartimit të një strategjie për të luftuar këtë fenomen në të gjithë dimensionet e tij. Gjithashtu çmojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të organizojë kontrole dhe analiza në të gjitha strukturat e shërbimeve të policisë gjyqësore në policinë e shtetit, me qëllim për të analizuar gjëndjen e veprave penale të pazbuluara si dhe për të rritur angazhimin dhe përgjegjshmërinë e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore në të gjithë nivelet në ushtrimin e funksioneve të tyre, për kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave, njoftimeve dhe provave, për gjurmimin dhe zbulimin e autorëve të mundshëm të veprave penale të pezulluara/pazbuluara.

IV. REFORMIMI I PROKURORISË, RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE ME MISIONET NDËRKOMBËTARE

I. Reformimi i Prokurorisë

Prokuroria shqiptare krahas punës së saj të përditshme në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shteti, është angazhuar seriozisht dhe në pëmirësimin e treguesve të tjerë të punës, të cilët në mënyrë integrale janë pjesë e funksioneve të saj kushtetuese. Në këtë kontekst është konsideruar në mënyrë të vazhdueshme, reformim i brendshëm, si një element vital për mirëfunksionimin e institucionit. Në këtë drejtim, duke shfrytëzuar asistencën e partnerëve ndërkombëtarë edhe të misioneve të huaja që asistojnë e mbështesin punën e prokurorisë, janë miratuar një sërë aktesh normative të cilat janë të drejtuara drejt vendosjes së rregullave për funksionimin e brendshëm të institucionit dhe rritjes së transparencës në aktivitetin e tij. Miratimi i këtyre akteve është bërë duke u mbështetur në ligjin organik të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë dhe në rekomandimin nr. 19/2000 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, rekomandimet e Raport-progresit të Komisionit Europian, rezolutën e datës 10.06.2010 të Kuvendit të Shqipërisë.

1. Gjatë vitit 2010 janë miratuar akte normative të Prokurorit të Përgjithshëm si:

- Rregullorja e funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila synon të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e secilës hallkë të institucionit, të formalizojë marrëdhëniet dhe mënyrat e komunikimit të këtyre hallkave me qëllim individualizimin e funksioneve dhe përgjegjësi
- Rregullorja e inspektimit dhe e procedimit disiplinor të prokurorëve, e cila synon të rrisë transparencën dhe të garantojë të drejtat e prokurorëve që do të inspektohen dhe do të procedohen disiplinarisht.
- Rregullorja e Këshillit të Prokurorisë, e cila do të përmirësojë në të ardhmen punën e këtij organi të rëndësishëm këshillimor pranë Prokurorit të Përgjithshëm
- Urdhëri për “Trajnimin e prokurorëve” i cili synon trajnimin dhe specializimin e tyre, në drejtime të caktuara, në përputhje me nevojat e hetimeve, si dhe në reflektim të rekomandimeve të partnerëve të huaj që na asistojnë në punën tonë;
- Urdhëri për “Rregullimin e raporteve mes prokurorive të rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë Për Krimet e Rënda në zbatim të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese të pasurisë”, me synim koordinimin e veprimtarisë ndërmjet prokurorive të rretheve gjyqësore dhe asaj për Krimet e Rënda në drejtim të rritjes së efektivitetit të hetimit pasuror për evidentimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që rrjedhin nga krimi i organizuar dhe trafiket e paligjshme.
- Nëpërmjet akteve të posaçme janë krijuar pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë seksioni i hetimit pasuror në përbërje të të cilit janë 3 prokurorë e 3 oficerë, si dhe seksioni i hetimit të trafikut të femrave për prostitucion i përbërë nga 2 prokurorë dhe një koordinator.

2. Akte normative të përbashkëta të Prokurorit të Përgjithshëm me institucione të tjera

- Udhëzim i përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm me synim planifikimin, bashkërendimin, organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të policisë së shtetit.

- Urdhër i përbashkët me Ministrinë e Brëndshme për kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për vitin 2010, në drejtimet: hetimi i aseteve kriminale; hetimi proaktiv i trafikimit të qënieve njerëzore.
- Përgatitur dhe është në prag të nënshkrimit Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim realizimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet strukturave inspektuese të këtyre dy institucioneve për kontrollin në mënyrë të planifikuar të veprimtarisë së prokurorisë në zbatim të kompetencave ligjore përkatëse.

3. Forcimi i kontrollit të brendshëm.

Prokuroria e Përgjithshme një ndër funksionet e rëndësishëm të punës së saj ka kontrollin e brendshëm të prokurorive të shkallës së parë dhe atyre të apeleve me synim mbikqyrjen e ushtrimit të funksioneve të tyre në zbatim të kushtetutës, ligjit dhe akteve normativë të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në përmbushje të këtij funksioni, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vitit 2010 kanë ushtruar kontrole të përgjithshme, të pjesshme, për grup çështjesh dhe për çështje të veçanta.

Kështu, janë ushtruar kontrole në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Elbasan, Burrel, Tropojë, Lezhë për periudhën kohore 2008-2010.

Gjithashtu janë kryer kontrole për prokuror të vecantë në Prokurorinë e Apelit Tiranë, Prokurorinë e Rretheve Gjyqësore Kukës, Lushnje, Mat dhe Prokurorinë Për Krime të Rënda Tiranë.

Në total janë kontrolluar 2636 procedime penale dhe vendime mosfillimi.

Në përfundim të kontrolleve të kryera është filluar procedimi disiplinor për 10 prokurorë të shkallës së parë dhe të apelit. Në përfundim të procesit disiplinor nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm janë dhënë masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim për shkarkim” për katër prokurorë dhe masa disiplinore “vërejtje” për dy prokurorë.

II. Forcimi i kapaciteteve në organin e prokurorisë.

Forcimi i kapaciteteve në prokurori si prioritet i punës sonë, është realizuar nëpërmjet përmirësimeve strukturore dhe rritjes profesionalizmit dhe profilizimit të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës për të rritur efektivitetin në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore.

1. Gjatë vitit 2010 kanë funksionuar me kapacitet të plotë 7 Njësitë e Përbashkëta Hetimore pranë prokurorive më të mëdha në vend, duke u përzgjedhur dhe plotësuar organika me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore. Njësitë e Përbashkëta Hetimore nuk kanë buxhet të pavarur por janë mbështetur financiarisht nga fondet e buxhetit të Prokurorisë së Përgjithshëm. Në vijim, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm ju është dhënë dhe shtesa e pagës prej 20% për efekt të vështirësisë në punë si dhe janë mbështetur me përparësi të gjitha kërkesat e tyre. Si rezultat i gjithë kësaj politike mbështetëse dhe motivimit e përkushtimit në punë të tyre, treguesit e punës së tyre janë përmirësuar ndjeshëm. Ng analiza e të dhënave statistikore rezulton rritje e ndjeshme e volumit të punës, efektivitetit dhe ligjshmërisë në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqsimin e akuzës në gjyq për veprat penale të korrupsionit dhe krimit ekonomiko-financiar.

2. Gjatë vitit 2010 është ngritur Seksioni i Hetimit Pasuror pranë Prokurorisë për Krime të Rënda në përbërje të të cilit janë tre prokurorë dhe tre oficerë të policisë gjyqësore. Objekti i punës i këtij seksioni është kryerja e hetimit pasuror për të gjitha rastet e referuara nga policia gjyqësore, nga prokuroritë e tjera dhe nga vetë prokurorët e Prokurorisë për Krimet e Rënda. Megjithë kohën e shkurtër të funksionimit të këtij seksioni treguesit e punës së tij janë dukshëm në rritje. Për një periudhë 10 mujore ky seksion ka regjistruar 35 procedime, ka kërkuar dhe është vendosur nga gjykata në 11 raste sekuestrimi i pasurisë. Nga këto, 5 raste janë në procedura konfiskimi nga gjykata. Pasuritë e sekuestruara nga ky seksion përfaqësojnë vlera të konsiderueshme monetare në valutë dhe në lekë si dhe asete të paluajtshme në sipërfaqe dhe vlerë të konsiderueshme sikurse janë trajtuar në mënyrë të detajuar më sipër në këtë raport.
3. Në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, gjithashtu në muajin mars është krijuar Seksioni i Hetimit të Trafikut të Femrave. Në përbërje të këtij seksioni janë caktuar dy prokurorë dhe një oficer e policisë gjyqësore që kryen edhe funksionet e koordinatores mes zyrës së prokurorisë dhe viktimave të trafikut. Ngritja e këtij seksioni është bërë në mbështetje të rekomnadmive të dhëna nga partnerët ndërkombëtarë. Ngritja e këtij seksioni ka ndikuar në rritjen e rasteve të referimit të trafikimit të femrave për shkak edhe të rritjes së raportit të besimit mes viktimave të trafikut dhe organeve të zbatimit të ligjit.
4. Në Sektorin e Përgjimeve që funksionon në Prokurorinë e Përgjithshme është bërë riorganizimi i tij me qëllim rritjen e efektivitet në ndjekjen e proceseve hetimore në dinamikë dhe në konkludimin me sukses të hetimeve proaktive.

Në mënyrë të veçantë procesi i rritjes së kapaciteteve është fokusuar në trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore janë realizuar me mbështetjen dhe kujdesin e Shkollës së Magjistraturës, Akademisë së Policisë, Misioneve ndërkombëtare OPDAT, EURALIUS, Projekti PACA etj.

Në kuadër të trajnimeve të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë janë organizuar trajnime edhe jashtë vendit në shtete të ndryshme me tematika të ndryshme të konsideruara me interes për rritjen e aftësive profesionale të prokurorëve. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë 58 prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe punonjës të administratës së prokurorisë.

Në kuadër të Njësive të Përbashkëta Hetimore, me mbështetjen e zyrës OPDAT, janë organizuar tetë sesione trajnimi brenda vendit me objekt rritjen e njohurive dhe të aftësive profesionale në drejtim të hetimit të krimit ekonomiko-financiar, korrupsionit, krimit kompjuterik dhe të pastrimit të parave. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 220 prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore. Në mënyrë më të detajuar janë si më poshtë:

- Nga 22 deri 26 Shkurt 2010 është organizuar trajnimi me objekt “Aftësitë e prezantimit të çështjeve në gjykatë”. Kanë marrë pjesë 25 prokurorë nga Njësitet e Përbashkëta dhe Prokuroria e Tiranës.
- Nga 6 deri 9 Prill 2010 është organizuar trajnimi me objekt “Teknikat e Hetimit Financiar”. Kanë marrë pjesë 34 persona, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore të Njësive të Përbashkëta.
- Nga data 12 deri 16 Prill 2010 është organizuar trajnimi me objekt “Teknikat e Hetimit Financiar”. Kanë marrë pjesë tre prokurorë nga Njësitet e Përbashkëta dhe oficerë të policisë gjyqësore nga tatimet.
- Nga data 11 deri 13 Maj 2010 është organizuar trajnimi me objekt “Hetimi i krimit kompjuterik”. Kanë marrë pjesë 47 persona, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore nga të gjitha Njësitet e Përbashkëta Hetimore.

- Në datat 28-29 Tetor (Tiranë), 4-5 Nëntor (Pogradec) dhe 2-3 Dhjetor 2010 (Vlorë) janë zhvilluar tre trajnime rajonale me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, pjestarë të Njësive të Përbashkëta Hetimore, me temë “Prezantimi i Manualit të Hetimit të Krimit Financiar dhe Korrupsionit”. Manuali është përgatitur nga ekspertë të OPDAT dhe Projektit PACA (Këshilli Europës) në bashkëpunim me prokurorë shqiptarë.
- Në datën 31 Mars 2010 është zhvilluar një trajnim me temë “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive kriminale dhe legjislacioni shqiptar në fuqi”. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 20 persona, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, përfaqësues nga FIU dhe Agjencia për Administrimin e Aseteve të Konfiskuara.

Në proces trajnimi kanë qenë edhe punonjësit e administratës së sistemit të prokurorisë, fokusuar në menaxhimin e fondeve buxhetore i mbështetur nga misioni EURALIUS.

Nisur nga rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë, jemi orientuar dhe janë zhvilluar trajnime të përbashkëta me prokurorët dhe shërbimet e policisë gjyqësore të policisë së shtetit. Me qëllim përmirësimit dhe shpalosjen e politikave të përbashkëta gjatë zhvillimit të këtyre trajnimeve, është finalizuar së fundmi një udhëzim i përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrin e Brendshëm.

III. Marrëdhëniet e prokurorisë me institucionet e tjera

Në zbatim të kushtetutës dhe ligjit, për përmbushjen e misionit të saj, Prokuroria ka ndërtuar marrëdhënie me të gjitha institucionet dhe hallkat e pushteteve.

1. Marrëdhëniet me institucionin e Presidentit të Republikës, kanë qenë dhe janë institucionale, në mbështetje të reformës në organin e prokurorisë dhe të veprimtarisë së saj. Në vitin 2010, Presidenti i Republikës ka dekretuar emërimet në detyrë të prokurorëve të rinj, transferimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve, në përgjigje të propozimeve të dërguara nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjithashtu, institucioni i Presidentit të Republikës është informuar në vazhdimësi për konkluzionet e kontrolleve të ushtruara në organin e prokurorisë dhe problematikat e konstatuara në funksionimin e sistemit të drejtësisë.
2. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë janë të ndërtuara në linja institucionale dhe korrekte. Prokuroria është thirrur dhe ka shfaqur mendimin e saj në Komisionet respektive kur janë diskutuar amendime të ligjeve të cilët janë pjesë e punës së prokurorisë. Në këtë kuadër, Kuvendi ka miratuar pjesërisht kërkesat tona për shtimin e organikës. Sjellim në vëmendje tuaj dhe kërkojmë mbështetjen e Kuvendit në drejtim të:
 - Rritjes së fondeve buxhetore dhe plotësimin e numrit të kërkuar të punonjësve si nevojë e domosdoshme e institucionit për ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe për implementimin e ndryshimeve që pësoi ligji organik i prokurorisë.
 - Amendimeve të nevojshme ligjore me qëllim kufizimin e imuniteteve për t'i hapur rrugë organit të akuzës që të ushtrojë më me efektivitet ndjekjen penale edhe për këtë kategori personash, veçanërisht në drejtim të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve në detyrë.
 - Amendimeve të nevojshme ligjore me qëllim dhënien e së drejtës Prokurorit të Përgjithshëm për të vënë në lëvizje kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë me synim unifikimin e praktikave

gjyqësore, si dhe të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që janë në juridiksionin e kësaj Gjykate.

- Ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme ligjore në Kodin Penal për të qartësuar dhe plotësuar formulimet e dispozitave për parashkrimin e ndjekjes penale dhe për parashkrimin e ekzekutimit të vendimeve, nenet 66 dhe 68 të Kodit Penal.
 - Ndërhyrje në Kodin e Procedurës Penale me qëllim pezullimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale për personat me imunitet, përsa kohë e gëzojnë këtë status.
 - Amendimet e nevojshme në Kodin Penal për dispozitat penale në ligje të vecanta që kohët e fundit janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (neni 90 i Ligjit për Bankat).
3. Në marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave, Prokuroria ka orientuar punën e saj duke ndjekur në dinamikë, prioritetet e qeverisë për luftën ndaj kriminalitetit. Aspekte të tjera të marrëdhënieve me Këshillin e Ministrave janë:
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të prokurorisë në Komitetet Ndër-institucionale të ngritura nga qeveria.
 - Angazhimi i përfaqësuesve të prokurorisë në kuadrin e proceseve integruese të Shqipërisë në BE, nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të KE-së dhe procesin e liberalizimit të vizave në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Integritit, Ministrinë e Brendshme, etj.
4. Marrëdhëniet me Ministrinë e Brendshme janë karakterizuar nga fryma e bashkëpunimit të ndërsjellë për zbatimin e ligjit dhe akteve normative të përbashkëta. Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe shërbimet e policisë gjyqësore në varësi të saj, vlerësohet si shumë i rëndësishëm në efektivitetin e punës së organit të prokurorisë dhe në mënyrë të veçantë në cilësinë e hetimit.

Vlen të përmenden si një eksperiencë pozitive për vitin që kaloi bërja e analizave të përbashkëta të cilat kanë shoqëruar hetimet paraprake. Këto analiza janë bërë si në nivelin e bazës ashtu edhe në nivel qëndror në raste të veçanta apo për vepra penale të konsideruara prioritet. Në mënyrë të veçantë ky bashkëpunim është shfaqur në funksionimin e Njësisë të Përbashkëta Hetimore.

Krahas arritjeve, në marrëdhëniet me shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit, vazhdon të evidentohet shqetësimi lidhur me nivelin profesional dhe paqëndrueshmërinë në detyrë të oficerëve të shërbimeve të policisë, faktorë të cilët kanë ndikuar qoftë në cilësinë ashtu dhe në mbarëvajtjen e hetimeve.

Gjithashtu, vihet re tendencë në ulje e referimeve të ardhura në prokurori nga Policia e Shtetit për vitin 2010 tek e cila do të veconim tendencën në ulje të referimeve për veprat penale në lidhje me korrupsionit dhe trafikut të narkotikëve.

Bashkëpunim i frutshëm me Policinë e Shtetit evidentohet në grupet e përbashkëta të punës amendimet deri në miratimin e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", si dhe në implementimin e tij nëpërmjet përgatitjes së akteve nënligjore të përbashkëta që duhet të miratohen në zbatim të këtij ligji.

Konstatohet se po ndërtohet një eksperiencë pozitive në lidhje me trajnimet e përbashkëta të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore me qëllim jo vetëm rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre, por edhe përfundimin e qëndrimeve të unifikuara përsa i përket problematikave të caktuara ligjore apo tipologjive të ndryshme të aktiviteteve kriminale.

Konkretisht për vitin 2010 ka qënë kryerja e trajnimeve të përbashkëta të prokurorëve me shërbimet e policisë së shtetit. Kështu janë kryer 8 sesione trajnuese në disa Drejtori të Policisë, ku kanë marrë pjesë 12 prokurorë, 18 oficerë të policisë gjyqësore dhe 135 punonjës të shërbimeve të policisë së shtetit.

5. Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë për shkak të parashikimeve ligjore janë të orientuara në disa drejtime, të cilat ndërtohen kryesisht në rekomandimet për prioritet e luftës kundër kriminalitetit, që Ministria i paraqet në prokurori në emër të Këshillit të Ministrave.

Ministria e Drejtësisë, nga inpektimet që ka kryer në institucionin e prokurorisë, në vitin 2010, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme raportin e kontrollit të bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nga raporti i paraqitur rezulton se inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë kanë kontrolluar në këtë prokurori 556 vendime mosfillime dhe 800 procedime penale të pushuara, në total 1356 fashikuj. Nga ky volum, janë kontestuar 44 vendime mosfillimi dhe 146 vendime pushimi. Nga prokurorët e Drejtorisë së Inspektimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme janë shqyrtuar konkluzionet e Ministrisë së Drejtësisë duke ushtruar kontroll të drejtpërdrejtë për të gjitha dosjet e kontestuara. Në përfundim të këtij kontrolli është vendosur shfuqizimi i vendimit të pushimit për 8 procedime penale.

Gjithashtu, gjatë vitit 2010 Ministria e Drejtësisë ka ushtruar kontroll tematik për çështje të veçanta në 25 prokurori të rretheve gjyqësore për një total prej 59 procedime penale. Në përfundim të këtyre kontrolleve, Ministria e Drejtësisë ka kontestuar zgjidhjet e çështjeve nga prokurorët vetëm në 3 procedime penale ose rreth 5 % të tyre. Nga prokurorët e Drejtorisë së Inspektimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme janë shqyrtuar konkluzionet e Ministrisë së Drejtësisë duke ushtruar kontroll të drejtpërdrejtë për procedime penale të kontestuara. Në përfundim të këtij kontrolli është vendosur fillimi i procedimit disiplinor për një prokuror.

Në kuadrin e përmirësimit të legjisllacionit dhe për përditësimin e strategjisë ndërsektoriale në fushën e drejtësisë, për projektligjet e ardhura nga Ministria e Drejtësisë kemi dhënë kontributin tonë nëpërmjet opinioneve të paraqitura nga ana jonë.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë ka qënë dhe është në fushën marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale.

6. Marrëdhëniet me Shërbimin Informativ Shtetëror janë të fokusuara kryesisht në marrjen e informacionit nga ky shërbim në funksion të rritjes së efektivitetit në ndjekjen penale, veçanërisht në kuadër të veprave penale të krimit të organizuar dhe terrorizmit, trafiqeve të paligjshme dhe korrupsionit. Informacionet e përcjella nga SHISH kanë rezultuar të vlefshme dhe na kanë orientuar drejt në nisjen e procedimeve penale veçanërisht nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore.
7. Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Drejtësisë konsiderohen pozitive dhe në vitin 2010 janë pasqyruar në procesin e dhënies së autorizimit për procedim penal ndaj gjyqtarëve për të gjitha rastet e kërkuara nga ana jonë. Gjithashtu kemi dërguar informacion dhe përcjellë shqetësim për rastet e shkeljeve në detyrë të gjyqtarëve dhe jemi në pritje të përgjigjeve.
8. Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive janë ndërtuar bazuar në ligj dhe në memorandumet e bashkëpunimit me secilin prej tyre. Ne i kemi konsideruar dhe i konsiderojmë këto institucione si burim i rëndësishëm dhe i vlefshëm për referimin e grup veprave penale që lidhen me korrupsionin, krimin në detyrë dhe krimin financiar.

9. Në marrëdhëniet e prokurorëve me sistemin gjyqësor kemi synuar të respektojmë me rigorozitet pavarësinë dhe paanësinë e gjykatave. Kemi synuar dhe synojmë që prokurorët të jenë profesionalë, objektivë dhe të ndershëm gjatë procedurave gjyqësore, veçanërisht duke siguruar që gjykatës t'i jenë paraqitur të gjitha faktet që kanë lidhje me akuzën e ngritur dhe argumentat ligjore të nevojshëm për administrimin e duhur të drejtësisë.

Konstatojmë se drejtuesit e prokurorive nëpër rrethe kanë një raport të mirë bashkëpunimi me drejtuesit e gjykatave nëpër rrethe përsa i përket menaxhimit të procesit administrativ të shpërndarjes së çështjeve apo respektimit të afateve të vënies në lëvizje të çështjeve. Konstatojmë nevojën gjithnjë në rritje të kalimit në kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore për çështje të ngjashme me qëndrime të ndryshme.

Për shkak të rritjes së punës të Njësive të Përbashkëta Hetimore dhe specifikës së çështjeve të hetuara prej tyre, cmojmë se do të ishte në shërbim të mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë organizimi i kolegjeve të specializuara për të gjykuar çështjet e trajtuara nga strukturat tona. Në vazhdim të kësaj ideje do të ishte shumë i vlefshëm dhe trajnimi i përbashkët i gjyqtarëve të këtyre kolegjeve me prokurorët e Njësive të Përbashkëta Hetimore për këtë kategori veprash penale.

IV. Marrëdhëniet me misionet ndërkombëtare

Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit të kaluar ka qënë e përfshirë në disa projekte të financuara nga strukturat e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Qeverisë së SHBA e donatorëve të tjerë. Ajo që duhet thënë është se këto projekte kanë patur një impakt shumë pozitiv në punën e prokurorisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal ndërmjet prokurorive një kontribut të rëndësishëm ka dhënë projekti PROSECO, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës i përfunduar në Korrik të vitit 2010.

Gjatë vitit 2010 përfundoi projekti i binjakëzimit të Prokurorisë Shqiptare me Prokurorinë e Përgjithshme të Spanjës dhe Këshillin e Lartë të Magjistraturës së Italisë, i financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt realizoi me shumë sukses objektivat e parashikuara në drejtim të përgatitjes së akteve për vlerësimin e punës së prokurorëve, përgatitjes së disa protokolleve për hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimin financiar dhe për krimet që lidhen me mjedisin.

Gjatë vitit 2010 ka vazhduar zbatimi i projektit të Sfidës së Mijëvjeçarit Faza e 2-të, i financuar nga Qeveria e SHBA duke realizuar të gjitha objektivat e parashikuara për ngritjen dhe funksionimin e Njësive të Përbashkëta Hetimore.

Prokuroria e Përgjithshme është përfituese gjithashtu dhe nga tre projekte të financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit IPA.

Prokuroria Shqiptare është në pritje të fillimit të zbatimit të projektit të informatizimit të sistemit të Prokurorisë (CSM), të financuar nga Komisionit European. Projekti është në fazën e përzgjedhjes së subjektit që do të zbatojë këtë projekt. Ky sistem vlerësohet si shumë i rëndësishëm në drejtim të efektivitetit të punës së Prokurorisë, në drejtim të transparencës, në drejtim të kontrollit të punës së organit në tërësi, por edhe të çdo Prokurorie në veçanti. Gjithashtu, do të bëje të mundur krijimin e një baze të dhënash për të analizuar me hollësi tendencat e kriminalitetit në vend.

Projekti “Mbështetje për strukturat e hetimit të krimit financiar dhe pastrimit të parave” është finalizuar më përzgjedhjen dhe lidhjen e kontratës me partnerët Spanjë & Bullgari. Përfitues kryesor i këtij projekti është Prokuroria e Përgjithshme dhe përfitues të tjerë janë Ministria e Brendshme (Drejtoria e Hetimit të Krimit Ekonomik në Policinë e Shtetit) dhe Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Aseteve të Konfiskuara).

Objekti është të rritet kapacitet e hetimit të veprës penale të pastrimit të parave dhe krimit financiar, duke forcuar bashkëpunimin institucional ndërmjet strukturave të zbatimit të ligjit. Zbatimi i projektit fillon me 1 mars 2011.

Ka vazhduar implemetimi i Projektit kundër korrupsionit në Shqipëri “PACA“, me objektiv të përgjithshëm “Dhënien e kontributit për demokracinë dhe shtetin e të drejtës nëpërmjet parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit”. Në këtë projekt Prokuroria e Përgjithshme është një nga përfituesit e tij, bashkë me insitucione të tjera që merren me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në Shqipëri.

V. PRIORITET E PROKURORISË PËR VITIN 2011

Duke konsideruar prioritetet e shpallura nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, në strategjitë kombëtare të miratuara, në progres raportin dhe në rekomandimet që vijnë nga partnerët e huaj për shkak të angazhimeve të shtetit shqiptar në organizmat ndërkombtare, si dhe në problematikat e punës së organit të prokurorisë dhe tendencat e kriminalitetit të evidentuara gjatë vitit 2010, prokuroria shqiptare ka përcaktuar prioritetet për vitin 2011 si më poshtë:

1. Përmirësimi dhe rritja e vazhdueshme e bashkëpunimit me Policinë Gjyqësore me synim përmirësimin e funksionimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe me policitë gjyqësore të institucioneve të tjera.

2. Bashkëpunimi ndër-institucional me Ministrinë e Drejtësisë vlerësohet, gjithashtu, aspekt i rëndësishëm që ndikon në rritjen e efektivitetit të punës së organit të prokurorisë. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, për vitin në vazhdim, do të nënshkruajmë memorandumin e përbashkët për koordinimin e punës në kryerjen e inspektimeve në prokurori nga Drejtoria e Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë dhe nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme. Bazuar në ligjin e ri për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja, do të synojmë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përkatëse në dy institucionet.

3. Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomiko- financiar dhe krimit kompjuterik ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet e punës së prokurorisë. Në funksion të këtij prioriteti, me synim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, si dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në hetimin dhe ndjekjen penale kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, do të vazhdojë të mbështetet në të gjitha drejtimet puna e 7-të njësive të përbashkëta të ngritura për këtë qëllim. Në funksion të këtij prioriteti do të synojmë shtrirjen e këtyre njësive edhe në prokuroritë e rretheve të tjera gjyqësore.

4. Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikeve të paligjshme dhe pastrimit të parave do të vazhdojë të jetë prioritet i punës sonë. Për realizimin e këtij prioriteti do të fokusohemi kryesisht:

- Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e zbatimit të ligjit brenda vendit, duke i dhënë rrugë kryesisht hetimeve proaktive për goditjen e këtij lloj kriminaliteti.

- Zbatimin me efikasitetin e duhur të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” të ndryshuar.

- Zbatimin me efikasitet të ligjit “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.
- Shfrytëzimin në maksimum të gjithë materialit informativ që vjen nga agjensitë e ndryshme të shërbimeve inteligjente.
- Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e huaja të zbatimit të ligjit, duke tentuar të përdorim sa më shumë hetime paralele dhe të rrisim fleksibilitetin në shkëmbimin e informacionit.
- Në vazhdimin e trajnimeve për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin e ndryshime të reja ligjore dhe për përmirësimin e përdorimit më me efektivitet të metodave të posaçme të hetimit.

5. Lufta kundër veprave penale të vjedhjes së pasurisë me tendencë në rritje në vitin e kaluar do të jetë prioritet i prokurorisë për sa kohë ajo konsiderohet e lidhur ngushtë me sigurinë publike, duke :

- Forcuar kontrollin periodik të procedimeve penale në ndjekje dhe atyre të pezulluara për këto vepra penale.
- Ashpërsimin e politikës penale në drejtim të autorëve të këtyre veprave penale.

6. Lufta kundër veprave penale që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, për shkak të peshës së lartë specifike të saj, do të jetë prioritet i prokurorisë për sa kohë ajo konsiderohet e lidhur ngushtë me mbrojtjen në mënyrë të posaçme që legjislacioni shqiptar i bën jetës dhe shëndetit të shtetasve.

7. Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore mbetet prioritet edhe për vitin në vazhdim. Në këtë kuadër vëmëndje do t'i kushtohet:

- Rritjes së transparencës në emërimin dhe promovimin e prokurorëve.
- Rritjes së transparencës në procesin e inspektimit dhe procedimit disiplinor të prokurorëve.
- Rritjen e nivelit profesional nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe të specializuara të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.
- Vënies në efikasitet të sistemit të vlerësimit të prokurorëve.
- Krijimit të sistemit të vlerësimit të oficerëve të policisë gjyqësore në zbatim të ligjit të ri për policinë gjyqësore.
- Rritjes së integritetit të prokurorit dhe oficerëve të policisë gjyqësore duke synuar përmirësimin e motivimit nëpërmjet shpërblimeve financiare.
- Shfrytëzimit maksimal të gjithë produktit të përfutur nga projektet e huaja në mbështetje të Prokurorisë së Përgjithshme.
- Rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve të Qendrës së Përgjimit.
- Përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore për përmirësimin e kushteve dhe ambjenteve të punës për prokurorët.

Në vlerësim të treguesve të punës së prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë në emër të shtetit dhe në vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, theksojmë se Prokuroria Shqiptare ka realizuar me sukses angazhimet, rekomandimet dhe detyrat kushtetuese e ligjore në rritjen e efektivitetit dhe të ligjshmërisë në ushtrimin e funksioneve të saj.

Megjithë arritjet në vitin 2010, sfida dhe probleme të mëdha kemi përpara. Tendencat në rritje të kriminalitetit të paraqitura në këtë raport do të jenë në fokusin e punës tonë për vitin 2011.

Ju siguroj se Prokuroria në të gjitha hallkat e saj do të realizojë prioritetet në luftë kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimin të organizuar, korrupsionit në veçanti duke rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit si dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kemi synuar dhe do të synojmë ta ngrejmë drejtësinë shqiptare drejt standarteve që i kemi aspiruar prej kohësh duke u përpjekur për të bërë më të mirën për të rritur më tej vlerat e kësaj hallke të sistemit kaq të rëndësishëm të drejtësisë penale në Shqipëri.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

INA RAMA

PËRMBAJTJA

H Y R J E.....	1
VOLUMI I PUNËS SË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2010.....	2
MBI PROCEDIMET E HETUARA DHE TË PËRFUNDUARA.....	5
PEZULLIMET	9
MOSFILLIMET	10
PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS RRETHEVE DHE KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT	11
KOEFIÇIENTËT E KRIMINALITETIT.....	16
TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE	20
TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT PËR VITIN 2010....	21
KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE.....	22
TE PANDEHURIT	23
TENDENCA	24
KRIMET KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE.....	33
TE PANDEHURIT	34
TENDENCA	35
VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS.....	41
TE PANDEHURIT	42
TENDENCA	42
SEKSIONI IV, “KRIME SEKSUALE”	45
TE PANDEHURIT	46
TENDENCA	47
VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT.....	50
TE PANDEHURIT	51
TENDENCA	51
VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT	55
TRAFIQET E PALIGJSHME	55
TE PANDEHURIT	56
TENDENCA	57
VEPRAT PENALE, TË PRODHIMIT, TRAFIKIM, KULTIVIMIT DHE SHITJES TË NARKOTIKËVE	66
TE PANDEHURIT	67
TENDENCA	68
VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME SHFRYTËZIMIN E PROSITUCIONIT.....	72
TE PANDEHURIT	73
TENDENCA	74

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME KORRUPSIONIN	76
TE PANDEHURIT	77
TENDENCA	78
VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME DETYRËN.....	83
TE PANDEHURIT	84
TENDENCA	85
VEPRA PENALE NË LIDHJE ME PASTRIMIN E PARAVE	91
TE PANDEHURIT	91
TENDENCA	92
VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME KRIMIN E ORGANIZUAR.....	94
TE PANDEHURIT	94
III, VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE, KREU	
SEKSIONI I, “VJEDHJA E PASURISË”	96
TE PANDEHURIT	97
TENDENCA	98
VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME MASHTRIMET, KREU III, SEKSIONI II,	
MASHTRIMET	110
TE PANDEHURIT	111
TENDENCA	112
VEPRAT PENALE TË LIDHURA ME SHKATËRRIMIN E PRONËS, KREU III,	
SEKSIONI III	115
TE PANDEHURIT	116
TENDENCA	117
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E DOGANAVE, KREU III, SEKSIONI V.....	123
TE PANDEHURIT	124
TENDENCA	125
VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET, KREU III, SEKSIONI IV	132
TE PANDEHURIT	133
TENDENCA	133
VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME FALSIFIKIMIN E DOKUMENTEVE, KREU III,	
SEKSIONI VII.....	137
TE PANDEHURIT	138
TENDENCA	138
VEPRA PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT, SEKSIONI IX, KREU III.....	147
VEPRAT PENALE TË FALSIFIKIMIT TË MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË,	
KREU III, SEKSIONI VII.....	147
TE PANDEHURIT	148
TENDENCA	149
VEPRAT PENALE QË CËNOJNË RREGJIMIN JURIDIK TË TOKËS, SEKSIONI XI.	151
TENDENCA	152

VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME ZHVILLIMIN E PALEJUAR TË LOJËRAVE TË FATIT, SEKSIONI X.....	153
TE PANDEHURIT	153
TENDENCA	154
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KREU IV	156
TE PANDEHURIT	157
TENDENCA	158
KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT, KREU VIII, SEKSIONI I	
VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT	161
TE PANDEHURIT	162
TENDENCA	163
KREU VIII, SEKSIONI III, “VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE”	168
TE PANDEHURIT	170
TENDENCA	171
VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË, KREU X	194
TE PANDEHURIT	196
TENDENCA	197
KREU X, VEPRAT PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE	208
NË LIDHJE ME DINAMIKËN E VEPRAVE PENALE TË PARASHIKUARA NGA LIGJI NR.8003, DATË 28.9.1995(I NDRYSHUAR) “KODI PENAL USHTARAK”	211
TË DHËNAT PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2010	212
GJINIA E TË PANDEHURVE	215
TË PANDEHUR TË MITUR.....	216
TË DHËNA MBI LLOJET E DËNIMEVE TË KERKUARA NGA PROKURORËT	229
TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA PËR VITIN 2010.....	231
ANALIZË E GRUP TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË	233
KRIMI I ORGANIZUAR DHE TRAFIQET E PALIGJSHME.....	234
KORRUPSIONI DHE KRIMI EKONOMIK E FINANCIAR.....	235
VJEDHJET	236
SHKELJET E RREGULLAVE TË QARKULLIMIT RRUGOR	237
TENDENCAT.....	237
ANALIZË E DISA TREGUESVE NË RITJE TË NDJEKJES PENALE NË HETIMET PARAPRAKE DHE NË GJYKIM	239
REFORMIMI I PROKURORISË, RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE ME MISIONET NDËRKOMBËTARE.....	244

FORCIMI I KAPACITETEVE NË ORGANIN E PROKURORISË	245
MARRËDHËNIET E PROKURORISË ME INSTITUCIONET E TJERA	247
MARRËDHËNIET ME MISIONET NDËRKOMBËTARE	250
PRIORITET E PROKURORISË PËR VITIN 2011	251